

LILA DAMESKA



EKONOMIA

PËR VITIN E KATËRT

PËR ARSIMIN E MESËM PROFESIONAL
PROFESIONI EKONOMIKO-JURIDIK DHE TREGTAR
SEKTORI/EKONOMI, DREJTËSI, TREGTI

TEKNIK I EKONOMISË, TEKNIK I DREJTËSISË DHE ADMINISTRATOR BIZNESI

LILA DAMESKA

EKONOMIA

për vitin e katërt

**Për arsimin e mesëm profesional
Profesioni ekonomiko-juridik dhe tregtar
Sektori: ekonomi, drejtësi, tregti
Profili arsimor: teknik i ekonomisë, teknik i drejtësisë dhe
administrator biznesi**

Shkup, 2024

EKONOMIA

EKONOMIA

për vitin e katërt

Për arsimin e mesëm profesional

Profesioni ekonomiko-juridik dhe tregtar

Sektori: ekonomi, drejtësi, tregti

Profili arsimor: teknik i ekonomisë, teknik i drejtësisë dhe administrator biznesi

Autore:

Lila Dameska

Recensentë:

Oliver Filiposki

Lidija Qoseve

Aneta Pavoviq Dueva

Përpunimi teknik:

Sasho Stojčeski

Emil Todorov

Sasho Todorov

Titulli origjinal:

ЕКОНОМИЈА

за четврта година

За средно стручно образование

Економско – правна и трговска струка

Сектор / економија, право, трговија

Образовен профил: економски техничар, правен техничар и бизнис администратор

Ли́ла Да́меска

Redaktor: Refail Sulejmani

Përkthyer nga gjuha maqedonase: Sadulla Kamberi

Redaktor profesional në gjuhën shqipe: Efraim Sejdija

Lektor: Refail Sulejmani

Botues:

Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut
rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr. 54 1000 Shkup.

Rregullimi gra ik dhe teknik: Vlladimir Mlladenovski – ARS STUDIO

Vendi dhe viti i botimit: Shkup, 2024

Me vendim të Komisionit kombëtar të teksteve shkollore për Arsimin fillor dhe të mesëm nr. 26-2189/1 të datës 15.09.2023, miratohet përdorimi i tekstit shkollor Ekonomia për vitin e katërt, arsimit të mesëm profesional në profilin ekonomiko-juridik dhe tregtar.

PARATHËNIE

Të dashur nxënës!

Lënda e Ekonomisë është disiplinë themelore shkencore e cila mësohet në të gjitha shkollat e mesme.

Punimi që do t'ua prezantoj në nivel global do t'ju ndihmojë të mësoni bazat e ekonomisë, duke përfshirë elementët e makroekonomisë. Është shkruar sipas programeve modulare për arsimin e mesëm profesional, sektorin e ekonomisë, drejtësinë, tregtinë, profesionin ekonomiko-juridik dhe tregtar, për profilin: teknik i ekonomisë, teknik i drejtësisë dhe administrator biznesi.

Në tekstin shkollor janë paraqitur pesë njësi modulare: Bazat e Makroekonomisë, Rritja dhe zhvillimi i ekonomisë, Paraja dhe politika monetare, Shteti dhe ekonomia dhe Ekonomia ndërkombëtare.

Në njësinë e parë modulare mbi bazat e makroekonomisë, do të qëndroj dhe analizoj tri kapituj, edhe atë: Objektivat dhe instrumentet e politikës makroekonomike, Kërkesa agregate dhe oferta agregate dhe Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) dhe shpërndarja e dedikuar e PBB-së. Në njësinë e dytë modulare për rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë janë analizuar tri kapituj, përkatësisht: Rritja ekonomike dhe fazat e ciklit ekonomik, Konsumi, kursimet, investimet dhe papunësia dhe shkaqet e papunësisë. Në njësinë e tretë modulare për paranë dhe politikën monetare analizohen tri kapituj edhe atë: Vlera dhe ndryshimet në vlerën e parasë, Kërkesa dhe oferta e parasë dhe politika monetare, Inflacioni dhe lakorja e Filipsit në periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë. Në njësinë e katërt modulare, shteti dhe ekonomia, do të fokusohem dhe do t'i analizoj tri kapituj edhe atë: Teoritë ekonomike dominuese për rolin e shtetit në ekonomi, Të ardhurat publike, shpenzimet publike dhe buxheti, taksat dhe sistemi tatimor. Në njësinë e pestë modulare për ekonominë ndërkombëtare do të analizohen tri kapituj, përkatësisht: Marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare, Proteksionizmi dhe liberalizmi si sisteme të tregtisë ndërkombëtare dhe sistemi devizor dhe politika devizore.

Çdo njësi modulare përmban rezultatet e të nxënit dhe në çdo kapitull vijues, përveç shtjellimit të këtyre koncepteve, përfshihen edhe kategoritë, ligjet, përmbajtja e kapitullit, konceptet kryesore, pyetjet për kontrollimin e njohurive dhe detyrat për zbatimin praktik të njohurive.

Në fund të tekstit kam përgatitur fjalor që do t'ju ndihmojë të fitoni më lehtë dhe shpejt njohuri rreth koncepteve dhe termave të caktuara ekonomike që do t'i hasim në të.

Teksti shkollor bazohet në programin e Ekonomisë për vitin e katërt (e hartuar në mënyrë modulare), për arsimin e mesëm profesional, profesionin ekonomiko-juridik dhe tregtar, sektorin e ekonomisë, drejtësisë dhe tregtisë dhe përputhet plotësisht me të.

Këto agregate makroekonomike kanë ndikim të fortë në mënyrën e jetesës dhe në mirëqenien e qytetarëve në vendet moderne. Prandaj edhe unë, si shumë autorë të tjerë ekonomistë, mora përsipër të shkruaj material që, me të drejtë mund të thuhet se, lë vend për reflektim dhe përmirësim të mëtejshëm për nxënësit që punojnë me të.

Besoj se përmbajtjet mësimore në tekstin shkollor i kam shpjeguar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, të pranueshme për ju, sa i përket njohurive të nevojshme për të vazhduar shkollimin tuaj më tej, në ndonjë nga fakultetet sociale, veçanërisht fakultetin ekonomik në vendin tonë dhe jashtë vendit.

Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të veçantë për të gjithë ata që më ndihmuan në përgatitjen e tekstit shkollor, për recensentët të cilët me njohuritë dhe sugjerimet e tyre kontribuan në zhvillimin e materialit dhe qëndrimet pozitive ndaj shpjegimeve të mia dhe përpunimit të moduleve, kurse veçanërisht. familjes sime, nipërve dhe mbesave të mia, të cilët ishin mbështetje gjatë përgatitjes së këtij punimi.

Nga Autori

*EKONOMIA SJELLË PARA, NDËRSA ATO
E RROTULLOJNË BOTËN*



PËRMBAJTJA

NJËSIA MODULARE 1: BAZAT E MAKROEKONOMISË	2
KAPITULLI 1: OBJEKTIVAT DHE INSTRUMENTET E POLITIKËS MAKROEKONOMIKE	3
1. SISTEMI EKONOMIK DHE POLITIKA EKONOMIKE	4
2. BJEKTIVAT BAZË TË POLITIKËS MAKROEKONOMIKE	6
3. INSTRUMENTET THEMELORE TË POLITIKËS MAKROEKONOMIKE	9
KAPITULLI 2: KËRKESA AGREGATE DHE OFERTA AGREGATE.....	13
1. KËRKESA AGREGATE – AD(AGGREGATE DEMAND)	14
2. KËRKESA AGREGATE – AS(AGGREGATE SUPPLY).....	16
3. BILANCI MAKROEKONOMIK	18
KAPITULLI 3: PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO (PBB) DHE SHPËRNDARJA E PBB-së.....	21
1. AFATIT DHE ESENCA E PBB-së.....	22
2. METODAT E LLOGARITJES SË PBB-së.....	23
3. PRODHIMI NOMINAL DHE REAL VENDOR BRUTO	24
4. QËLLIMI I SHPËRNDARJES SË PBB-së	26
NJËSIA MODULARE 2: RRRITJA DHE ZHVILLIMI I EKONOMISË	30
KAPITULLI 1: RRRITJA EKONOMIKE DHE FAZAT E CIKLIT EKONOMIK	31
1. RRRITJA DHE ZHVILLIMI EKONOMIK	32
2. FAKTORËT PËR ZHVILLIM EKONOMIK	34
3. CIKLI EKONOMIK.....	37
KAPITULLI 2: KONSUMI, KURSIMET DHE INVESTIMET	42
1. KONSUMIMI DHE STRUKTURA E TIJ	43
2. KURSIM.....	41
3. INVESTIMET – AFAT DHE LLOJET	45

KAPITULLI 3: PAPUNËSIA DHE SHKAQET E PAPUNËSISË	52
1. KONCEPTI, MATJA DHE SHPENZIMET E PAPUNËSISË	53
2. LLOJET E PAPUNËSISË	55
3. SHKAQET E PAPUNËSISË.....	56
NJËSIA MODULARE 3: PARAJA DHE POLITIKA MONETARE	60
KAPITULLI 1: VLERA DHE NDRYSHIMET NË VLERËN E PARAVE.....	61
1. PARAJA DHE FUNKSIONET E TYRE.....	62
1.1. FUNKSIONET E PARAVE.....	63
2. VLERA DHE NDRYSHIMET NË VLERËN E PARA VE	64
KAPITULLI 2: KËRKESA DHE OFERTA E PARAVE DHE POLITIKA MONETARE.....	69
1. AGREGATET ELEMENTARE MONETARE DHE KËRKESA E PARAVE.....	70
1.1. KËRKESA PËR PARA.....	70
2. OFERTA E PARAVE.....	71
3. POLITIKA MONETARE	73
3.1. POLITIKA E TREGUT TË HAPUR.....	74
3.2. POLITIKA E NORMËS SË ZBRITJES	75
3.3. POLITIKA E REZERVAVE TË DETYRUARA.....	75
KAPITULLI 3: INFLACIONI DHE LAKORJA E FILIPSIT NË PERIUDHË AFATSHKURTËR DHE AFATGJATË	78
1. KONCEPTI, MATJA DHE SHPENZIMET E INFLACIONIT	79
1.1. SHPENZIMET INFLACIONI	81
2. LLOJET E INFLACIONIT SIPAS SHKAQEVE QË E SHKAKTOJNË.....	82
3. LIDHJA MIDIS INFLACIONIT DHE PAPUNËSISË – LAKORJA E FILLIPS NË PLANIN AFATSHKURTËR DHE AFATGJATË	83
3.1 LAKORJA E FILLIPSIT NË PLANIN AFATGJAT	84
NJËSIA MODULARE 4: SHTETI DHE EKONOMIA.....	88
KAPITULLI 1: TEORITË EKONOMIKE DOMINANTE MBI ROLIN E SHTETIT NË EKONOMI	89
1. TEORITË EKONOMIKE DOMINUESE.....	90
2. NEO-KEJNESIANIZMI	91

2.1. NEO-KEJNESIANËT PËR TREGUN.....	91
2.2. NEOKEJNESIANËT PËR SHTETIN.....	92
3. NEOLIBERALIZMI	92
3.1. DREJTIMET THEMELORE NË SHKOLLËN NEOLIBERALE	93
3.1.1. EKONOMIA E OFERTIMIT	94
3.1.2. PRITJE RACIONALE	94
3.1.3. ZGJIDHJET PUBLIKE	95
KAPITULLI 2: TË ARDHURAT PUBLIKE DHE SHPENZIMET PUBLIKE	97
1. POLITIKA FISKALE.....	98
1.1. TË ARDHURAT PUBLIKE	98
2. SHPENZIMET PUBLIKE	100
3. BUXHETI.....	102
KAPITULLI 3: TATIMET DHE SISTEMI TATIMOR.....	106
1. KUPTIMI PËR TATIMET, KARAKTERISTIKAT DHE ELEMENTET E TATIMEVE	107
2. LLOJET E TATIMEVE	108
3. TATIMI I FITIMIT	109
4. TATIMI PERSONALE I TË ARDHURAVE	110
5. TATIMET NË PRONË	111
6. TATIMET MBI KONSUMIN	112
6.1. TATIMI NË VLERËN E SHTUAR (TVSH)	112
6.2. AKCIZAT	113
6.3. DOGANAT	114
NJËSIA MODULARE 5: EKONOMIA NDËRKOMBËTARE	117
KAPITULLI 1: MARRËDHËNIET EKONOMIKE NDËRKOMBËTARE	118
1. FORMAT E TREGTISË NDËRKOMBËTARE	119
2. MARRËDHËNIET EKONOMIKE NDËRKOMBËTARE	120
3. SISTEMI I TREGTISË SË JASHTME DHE POLITIKA TREGTARE E JASHTME	123
KAPITULLI 2: PROTEKTIONIZMI DHE LIBERALIZMI SI SISTEM TË TREGTISË NDËRKOMBËTARE	126
1. PËRPARËSITË ABSOLUTE DHE KRAHASUESE	127
1.1. TEORIA E PËRPARËSIVE ABSOLUTE.....	127

1.2. TEORIA E PËRPARËSIVE KRAHASUESE.....	128
2. PROTEKSIONIZMI NË TREGTINË NDËRKOMBËTARE	130
3. TREGTIA E LIRË NDËRKOMBËTARE -LIBERALIZMI.....	131
KAPITULLI 3: SISTEMI VALUTOR DHE POLITIKA KËMBIMORE.....	134
1. SISTEMI DEVIZOR DHE POLITIKA DEVIZORE.....	135
2. KURSI DEVIZOR.....	136
3. BILANCI I PAGESËS.....	139
3.1. TEKNIKA E PAGESAVE NDËRKOMBËTARE.....	140
3.2. KONCEPTI PËR BILANCIN E PAGESAVE NDËRKOMBËTARE	140
FJALOR.....	146
LITERATURA E SHFRYTËZUAR.....	158

LILA DAMESKA

EKONOMIA

Për vitin e katërt

**Për arsimin e mesëm profesional
Profesioni ekonomiko-juridik dhe tregtar
Sektori/Ekonomi, drejtësi, tregti
Profili arsimor: teknik i ekonomisë, teknik i drejtësisë
dhe administrator biznesi**

Shkup, 2024

Njësia modulare 1

Bazat e makroekonomisë

Rezultatet nga mësimi

Nxënësi do të jetë në gjendje:

- Të shpjegojë objektivat dhe instrumentet e politikës makroekonomike;
- Të shpjegojë kërkesën agregate – AD (Aggregate Demand) dhe ofertën agregate-AS (Aggregate Supply) dhe të konstruktoj grafikun e bilancit makroekonomik;
- Të diferencojë llojet e prodhimit të brendshëm bruto (PBB) dhe të shpjegojë shpërndarjen e dedikuar të PBB.

Kapitulli 1

Qëllimet dhe instrumentet e politikës makroekonomike

Përmbajtja:

1. Sistemi ekonomik dhe politika ekonomike
2. Objektivat elementare të politikës makroekonomike
3. Instrumentet elementare të politikës makroekonomike

Kur të përfundoni këtë kapitull, duhet të jeni në gjendje:

- të përkufizoni konceptin e sistemit ekonomik dhe politikës ekonomike;
- të shpjgoni elementet e sistemit ekonomik;
- të jepni shembull të politikës ekonomike;
- të theksoni qëllimet e politikës makroekonomike;
- të shpjgoni qëllimet e politikës makroekonomike;
- të shpjgoni instrumentet e politikës makroekonomike;
- të krahasoni qëllimet dhe instrumentet e politikës makroekonomike.

1. Sistemi ekonomik dhe politika ekonomike

Për të qenë në gjendje të shpjegojmë termin sistem ekonomik dhe politikë ekonomike, fillimisht duhet të shpjegojmë se çfarë nënkuptohet me termin ekonomi, ekonomikë apo ekonomi të një vendi. Këto tri fjalë janë sinonime, domethënë përdoren me të njëjtin kuptim. Këto shprehje nënkuptojnë realitetin ekonomik, pra realitetin ekonomik të një vendi. Kjo nënkupton menaxhimin me familjen, ekonominë, me pronën, por edhe vetë pronën, burimet natyrore, punën, shpërndarjen, shkëmbimin, konsumin. Këto terma e shpjegojnë *shqetësimin* për zgjidhjen me sukses të të gjitha problemeve që lidhen me sigurimin e bazës materiale për jetën e njerëzve. Ajo e supozon gjithashtu edhe nevojën e sjelljes së organizuar të njerëzve, duke filluar nga prona individuale, ekonominë apo ekonominë individuale, deri te ekonomia dhe ekonomia e vendit në tërësi.

Pra, ekonomia e një vendi është sfera ekonomike, ekonomia ose ana e jetës shoqërore, përveç sferave politike, kulturore, sociale dhe të tjera, pra ajo në të cilën sigurohet baza materiale për jetën e njerëzve, d.m.th. për të mirat dhe shërbimet materiale, kulturore dhe sociale, nga ushqimi dhe veshmbathja deri te sporti dhe rekreacioni. Madje më konkretisht, nën ekonomi-ekonomik si realitet ekonomik nënkuptohen, në fakt, kapacitetet prodhuese dhe shërbyese, kompanitë dhe punëtorët, vetë procesi i prodhimit, shpërndarjes, shkëmbimit dhe konsumit dhe në përgjithësi e gjithë jeta ekonomike e vendit, struktura e prodhimit, punësimi dhe papunësia, inflacioni, paraja, bankat, importet, eksportet dhe shumë dukuri, procese dhe situata të tjera të ngjashme. Gjithçka që është realitet ekonomik i një vendi. Ekonomia si shkencë e studion atë realitet ekonomik dhe mbi të gjitha këtu nënkuptohen:

- 1. sistemi ekonomik;**
- 2. politika ekonomike.**

Çka në fakt paraqet sistemi ekonomik si pjesë e realitetit ekonomik.

Ekzistojnë kuptime të ndryshme për termin sistem ekonomik. Shpesh barazohet me termin sistem ekonomik, i cili, në parim, nuk është i gabuar sepse të dy termat kanë të njëjtën përmbajtje dhe kuptim. Ekziston ndryshim në gjerësi, domethënë në shtrirje. Kur përdoret termi sistem ekonomik, në fakt nënkupton karakteristikat më të gjera të sistemit ekonomik të një formacioni të tërë ekonomik social, pra flasim për ekonomi kapitaliste ose sistem ekonomik. Nën termi sistem ekonomik, sërish, nënkuptohet një situatë më specifike brenda një sistemi ekonomik dhe shpreh kushtet e përcaktuara nga shteti, në të cilin zhvillohet veprimtaria ekonomike.

Prandaj sistemi ekonomik përkufizohet si tërësia e kushteve ekonomike, përkatësisht ato kushte të përcaktuara nga shteti me rregullore juridike dhe norma zakonore.

Çdo sistem ekonomik ka elemente dhe rregulla bazë, duke përfshirë:

- Për shembull: në Republikën e Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm RMV) *marrëdhëniet pronësore* përcaktohen me Kushtetutë dhe me ligje, të cilat garantojnë paprekshmërinë e së drejtës së pronës. Ekziston pluralizëm i pronësisë.

- **Rregullat që rregullojnë organizimin dhe menaxhimin e ndërmarrjeve me firmat:** Ky është element që në thelb lidhet dhe varet nga rregulli i parë, pra lloji i pronësisë. Kjo e përcakton se cila do të jetë mënyra e menaxhimit.

- **Rregullat e operacioneve të tregut,** ku përcaktohen në mënyrë specifike rregullat e konkurrencës në treg, kur ka sjellje monopoliste, cili është roli i shtetit në rregullimin e marrëdhënieve të tregut dhe sa të lira apo të kufizuara janë kompanitë në punën e tregut.

- **Rregullat mbi të cilat bazohen marrëdhëniet e punës,** përcaktohen marrëdhëniet ndërmjet punëdhënësve dhe punëtorëve, pronarët, mënyra e grupimit të tyre, formimi i shoqatave sindikale etj.

- Çështje shumë e rëndësishme në përcaktimin e sistemit ekonomik si grup rregullash juridike në të cilat funksionon ekonomia *është roli i shtetit në rregullimin e praktikës ekonomike,* gjegjësisht sa shteti me rregullat e vendosura e kufizon pavarësinë e kompanive.

Duke marrë parasysh elementet (rregullat) bazë, në fakt shteti përcakton përbërësit individualë, nënsistemet e sistemit ekonomik. Ato formojnë përmbajtjen e sistemit ekonomik dhe përfshijnë: rregullat e sistemit fiskal, të sistemit bankar-kreditor dhe monetar, rregullat për funksionimin e tregut të kapitalit, të tregut të parasë etj.

Sistemi ekonomik i RMV është në ndërtim e sipër, në zhvillim e sipër, ndërsa elementet bazë tashmë janë përcaktuar. Por kjo nuk do të thotë se ato janë dhënë përgjithmonë. Sistemi ndryshon dhe përmirësohet vazhdimisht, domethënë po reformohet. Por nëse ndryshimet shkojnë deri aty sa ndryshojnë edhe karakteristikat dhe elementet bazë të atij sistemi, atëherë bëhet fjalë për një sistem të ri ekonomik.

Jeta dhe praktika ekonomike zhvillohen pavarësisht nëse njerëzit do t'i kontrollojnë ato me rregulla të caktuara, siç janë rregullat e vendosura nga sistemi ekonomik, ose me masa të veçanta, siç janë masat e politikës ekonomike. Nga përvojat dhe zhvillimet e kaluara është treguar, sidomos në shembullin e vendeve të zhvilluara, se në kushtet moderne praktikisht nuk është e mundur që zhvillimi të bëhet plotësisht i lirë, vetëm nën ndikimin e ligjshmërive të tregut, pa ndonjë rregullim shtetëror.

Megjithëse funksioni themelor i tregut është të mundësojë alokimin, rregullimin dhe përdorimin sa më racional dhe efikas të burimeve natyrore dhe njerëzore, megjithatë, tregu ka shumë dobësi dhe kufizime, të cilat, nëse nuk eliminohen me masat e politikës ekonomike, mund të çojnë në shumë pasoja negative. Rregullorja shtetërore nuk duhet të insistoj që t'i zëvendësojë parimet e tregut, por të korrigjojë dhe plotësojë lëvizjet e tregut në mënyrë që ato të drejtohen në drejtimin e dëshiruar. Për këtë arsye në kuadër të rregullores shtetërore **politika ekonomike përkufizohet si: përmbledhje e masave me të cilat autoritetet shtetërore i rregullojnë lëvizjet ekonomike dhe në këtë mënyrë ndikojnë në praktikën ekonomike.**

Këto masa dhe instrumente të shtetit – qeverisë bazohen në parimet dhe kriteret e tregut, ndër të cilat janë masat në politikën fiskale dhe monetare-kreditore, politikën e çmimeve dhe të ardhurave, kurse instrumentet janë: paraja, normat e interesit, kursi i këmbimit, kreditë, taksat, doganat, rezervat shtetërore, buxheti dhe të ngjashme.

Për t'u kuptuar më lehtë konceptet e termave, sistemin ekonomik dhe politikën ekonomike dhe marrëdhëniet e tyre të ndërsjella, do të shpjegojmë një shembull. Nëse aktivitetin ekonomik e barazojmë me lojën sportive të futbollit, atëherë rregullat që zbatohen për atë lojë (numri i lojtarëve, madhësia e fushës së futbollit, kohëzgjatja e pjesës së parë etj.) mund të barazohen me sistemin ekonomik, ndërsa taktikat e trajnerëve, masat që ata ndërmerren për zëvendësimin e lojtarëve gjatë lojës dhe në të njëjtën mënyrë identifikohen me politikën ekonomike.

2. Qëllimet themelore të politikës makroekonomike

Makroekonomia i monitoron dhe analizon lëvizjet e treguesve më themelorë makroekonomikë, si: PBB – GDP (Prodhimi i Brendshëm Bruto – Gross Domestic Product), kursimet dhe investimet, normën e interesit, deficitin, ciklet ekonomike, devizat dhe të ngjashme. Politika makroekonomike (përmbledhje masash dhe instrumentesh me të cilat autoritetet shtetërore i rregullojnë lëvizjet ekonomike, duke i drejtuar ato në drejtimin e dëshiruar, duke ndikuar kështu në praktikën ekonomike), kryesisht ndikojnë në arritjen e synimeve të përcaktuara zhvillimore. Në ekonomi zakonisht ekzistojnë **katër qëllime bazë**, për realizimin e të cilave kujdeset politika makroekonomike:

1. Realizimi i vëllimit më të madh të mundshëm të aktivitetit ekonomik në vend dhe sigurimi i ritmit të qëndrueshëm të rritjes ekonomike;
2. Ruajtja e nivelit të lartë të punësimit, gjegjësisht niveli i ulët i papunësisë;
3. Ruajtja e normës së ulët të inflacionit, pra ruajtja e stabilitetit të lartë të çmimeve;
4. Ruajtja e shkëmbimit tregtar të pasur dhe të ekuilibruar ndërmjet vendit dhe jashtë vendit dhe kursit të qëndrueshëm devizor.

Objektivi i parë flet për treguesin më sintetik të aktivitetit të përgjithshëm të vendit, që është **Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB)**. Ai e përfaqëson vlerën e tregut të të gjitha mallrave dhe

shërbimeve të prodhuara përfundimtare në një vend gjatë një viti. Prodhimi i Brendshëm Bruto mund të jetë: nominal, real, faktik dhe potencial.

Figura 1-1: Llojet e Prodhimit të Brendshëm Bruto



▪ **PBB NOMINAL** – *përfitohet duke shumëzuar të gjitha mallrat dhe shërbimet e prodhuara me çmimet aktuale të tregut* – ku përfshihet ndikimi i inflacionit dhe PBB e llogaritur me çmimet aktuale e jep treguesin që pasqyron rritjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve në atë vit.

▪ **PBB REAL** – *fitohet kur, duke përdorur çmimet konstante nga ndonjë vit i mëparshëm, e cila është e përcaktuar si bazë, mallrat dhe shërbimet e prodhuara vjetore shumëzohen me çmimet bazë, kurse kështu treguesi çlirohet nga ndikimi i rritjes së çmimeve*. Konsiderohet si më i besueshëm.

▪ **PBB FAKTIK** – *e tregon lëvizjen e sasisë totale të prodhuar të të gjitha mallrave dhe shërbimeve në ekonomi në periudha të caktuara kohore, zakonisht për një vit*. Ai tregon luhatje dhe paqëndrueshmëri që ndodh kur rritet dhe bie gjatë gjithë vitit dhe nga viti në vit. Pra, mund të ketë lëvizje lart e poshtë.

▪ **PBB POTENCIAL** – *e tregon tendencën afatgjate të PBB-së faktike, pra na tregon mundësinë e ekonomisë për prodhim maksimal (mallra dhe shërbime të prodhuara) në kushtet e mbajtjes së një niveli të lartë të stabilitetit të çmimeve*. Nëse ekonomia funksionon me PBB-në potenciale, d.m.th i shfrytëzon plotësisht të gjitha burimet që janë në disponim (prodhimi viteti dhe prodhimi maksimal).

Qëllimi i dytë – shkalla e ulët e papunësisë.

Realizimi i këtij qëllimi është zgjidhja e një prej problemeve më të mëdha makroekonomike në ekonominë e vendeve moderne. Ky problem është shumë i vështirë edhe nga pikëpamja sociale. Përkatesisht, personat e papunë nuk marrin pjesë në krijimin e PBB-së dhe në rritjen ekonomike të vendit, gjegjësisht nuk prodhojnë mallra dhe nuk ofrojnë shërbime, prandaj nuk kanë fonde të mjaftueshme për të plotësuar nevojat e tyre themelore. Dhe me këtë nuk janë në gjendje t'i paguajnë

taksat shtetit dhe ai duhet të ndajë fonde të ndihmës sociale për të ndihmuar në plotësimin e nevojave të tyre themelore. Në këtë kontekst mundemi ta llogarisim edhe shkallën e papunësisë, e cila e jep raportin ndërmjet numrit të papunëve në vend dhe fuqisë totale të punës të shprehur në përqindje.

Qëllimi i tretë – norma e ulët e inflacionit.

Ky synim kërkon zgjidhjen e një problemi shumë të madh ekonomik, fenomenit të quajtur inflacion. Ajo është gjendje në të cilën fondet monetare tejkalojnë fondet e mallrave dhe kështu ka rritje të nivelit të përgjithshëm të çmimeve. **Çmimet, nga ana tjetër, janë tregues nëse burimet dhe faktorët e prodhimit janë të pakta ose të bollshme në ekonominë e tregut.** Pra, çmim i lartë për burim të pakët, ndërsa çmim i ulët për burim të bollshëm. Megjithatë, kur në ekonomi ka inflacion të lartë dhe kur ka rritje të përgjithshme të çmimeve, ato pushojnë së qeni sinjal real për shpërndarjen optimale të burimeve. Nëse, nga ana tjetër, ndodh situatë me inflacion shumë të lartë, ajo përfaqëson kërcënim për gjithçka në ekonomi. Njerëzit nuk do të duan të mbajnë para të gatshme, vlera e të cilave bie shumë, duke u përpjekur t'i materializojnë sa më shpejt në pasuri të paluajshme, duke u përpjekur të ruajnë fuqinë blerëse të parasë.

Ekonomistët e matin inflacionin **nëpërmjet indekseve të çmimeve të konsumit** (Consumer Price Index – CPI), pra nëpërmjet nivelit të çmimeve, mallrave dhe shërbimeve që e japin **shportën e konsumit të një familjeje mesatare prej katër anëtarëve.**

Qëllimi i katërt – ruajtja e shkëmbimit tregtar të pasur dhe të ekuilibruar të vendit me vendet e huaja dhe kurs devizor të qëndrueshëm.

Sot në botë ekziston ndarje e gjerë e punës, e cila i drejton vendet drejt bashkëpunimit të ndërsjellë ekonomik në ekonominë botërore, me ç' rast vendet kanë dobi dhe përfitime shumë domethënëse nga tregtia ndërkombëtare. Pasurohet oferta e brendshme e mallrave dhe shërbimeve nga më të ndryshmet, rritet aftësia konkurruese e ofruesve vendas, rritet specializimi në avantazhe krahasuese etj. Të gjitha vendet në këtë shkëmbim realizojnë importe dhe eksporte të ndryshme, gjë që jep eksporte neto më të larta dhe PBB më të lartë, ose huamarrje më të larta jashtë vendit. Në tregtinë e jashtme, vendet përpiqen të arrijnë marrëdhënie të balancuara në afat kohor më të gjatë. Arkëtimet dhe pagesat kryhen me mjete devizore, ndërkohë që politika makroekonomike synon të ruajë stabilitetin e kursit devizor të ekonomisë. Kursi i devizave është çmimi i njësisë monetare vendase i shprehur në njësi monetare të huaja. Kështu, për shembull, kursi i denarit është 61,6 denarë për një euro (sipas kursit të mesëm të kursit të listës së Bankës Popullore të RMV). Ky është kursi zyrtar i denarit. Pra, stabiliteti i kursit devizor është shumë i rëndësishëm për aftësinë e vendit në tregtinë e jashtme dhe në tregun botëror.

3. Instrumentet themelore të politikës makroekonomike

Për realizimin dhe arritjen e qëllimeve bazë makroekonomike, politikat makroekonomike përdorin arsenal të tërë masash dhe instrumentesh, ndërsa shteti praktikisht zhvillon politikën e synuar ekonomike nëpërmjet tyre. Ekzistojnë katër politika të rëndësishme makroekonomike që përmbajnë instrumente të ndryshme për realizimin e qëllimeve makroekonomike. Këto janë: *politika fiskale*, *politika monetare*, *politika e marrëdhënieve ekonomike me jashtë dhe politika e të ardhurave*. Le t'i shqyrtojmë ato në detaje.

Politika fiskale dhe ajo monetare janë politikat kryesore makroekonomike. Instrumenti bazë i përdorur nga politika fiskale është buxheti i shtetit. Është plan që ka anën e vet të të ardhurave dhe shpenzimeve. Ana e të ardhurave përbëhet nga të ardhurat publike që buxheti merr nga të gjitha llojet e tatimeve, tarifave, doganave, huave publike. Shteti i përcakton si detyrime ligjore dhe vetëm ai ka kompetencë të vendosë detyrime publike ndaj tatimpaguesve, ndërsa si obligues paraqiten qytetarët dhe personat juridikë. Sot, taksat publike në vendet moderne zënë pjesë të madhe të PBB-së (nga 30% në 45%), e cila rishpërndan fondet dhe jep mundësinë për të shpenzuar para në formën e shpenzimeve publike, për një sërë qëllimesh: për administratën shtetërore, ushtrinë, policinë, arsimin, shëndetësinë dhe për qëllime të tjera të dobishme shoqërore. Ai konsum publik (shpenzimet publike) zënë një pjesë të konsiderueshme të konsumit agregat, duke konsumuar një larmi të gjerë mallrash dhe shërbimesh përfundimtare, duke u dhënë kështu qeverive të vendeve moderne mundësinë që të ndikojnë fuqishëm në tendencat ekonomike nëpërmjet tij. Nëpërmjet kësaj politike fiskale, ajo vepron kryesisht si antinflacion në fazën e zgjerimit dhe antirecesive kur ekonomia është në fazë të rënies ekonomike, madje edhe në depresion. Pra, në një periudhë (fazë) të caktuar të zhvillimit ciklik, politika fiskale stimulon, ndërsa në tjetër kufizon.

Politika monetare është instrumenti i dytë i rëndësishëm në zbatimin e synimeve makroekonomike. Në thelb është në duart e bankës qendrore (dhe i referohet parasë dhe kredisë). Banka qendrore ka disa funksione, por funksioni i rregullimit të sasisë së parave në qarkullim është veçanërisht i rëndësishëm.

Banka qendrore, duke rritur apo ulur potencialin kreditor të bankave komerciale, ndikon në rritjen apo uljen e ofertës monetare, varësisht nëse cikli ekonomik është në fazën e zgjerimit apo të recesionit. Në të njëjtën kohë, banka qendrore përdor disa politika, duke përfshirë: *politikën e rezervës së detyruar*, *politikën e normës së uljes (interetit) dhe politikën e tregut të hapur (blerja dhe shitja e letrave me vlerë)*. Domethënë, nëse ekonomia është në fazë të recesionit (reduktim i prodhimi vitetit, reduktim i prodhimit, investime të ulëta, ulje e PBB-së dhe rritje e papunësisë), banka qendrore do të duhet të rrisë ofertën monetare, duke rritur kërkesën agregate dhe rigjallërimin e aktivitetit ekonomik. Pastaj banka qendrore me normën e rezervës së detyrueshme (pra rezervat monetare që bankat

komerciale duhet të mbajnë në bankën qendrore) do të rrisë kapacitetin monetar të bankave të nivelit të dytë për dhënien e kredive, duke ndikuar kështu në rritjen e ofertës monetare, kurse në këtë mënyrë në sasinë e parave në qarkullim. Gjithashtu, në kushtet e recesionit, banka qendrore do ta ulë normën e interesit, gjë që i bën më të lira kreditë që banka qendrore u jep bankave të nivelit të dytë dhe ato klientëve të tyre, kurse kështu oferta monetare rritet sërish. Instrumenti i tretë janë operacionet e tregut të hapur, të cilat reduktohen në blerjen dhe shitjen e obligacioneve të qeverisë. Në kushtet e recesionit, banka qendrore do të rrisë potencialin monetar duke blerë bono qeveritare nga bankat komerciale dhe në këtë mënyrë ato do të marrin më shumë fonde për miratimin e kredive tregtare për klientët e tyre.

Në kushtet e fazës së zgjerimit, politika e veprimit të këtyre instrumenteve është e kundërt¹

Politika e marrëdhënieve ekonomike të jashtme. Me këtë politikë qeveria ndikon në vëllimin dhe strukturën e tregtisë së jashtme të vendit. Kështu, ajo do të mbajë marrëdhënie të balancuara në import dhe eksport. Vëllimi dhe struktura e importeve dhe eksporteve ndikohen nga tarifat doganore, kuotat, stimujt e eksportit e të tjera, por instrumenti që ka ndikim shumë të fortë në këtë politikë është kursi devizor, i cili mund të jetë lirisht i luhatshëm nëse formohet në treg, (nën ndikimin e ofertës dhe kërkesës në tregun devizor) ose, nga ana tjetër, të jetë fiks, i përcaktuar sipas ndonjë standardi objektiv (kundër disa valutave të huaja, zakonisht euro, dollar e të tjera). Më pas banka qendrore, nëpërmjet masave dhe instrumenteve, e mban kursin devizor në nivel të caktuar. Shumë shpesh në ekonomitë e pothuajse të gjitha vendeve, përdoret sistem i kombinuar i devizor. Ai formohet nën ndikimin e ofertës kërkesës në tregun devizor, por nëse ndodhin deformime të caktuara në vlerën e njësisë monetare vendase në raport me vlerën e valutave të huaja, banka qendrore ndërhyr për të parandaluar luhatjet në kursin devizor.

Politika e të ardhurave. E fundit nga katër politikat është politika e të ardhurave, e cila përdoret në kushtet e inflacionit të lartë. Më pas kjo politikë ndikon në kufizimin e rritjes së të ardhurave nominale në ekonomi: pagave, dividendëve, fitimeve, si dhe në çmimet e mallrave. Ndërmerren veprime për të arritur dy qëllime: për të parandaluar rritjen e lartë të inflacionit (rriten çmimet, pagat, ndërsa me këtë përsëri rriten çmimet) por edhe nëse reduktohen të ashtuquajturat kosto dezinflatore, si që janë PBB-ja, rritja e papunësisë dhe të ngjashme.

Kjo politikë nuk është shumë e popullarizuar në mesin e ekonomistëve, sepse përfaqëson ndërhyrjen e qeverisë në jetën ekonomike dhe pengon funksionimin e mekanizmit të tregut si alokuesi më efikas i burimeve. Kjo politikë nënkupton ngrirjen e pagave dhe çmimeve, kurse kështu ato pushojnë së qeni tregues real i mungesës së burimeve, mallrave dhe shërbimeve. Politika e të ardhurave zakonisht zbatohet si politikë plotësuese financiare dhe monetare.

¹ Jovanovski T. (1995) "Ekonomia monetare" "Prosvetno dello" Shkup

Termet kyç

- sistemi ekonomik
- politika ekonomike
- politika makroekonomike
- synimet e politikës makroekonomike
- instrumentet e politikës makroekonomike

Përmbledhje

- Sistemi ekonomik është tërësi e kushteve për ekonomizim, përkatësisht atyre kushteve të përcaktuara nga shteti me rregullime juridike dhe norma zakonore. Çdo sistem ekonomik ka rregulla dhe elemente bazë: marrëdhëniet e pronësisë, organizimi dhe menaxhimi me ndër-marrjet, operacionet e tregut, marrëdhëniet e punës dhe roli i shtetit në rregullimin e praktikës ekonomike. Ky element i fundit quhet edhe politikë ekonomike dhe përkufizohet si grup masash me të cilat autoritetet shtetërore i rregullojnë lëvizjet ekonomike, duke ndikuar kështu në praktikën ekonomike. Për shembull, politika fiskale dhe monetare, çmimet, të ardhurat, interesat, kreditë, importet, eksportet, buxhetin etj.
- Politika makroekonomike kujdeset për realizimin e katër qëllimeve themelore: arritjen e PBB-së më të lartë, shkallën e ulët të papunësisë, normën e ulët të inflacionit dhe shkëmbimin e pasur dhe të balancuar tregtar të vendit me vendet e huaja. Ekzistojnë llojet e mëposhtme të PBB-së: vlera e fituar – nominale kur të gjitha mallrat dhe shërbimet përfundimtare shumëzohen me çmimet aktuale; vlera e përftuar – reale kur mallrat dhe shërbimet përfundimtare vjetore shumëzohen me çmimet bazë – konstante nga një vit që ka normë të ulët inflacioni; vlera – faktike jep variacione afatshkurtra të prodhimit, gjatë një viti; vlera – potenciale jep prodhimin maksimal duke përdorur të gjitha inputet edhe gjatë qëndrueshmërisë së përgjithshme të çmimeve. Papunësia është problem i vështirë ekonomik me të cilin përballet çdo qeveri dhe mbajtja e inflacionit të ulët do të thotë të mbash nivelin e përgjithshëm të çmimeve të qëndrueshme, domethënë të mos bie fuqia blerëse e parasë. Së fundi, le të themi gjithashtu se politika makroekonomike synon ruajtjen e import-eksportit të balancuar dhe rrjedhimisht kurs devizor të qëndrueshëm – si çmim i monedhës vendase, i shprehur në monedhë të huaj.
- Për t'i realizuar synimet bazë makroekonomike, qeveria përdor katër grupe politikash si instrumente: politika fiskale (sistemi i të ardhurave publike dhe shpenzimeve publike); politika monetare (rregullimi i sasisë së parasë në qarkullim nga banka qendrore); politika e të ardhurave (ndikimi për uljen e inflacionit duke ngrirë pagat në sektorin publik dhe çmimet e produkteve bazë të jetës – që nuk është masë shumë e popullarizuar, konsiderohet si ndërhyrje e shtetit në ekonomi); politika e marrëdhënieve ekonomike me jashtë (ndikimi në vëllimin dhe strukturën e tregtisë së vendit me vendet e huaja).

Pyetje për kontrollimin e njohurive

1. Çfarë është sistemi ekonomik?
2. Si përcaktohet politika ekonomike?
3. Cilat janë qëllimet bazë makroekonomike?
4. Cilat janë instrumentet bazë makroekonomike?

Detyra për zbatimin praktik të njohurive

1. Diskutoni për sistemin ekonomik dhe politikën ekonomike!
2. Krahasoni qëllimet e politikës makroekonomike përmes diskutimit!
3. Shpjegoni dhe krahasoni instrumentet e politikës makroekonomike!

Kapitulli 2

Kërkesa agregate dhe oferta agregate

Përmbajtja:

1. Kërkesa agregate – AD (Aggregate Demand)
2. Oferta e përgjithshme – AS (Aggregate Supply)
3. Ekuilibri makroekonomik

Kur të përfundoni këtë kapitull, duhet të jeni në gjendje:

- të përcaktoni kërkesën agregate;
- të shpjegoni kërkesën agregate;
- të konstruktoni grafikun e kërkesës agregate;
- të shpjegoni efektet e kërkesës agregate;
- të përcaktoni ofertë agregate;
- të shpjegoni ofertën e përgjithshme në periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë;
- të konstruktoni grafikun e ofertës agregate në periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë;
- të shpjegoni ekuilibrin makroekonomik;
- të konstruktoni grafikun e ekuilibrit makroekonomik.

1. Kërkesa agregate – AD (Aggregate Demand)

Kjo është një nga kategoritë bazë ekonomike që është objekt studimi në makroekonomi. Përkufizohet si: **sasia e mallrave dhe shërbimeve të prodhuara përfundimtare, të cilat familjet, firmat, institucionet qeveritare dhe sektori i tregtisë së jashtme janë të gatshme dhe në gjendje t'i blejnë gjatë niveleve të ndryshme të përgjithshme të çmimeve.**

Pra, në ekonomi ka sektorë që kërkojnë, blejnë mallra dhe shërbime për të kënaqur nevojat e tyre.

Këto janë: **sektori i amvisërisë (C), sektori i ndërmarrjeve (I), sektori shtetëror (G), kurse sektori i tregtisë së jashtme (X-M).**

Prandaj, kërkesa agregate (kërkesa përmbledhur) AD e përbëjnë:

$$AD = C + I + G + (X-M)$$


Sektori i amvisërive (ekonomive familjare) e bën të ashtuquajturin *konsum personal* dhe konsumon larmi produktesh dhe shërbimesh, si: ushqim, veshmbathje, këpucë, banesa, teknik të bardhë, automjete, shërbime shëndetësore dhe arsimore etj.

Sektori i ndërmarrjeve (sektori i biznesit) bën *konsumin e investimeve* dhe konsumon mallra dhe shërbime të ndryshme me karakter investues, si: sallat e punës, hapësirat e zyrave, pajisjet, makineritë, veglat dhe të ngjashme.

Sektori shtetëror bën konsumin shtetëror (të përgjithshëm) dhe në thelb është konsumator përmes buxhetit, kurse në krahasim me sektorët e tjerë është një nga konsumatorët më të mëdhenj të mallrave dhe shërbimeve përfundimtare, shpenzon: ushqime, veshmbathje, këpucë për ushtrinë dhe policinë, armët, tanket, aeroplanët, lapsat, letrat për institucionet publike, pajisjet për spitalet, barnat dhe të ngjashme.

Së fundi, është **sektori i tregtisë së jashtme**, i cili realizohet nëpërmjet importit dhe eksportit të mallrave dhe shërbimeve më karakteristike. Ky sektor, si pjesë e AD, shprehet si neto eksport që mund të jetë pozitiv nëse eksportet tejkalojnë importet dhe negativ nëse importet tejkalojnë eksportet.

Më poshtë është paraqitja grafike e lakores AD:

Grafiku 1-1: Lakorja e kërkesës agregate

Grafiku tregon se lakorja AD ka pjerrësi në rënie. Kjo do të thotë se kur ka rënie të nivelit të përgjithshëm të çmimeve në ekonomi, konsumatorët do të rrisin konsumin, domethënë do të kenë nevojë për sasi më të vogël parash për të blerë të njëjtën sasi të mallrave dhe shërbimeve përfundimtare. Dhe anasjelltas: kur niveli i përgjithshëm i çmimeve rritet, konsumatorët do të realizojnë më pak AD, domethënë do të nevojiten më shumë fonde për të blerë të njëjtat sasi mallrash dhe shërbimesh. Ekonomistët e shpjegojnë këtë marrëdhënie në lëvizjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve dhe kërkesës agregate nëpërmjet veprimit të tre efekteve:

- efekti i pasurisë (Pigu);
- efekti i normës së interesit (Kejnz);
- efekti i kursit të këmbimit (Mandel, Fleming).

Të gjitha efektet janë rezultat i ndryshimeve të lëvizjeve të çmimeve, ndërsa në AD ndryshimi i G jepet si konstante, kështu që komponentët e tjerë të AD ndryshojnë dhe me ndryshimet e çmimit ndodhin këto tre efekte:

Efekti i pasurisë së ekonomistit Pigu (1877-1959). Ai thelbin e efektit të pasurisë e paraqet si më poshtë: Vlera nominale e sasisë së parave në dispozicion të konsumatorëve është madhësi konstante, por vlera reale e saj është e ndryshueshme në varësi të nivelit të përgjithshëm të çmimeve. Kur ato bien, konsumatorët kanë nevojë për më pak para për të blerë mallra dhe shërbime përfundimtare, kështu që një pjesë e parave në dispozicion të tyre mbeten të pashpenzuara.

Duke vepruar kështu, ata fitojnë ndjenjën, përshtypjen se janë më të pasur dhe veprojnë në rritjen e kërkesës agregate.

Efekti i normës së interesit u prezantua nga ekonomisti Xhon Majnard Kenz (1883-1946). Ai thotë: Nëse niveli i përgjithshëm i çmimeve bie, kjo u jep konsumatorëve mundësinë të shpenzojnë më pak nga paratë e tyre në dispozicion për blerjen e mallrave dhe shërbimeve përfundimtare. Pjesa tjetër e parave, gjegjësisht teprica, familjet mund të investojnë, t'i depozitojnë në banka

dhe të tërheqin interes mbi këtë bazë. Pra, tani bankat komerciale, përmes fondeve të investuara me to, rrisin mundësitë e kreditimit, ulin normat e interesit dhe ofrojnë kredi të lira. Klientët e tyre i përdorin këto përfitime për të inkurajuar aktivitetet e tyre investuese, duke vepruar kështu në rritjen e kërkesës agregate.


Efekt i kursit devizor u zbulua dhe u prezantua nga ekonomistët Robert Mandel dhe Marius Fleming. Thelbi i këtij efekti është si vijon: Kur niveli i përgjithshëm i çmimeve bie, ai shkakton efektin e pasurisë dhe efektin e normës së interesit, kurse më tej ato bëjnë që kursi devizor të bie. Pra, ajo që ka norma interesi më të ulëta do t'i bëjë investitorët vendas të kërkojnë vendosje më fitimprurëse për kapitalin e tyre, ata mund të shesin obligacione vendase dhe të blejnë obligacione të huaja që kanë interes më të lartë. Kështu, më shumë para vendase do të vijnë në tregun e brendshëm që të mund të përdoren për të blerë para të huaja, në mënyrë që të investohen në obligacione të huaja. Me këtë oferta më e madhe e valutës vendase do të shkaktojë ulje të vlerës përfundimtare në raport me njësitë monetare të huaja, me çka produktet vendase bëhen më të lira për të huajt, pra stimulohen eksportet, që në fund të ketë rritje të neto eksportit dhe rritje e kërkesës agregate.²

2. Oferta e përgjithshme – AS (Aggregate Supply)

Oferta agregate – AS paraqet marrëdhënien ndërmjet nivelit të përgjithshëm të çmimeve dhe sasisë totale të mallrave dhe shërbimeve që sektori i ndërmarrjeve është i gatshëm dhe i aftë të ofrojë.

Që ta shpjegojmë ofertën agregate, përsëri, si edhe tek kërkesa agregate, duhet të bëjmë paraqitje grafike të lëvizjes së nivelit të përgjithshëm të çmimeve dhe sasisë së mallrave të ofruara, kurse kështu të shpjegojmë se në cilin drejtim lëviz lakorja AS. Ky rishikim bëhet në periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë.

Grafiku 1-2: Lakesa e ofertës agregate të shkurtër




² Fiti T. (2002) “Hyrje në mikroekonominë bashkëkohore”, Fakulteti Ekonomik, f.16

Oferta agregate në periudhë afatshkurtër është vijë e drejtë me pjerrësi në rritje, ndërsa në periudhë afatgjate bëhet më e pjerrët për t'u shndërruar përfundimisht në lakore vertikale, e cila është vetëm dëshmi *se ekonomia në periudhë afatgjate funksionon në nivelin e potencialit bruto prodhimit vendor*. Ja shpjegimi për këtë lëvizje (të ofruar nga ekonomistët kejnzian). Gjegjesisht, ata pretendojnë se në afat të shkurtër çmimet dhe pagat janë fikse, jofleksibile, gjegjesisht të pandryshuara lart e poshtë. Kjo është kështu. Pagat e punëtorëve në periudhë afatshkurtër përcaktohen me marrëveshje të mëparshme ndërmjet sindikatave të punëtorëve dhe punëdhënësve. Negociatat përfundojnë, kontratat janë nënshkruar për paga fikse nga një deri në tre vjet. Ngjashëm është edhe me çmimet e lëndëve të tjera të para, të cilat nevojiten për realizimin e prodhimit. Ndërmarrjet gjithashtu lidhin kontrata me furnizuesit e lëndëve të para dhe furnizimeve për t'i furnizuar ato me çmime fikse në periudhë afatshkurtër. Prandaj, këto kosto për ndërmarrjet prodhuese janë fikse, kështu që çdo rritje në nivelin e përgjithshëm të çmimeve sjell më shumë fitim nëse ato furnizojnë sasi më të mëdha të mallrave. Kjo për ato është nxitje për të ofruar mallra dhe shërbime përfundimtare, për të shitur me çmime më të larta dhe për të rritur fitimet e tyre. Kjo është paraqitur në Grafikon 2, ku rritja e çmimeve nga niveli 50 në nivelin 75 do të shkaktojë rritje të fortë të prodhimit nga 30 në 40 miliardë denarë.

Për shkak të kësaj, lakorja e ofertës agregate në periudhë afatshkurtër ka pjerrësi të lehtë dhe është e anuar djathtas. Gjithashtu, gjatë asaj periudhe, në pjesën fillestare të lakores AS ka shumë faktorë të lirë, të paangazhuar të prodhimit, të cilët tani mund të përdoren për të rritur prodhimin.

Grafiku 1-3: Lakorja e ofertës agregate në periudhë afatgjatë



Në periudhë afatgjatë, lakorja AS është më e pjerrët dhe definitivisht shndërrohet në vijë vertikale, e cila është në nivelin e prodhimit të brendshëm bruto potencial. Domethënë, në periudhë afatgjate pagat dhe çmimet bëhen fleksibël, sepse kohëzgjatja e kontratave ka përfunduar, prandaj nevojiten negociata të reja.


Në negociata sindikatat do të kërkojnë rritje rrogash, ndërsa furnitorët do të kërkojnë në kontratë çmime më të larta për lëndët e para. Kështu, kompanitë do të kenë kosto më të larta, të cilat do të rriten me rritjen e ofertës, kështu që nuk do të paguajnë që në të ardhmen të ofrojnë sasi më të mëdha mallrash dhe shërbimesh, edhe pse niveli i përgjithshëm i çmimeve është në rritje. AS do të ngeçë dhe në periudhë afatgjate do të mbetet në nivelin e PBB-së potenciale. Aty do të mbahet për shkak të burimeve tashmë të shfrytëzuara dhe pamundësisë së kompanive për të ofruar një ofertë më të lartë.

3. Ekuilibri makroekonomik

Çështja që e lidh kërkesën agregate dhe ofertën agregate është vendosja e ekuilibrit makroekonomik.

Ekulibri makroekonomik ekziston në pikën ku lakorja e kërkesës agregate (AD) kryqëzohet me lakoren e ofertës agregate (AS). Pra, pika në të cilën sektorët aktualë individualë të konsumit (familja, biznesi, sektori shtetëror dhe sektorët e jashtëm), si blerës të mallrave dhe shërbimeve përfundimtare, në nivelin ekzistues të përgjithshëm të çmimeve kërkojnë pikërisht atë sasi të prodhimit agregat (mallrat përfundimtare dhe shërbimet) që sektori i ndërmarrjeve është i gatshëm të ofrojë në të njëjtin nivel të përgjithshëm çmimesh. Ky ekuilibër makroekonomik, si ekuilibri E, mund të përcillet në Grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 1-4: Ekuilibri makroekonomik



Në pikën E, kryqëzohen lakoret AD dhe AS, d.m.th. me një nivel çmimi prej indeksit 100 dhe bruto prodhim real prej 50 miliardë denarë.

Ky bilanc makroekonomik është statik, fiks, por mund të prishet nga disa pengesa të faktorëve që e ndryshojnë AD dhe AS, në mënyrë që të vendoset në ndonjë pikë të re E1, në nivel më të lartë ose më të ulët.

Termet kyç

- kërkesa agregate
- lakorja e kërkesës agregate
- oferta agregate
- lakorja e ofertës agregate
- ofertë agregate afatshkurtër dhe afatgjatë
- bilanci makroekonomik

Përmbledhje

- Kërkesa agregate AD përkufizohet si sasia e mallrave dhe shërbimeve të prodhuara përfundimtare, të cilat sektorët e ekonomisë (familjet, firmat, institucionet shtetërore dhe sektori i tregtisë së jashtme) janë gati dhe në gjendje t'i blejnë dhe t'i konsumojnë në nivele të ndryshme të përgjithshme çmimesh. $AD = C + I + G + (X - M)$. Lakorja AD ka pjerrësi në rënie, kur çmimet rriten, kërkesa agregate bie dhe anasjelltas. Marrëdhënia ndërmjet kërkesës dhe nivelit të përgjithshëm të çmimeve shpjegohet nga tre efekte: efekti i pasurisë, efekti i normës së interesit dhe efekti i kursit devizor.
- Oferta agregate AS përfaqëson marrëdhënien ndërmjet nivelit të përgjithshëm të çmimeve dhe sasisë totale të mallrave dhe shërbimeve që sektori i ndërmarrjes është i gatshëm dhe në gjendje të ofrojë. Lakorja AS në periudhë afatshkurtër ka pjerrësi rritëse, ndërsa në periudhë afatgjatë është vertikale në nivelin e PBB-së potenciale.
- Detyrë shumë e rëndësishme për çdo ekonomi është vendosja e ekuilibrit makroekonomik në marrëdhëniet e ofertës dhe kërkesës – pika ku kryqëzohen lakoret e AD dhe AS, domethënë, aq sa kërkohet nga sektorët, aq shumë ofrohet nga agregati, oferta në një nivel të caktuar të përgjithshëm çmimesh. Por ky ekuilibër çrregullohet nga disa goditje si nga ana e AD-së ashtu edhe nga ajo e AS-së.

Pyetje për kontrollimin e njohurive

1. Çfarë është kërkesa agregate?
2. Shpjegoni tre efektet e AD-së!
3. Pse lakorja AD ka një pjerrësi në rritje?
4. Çfarë është oferta agregate?
5. Sa është pjerrësia e lakores AS në periudhë afatshkurtër dhe sa është pjerrësia në periudhë afatgjate?
6. Përcaktoni ekuilibrin makroekonomik!

Detyra për zbatimin praktik të njohurive

1. Konstruktioni grafik për të treguar lëvizjen e AD-së nëse niveli i përgjithshëm i çmimeve në ekonomi ulet!
2. Lakorja AS në periudhë afatgjate është vijë vertikale. Shpjegoni se çfarë do të ndodhë me AS nëse, për shkak të masave të qeverisë për parandalimin e inflacionit, niveli i përgjithshëm i çmimeve fillon të bjerë!
3. Shpjegoni se si dhe pse lakorja AS rritet në periudhë afatshkurtër dhe është vijë vertikale në periudhë afatgjate!
4. Tregoni grafikisht ekuilibrin makroekonomik!

Kapitulli 3

Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) dhe alokimi i dedikuar i PBB-së

Përmbajtja:

1. Koncepti dhe thelbi i PBB-së
2. Metodatat e llogaritjes së PBB-së
3. PBB nominale dhe reale
4. Shpërndarja me qëllim i PBB-së

Kur të përfundoni këtë kapitull, duhet të jeni në gjendje:

- të përcaktoni prodhimin e brendshëm bruto (PBB);
- të njihni karakteristikat e PBB-së;
- të llogaritni PBB-në sipas metodës së shumës së vlerës së mallrave dhe shërbimeve përfundimtare;
- të llogaritni PBB-në sipas metodës së shumës së shpenzimeve për inputet e faktorëve të prodhimit;
- të dalloni PBB-në nominale dhe reale;
- të llogaritni PBB-së reale përmes deflatorit të PBB-së;
- të shpjegoni llojet e shpërndarjes së PBB-së;
- të shprehni strukturën e shpërndarjes së qëllimshme.

1. Koncepti dhe thelbi i PBB-së

Një nga kategoritë më të rëndësishme makroekonomike është Prodhimi i Brendshëm Bruto (GDP)-PBB (Gross Domestic Product). Ai është treguesi më sintetik i aktivitetit të përgjithshëm ekonomik në një vend. Ekonomistët e përkufizojnë atë si:

Shuma e vlerës së totalit të mallrave dhe shërbimeve të prodhuara përfundimtare në një vend gjatë një viti.

Nga kjo mund të nxirren disa karakteristika të PBB-së, përmes të cilave mund të shpjegohet thelbi i saj:

1. PBB është shuma e vlerës së mallrave dhe shërbimeve përfundimtare. Në çdo vend, ekonomia prodhon një sërë mallrash dhe shërbimesh që janë sipas cilësisë; të ndryshme. Do të thotë se po krijohen miliarda mallra dhe shërbime të ndryshme që nuk mund të shprehen në tregues fizikë natyrorë, prandaj duhet gjetur ndonjë masë dhe tregues i përbashkët. Kjo arrihet duke shumëzuar mallrat dhe shërbimet me sasinë totale të tyre. Duke vepruar kështu, fitohet vlera e tregut të prodhimit të përgjithshëm në nivel të ekonomisë së përgjithshme.

2. PBB është masë e mallrave dhe shërbimeve totale të prodhuara. PBB jep vlerën e të mirave materiale për të plotësuar nevoja të ndryshme (ushqim, këpucë, strehim), kurse të mira materiale që përdoren për të përmbushur nevojat shpirtërore (filma, libra etj.), por edhe shërbime (arsimore, shëndetësore dhe të ngjashme). Pra, të gjitha këto mallra dhe shërbime janë me ndonjë vlerë tregu dhe janë pjesë e PBB-së.

3. PBB është shuma e vlerës së mallrave dhe shërbimeve përfundimtare. Një pjesë e madhe e asaj që prodhohet në ekonomi si mallra dhe shërbime janë vetëm lëndët e para, të ndërmjetme, të cilat më pas përdoren për të prodhuar mallra dhe shërbime të tjera. Kështu, për shembull, mielli përdoret për të bërë bukë, leshi për të bërë pulovra, letra për të bërë libra etj. Mielli, leshi dhe letra janë mallra ndërmjetëse, ndërsa buka, pulovra dhe libri janë mallra përfundimtare dhe vetëm ato, pra vlera e tyre, përfshihen në vlerën e PBB-së. Kështu shmanget llogaritja e dyfishtë e vlerës së produkteve të reja.

4. PBB përfshin mallrat dhe shërbimet e prodhuara gjatë vitit. Në llogaritjen e PBB-së përfshihen vetëm mallrat dhe shërbimet të prodhuara përfundimtare në vitin aktual, jo ato të viteve të mëparshme. Përkufizimi thotë se PBB-ja është masë e vlerës së mallrave dhe shërbimeve totale për një periudhë njëvjeçare.

5. PBB përfshin vetëm prodhimin legal. Kjo veçori synon ato mallra dhe shërbime që janë të vlefshme në tregjet legale dhe të organizuara, kurse jo ato që quhen ekonomi gri dhe e zezë (veprimtaritë e paregjistruara me drogë, armë, njerëz etj.).

Në fund, duhet theksuar se në PBB nuk përfshihen ato mallra dhe shërbime që prodhohen brenda amvisërive dhe janë të destinuara për anëtarët e familjes (përgatitja e ushqimit për anëtarët

në shtëpi, pastrimi i banesës, larja etj.). Këto mallra dhe shërbime nuk vlerësohen në treg dhe nuk janë objekt transaksioni.

2. Metodatat e llogaritjes së PBB-së

Në ekonomi ekzistojnë metoda bazë me të cilat llogaritet PBB:

1. PBB si shuma e vlerës së mallrave dhe shërbimeve përfundimtare;
2. PBB si shuma e shpenzimeve të inputeve të angazhuara të prodhimit.

PBB si shuma e vlerës së mallrave dhe shërbimeve përfundimtare. Këtë mënyrë llogaritjeje e shpjegojmë përmes pyetjes, kush i konsumon mallrat dhe shërbimet përfundimtare? Kur folëm për AD thamë se mallrat dhe shërbimet përfundimtare në vend konsumohen në katër sektorët e ekonomisë: *sektori familjar (S)*, *sektori i ndërmarrjeve – sektori i biznesit (I)*, *sektori qeveritar (G)* dhe *sektori i tregtisë së jashtme (X-M)*. Kështu fitojmë se:

$$GDR = C + I + G + (X-M)$$

(S) – Sektori i amvisërive është konsumatori më i madh i mallrave dhe shërbimeve përfundimtare në ekonomi, duke përfshirë ushqimin, veshmbathjen, strehimin, teknikën e bardhë dhe shumë shërbime të tjera. (arsim, shëndetësi, etj.).

(I) – Sektori i ndërmarrjeve është konsumator i mallrave përfundimtare duke investuar në objekte, pajisje, mjete, vegla e të ngjashme, si fonde kapitale, por edhe në këmbim të atyre të konsumuara, si dhe investon në rezerva të lëndëve të para, materialeve, ndërmjetës dhe të ngjashme.

(G) – Sektori shtetëror, pra buxheti shpenzon mallra dhe shërbime përfundimtare për shtetin, organet dhe institucionet publike në fushën e administratës shtetërore, ushtrisë, shëndetësisë, shkencës, kulturës etj.

(X-M) – Sektori i tregtisë së jashtme siguron eksportin neto, që do të thotë se përdor PBB (GDP-në) e tjerëve përmes importeve, ndërsa një pjesë e PBB-së tonë shkon në vendet e tjera përmes eksporteve. Nëse importet janë më të mëdha se eksportet, ai është negativ (-) eksport neto, kurse anasjelltas, eksporti më i madh se importi është eksport neto pozitiv (+).

PBB si shuma e shpenzimeve të inputeve të angazhuara të prodhimit. Në aktivitetet e tyre të përditshme, ndërmarrjet duhet të angazhojnë inpute, gjegjësisht faktorë të prodhimit për të kryer procesin e punës. Dhe këta faktorë (puna, kapitali, toka dhe sipërmarrja) i kanë pronarët dhe çmimet e tyre. Pra, ndërmarrjet ua paguajnë çmimet e këtyre faktorëve të pronarëve të tyre dhe kështu bëjnë harxhime. Domethënë, ata paguajnë rroga për punën e punëtorëve, interes për kapitalin, qira për tokën dhe fitim për sipërmarrësit. Nëse i mbledhim këto harxhime të ndërmarrjes për faktorët e prodhimit të punësuar në nivelin e ekonomisë së përgjithshme të vendit, fitojmë kategori që ekonomistët e quajnë të ardhura nacionale.

$$\text{paga} + \text{interes} + \text{qira} + \text{ftim} = \text{të ardhura nacionale}$$

Por me këtë ende nuk kemi arritur madhësinë e PBB. Në ekonomi akoma ka shpenzime që i shtohen të ardhurave nacionale. Shpenzimet e tilla janë taksat indirekte (TVSH, akcizat), të cilat e legalizojnë prodhimin. Tani kemi një kategori të quajtur **prodhimi i brendshëm neto**.

$$\text{të ardhurat nacionale} + \text{taksat indirekte} = \text{prodhimi i brendshëm neto}$$

Kësaj kategorie i shtohet edhe shuma e amortizimit të mjeteve të punës – makinerive dhe me këtë rrumbullakoset madhësia e shpenzimeve të grumbulluara dhe fitohet vlera e bruto prodhimi vendor:

$$\text{prodhimi i brendshëm neto} + \text{amortizimi} = \text{prodhimi i brendshëm bruto}$$

Kësaj kostoje të fundit i shtohet me qëllim që realisht të tregohet pjesa e shpenzuar e investimeve bruto, të cilat bëhen jo vetëm për furnizimin e fondeve të reja kapitale, por edhe për zëvendësimin e fondeve të kapitalit të shpenzuar.

Me këtë përlllogaritje të PBB-së sipas kësaj metode, është pothuajse identike me atë të llogaritur sipas metodës së mallrave dhe shërbimeve përfundimtare.

3. Prodhimi i brendshëm bruto nominal dhe real.

Në kapitullin e parë i numëruam dhe përcaktuam llojet bazë të prodhimit të brendshëm bruto. Në këtë kapitull do të shpjegojmë më në detaje ndryshimin mes tyre.

Prodhimi i brendshëm bruto nominal fitohet kur mallrat dhe shërbimet të prodhuara përfundimtare në vitin aktual shumëzohen me çmimet e tregut në atë vit. Këto çmime gjithashtu quhen edhe çmime aktuale, kurse përkufizimi i prodhimit të brendshëm bruto nominal do të ishte:

Prodhimi i brendshëm bruto nominal përfaqëson vlerën e përgjithshme të mallrave dhe shërbimeve të prodhuara përfundimtare në ekonomi të shprehur në çmime aktuale.

Në përkufizim kemi përdorur termin çmime aktuale, gjegjësisht çmimet e vitit për të cilin jemi duke llogaritur. Ato në vetvete përfshijnë ndikimin e inflacionit. Pra, nëse në një vit të caktuar norma e inflacionit është 25%, atëherë rritja e përgjithshme e nivelit të çmimeve në ekonomi është 25%. Kur vendosëm ne, kemi përdorur çmimet aktuale në përlllogaritje, kurse kjo përfshin inflacionin në madhësinë e prodhimit të brendshëm bruto, kurse ai mund të jetë më i lartë, jo vetëm si rezultat i prodhimit më të madh të mallrave dhe shërbimeve, por edhe si rezultat i çmimeve më të larta nga

inflacioni. Ndonjëherë PBB-ja më e lartë mund të merret vetëm nga çmimet e larta nga inflacioni, ndërsa sasia reale e mallrave dhe shërbimeve të prodhuara përfundimtare madje mund të zvogëlohet në krahasim me periudhën e fundit. Për shembull, një kompani prodhuese vitin e kaluar prodhoi 150,000 çanta me një çmim prej 30 njësi monetare. Me këtë ka realizuar 4.500.000 njësi monetare të të ardhurave totale. E njëjta ndërmarrje në vitin aktual ka prodhuar 40.000 thasë më pak (d.m.th. ka prodhuar 110 000 thasë), por në të njëjtën kohë gjatë vitit, për shkak të inflacionit prej 50%, thasët janë rritur në 45 njësi monetare për thes, me çka ndërmarrja realizoi të ardhura nominale prej 4,950,000 njësi monetare. Kjo tregon se kompania edhe pse prodhonte sasi më të vogël mallrash (çanta), prapëseprapë, për shkak të çmimeve më të larta se inflacioni, shfaqti rritje më të madhe në realizimin e 4.500.000 njësi monetare në 4,950,000 njësi monetare Megjithatë, kjo rritje nuk është reale. Është rezultat i rritjes së nivelit të përgjithshëm të çmimeve. Kjo është e mundur edhe në nivelin e gjithë ekonomisë (për shkak të efektit të inflacionit). Prandaj themi se prodhimi i brendshëm bruto nominal nuk është tregues real i prodhimit total në ekonomi. Prandaj, llogaritet lloji i dytë i PBB-së – i ashtuquajturit prodhimi i brendshëm bruto real.

Prodhimi i brendshëm bruto real përfaqëson vlerën e totalit të mallrave dhe shërbimeve të prodhuara përfundimtare në ekonomi të shprehur përmes çmimeve të përhershme, konstante, bazë.

Si tregues, PBB-ja reale është e liruar nga efektet e inflacionit. Çfarë do të thotë dhe si llogaritet? E fitojmë kur sasia totale e prodhuar e mallrave dhe e shërbimeve në vitin aktual, për shembull, 2022, shumëzohet me çmimet e vitit 2019, të cilat merren si konstante, bazë (pasi viti 2019 merret si vit bazë). Gjithashtu, PBB-ja reale për vitin 2022 do të llogaritet duke shumëzuar sasinë e mallrave dhe shërbimeve të vitit 2022 të prodhuara me çmimet e tyre të vitit 2019.

Sipas kësaj, bruto-prodhimi i brendshëm real reflekton ndryshime në prodhimin e përgjithshëm në ekonomi që janë rezultat i ndryshimeve në sasinë e mallrave dhe shërbimeve të prodhuara, kurse jo edhe rezultat i ndryshimeve në çmimet e mallrave dhe shërbimeve.

Prodhimi real kombëtar bruto mund të llogaritet edhe nëpërmjet të ashtuquajturit PBB deflatorit:

Deflatori i PBB-së tregon nivelin e çmimeve në vitin aktual në raport me nivelin e çmimeve të një viti më parë.

Niveli i çmimeve, përkatësisht ndryshimet në nivelin e përgjithshëm të çmimeve, maten përmes indeksit të çmimeve. Në ekonomi më shpesh përdoret i ashtuquajturit indeks i çmimeve të konsumit (Consumer Price Index – CPI).

Nëse, për shembull, niveli i përgjithshëm i çmimeve në vitin e kaluar e kemi shënuar me indeksin 100 dhe çmimet e vitit aktual janë rritur me 40%, indeksi i rritjes së çmimeve do të jetë 140. Tani

140 do të pjesëtohet me 100, do të fitohet 1,4 – ky është PBB deflatori. Për më tepër, PBB reale do të merret kur prodhimi i brendshëm bruto nominal pjesëtohet me deflatorin e PBB-së:

$$\text{PBB reale} = \frac{\text{PBB nominale}}{\text{Deflatori i PBB}}$$

Ja një shembull se si llogaritet PBB-ja reale. PBB nominale për vitin 2017 është më e lartë dhe arrin 550 miliardë njësi monetare. Le të supozojmë se rritja e çmimeve (norma e inflacionit) në vitin 2017, krahasuar me vitin 2016, është 2% dhe nëse indeksi i çmimeve në vitin 2016 shënohet me 100, atëherë indeksi i çmimeve në vitin 2017 do të jetë 102. PBB– deflatori do të merret kur 102 njësi mmonetare do të pjesëtohen me 100 dhe është e barabartë me 1.02

$$\text{PBB deflatori} = \frac{102}{100} = 1,02$$

Dhe nëse këto madhësi i zëvendësojmë në formulën për PBB-në reale, do të fitojmë:

$$\text{PBB-reale} = \frac{\text{PBB-nominale}}{\text{PBB-deflatori}} = \frac{550}{1,02} = 539,215$$

Një përlllogaritje e tillë tregon se PBB-ja nominale në vitin 2017 është më e lartë dhe arrin në 550 miliardë njësi monetare në raport me PBB-në reale, që është 539,215 miliardë njësi monetare, por kjo e fundit është reale dhe e besueshme, sepse përjashton inflacionin dhe jep pasqyrën e vërtetë të sasive të prodhuara të mallrave dhe shërbimeve. Kur PBB-ja reale pjesëtohet me numrin e banorëve, fitohet PBB per capita (PBB për kokë banori).

4. Shpërndarja e dedikuar e PBB-së

Që të plotësohen nevojat, pra për të realizuar konsumin, duhet fillimisht të shpërndahet prodhimi i krijuar. Duke studiuar shpërndarjen, duhet t'i jepet përgjigje njëjës prej pyetjeve themelore të ekonomisë – për kë prodhohet, pra si, mbi çfarë parimesh shpërndahet ajo që prodhohet.

Në kushtet e ekonomisë së orientuar nga tregu, zgjidhja e kësaj çështje i lihet tregut, por roli i shtetit dhe politika e tij e shpërndarjes është i rëndësishëm. Kështu nëpërmjet buxhetit rishpërndan të ardhurat e krijuara në shtet dhe në këtë mënyrë siguron fonde për funksionimin e institucioneve publike shtetërore.

Shpërndarja mund të shihet nga disa aspekte:

1. Njëri aspekt është shpërndarja që kryhet në treg ndërmjet prodhuesve të mallrave dhe shërbimeve bazuar në parimet e tregut. Kjo shpërndarje kryhet në bazë të cilësisë, asortimentit dhe mbi të gjitha në bazë të shpenzimeve, çmimeve dhe anasjelltas, në bazë të suksesit të tregut, kurse e shpreh përvetësimin e të ardhurave në tregun e ndërmarrjeve. Më pas shërben si bazë për shpërndarjen dhe rishpërndarjen e mëtejshme.

2. Lloji tjetër ose aspekti tjetër i shpërndarjes është kur të ardhurat e krijuara përcaktohen për nevoja të caktuara, pra për përcaktimin e pjesëve të PBB-së në një vit: kënaqësia e personale d.m.th. për konsumin individual të qytetarëve dhe familjeve (C), për kursimet dhe investimet e kompanive dhe qytetarëve (I), për konsumatorët shtetërorë (G), një pjesë shkon për rezervat dhe një pjesë për eksportet neto (X-M). Në publikimet e Entit Shtetëror të Statistikës të RMV, ky aspekt i shpërndarjes shprehet përmes parimit të shpenzimeve të formimit të PBB-së.

$$PBB = C + I + G + (X-M)$$

Ose në shkrimin cirilik si shpërndarje e dedikuar e PBB-së.

$$PBB = LP + BI + JP + (\text{Eksport-Import})$$

Në kushtet e sistemit ekonomik të orientuar nga tregu, siç po ndërtohet sot në RMV, shpërndarja për nevoja individuale është, para së gjithash, rezultat i vendimeve të pavarura të subjekteve ekonomike, por tashmë nën ndikimin dhe zbatimin e vërtetë të parimeve të tregut.

Këtu, si shembull, janë disa të dhëna për shpërndarjen e dedikuar të PBB-së në vitin 2020 në RMV. Sipas të dhënave të ESHS-së të marra nga llogaritë vjetore të subjekteve afariste dhe burime të tjera, PBB-ja në vitin 2020 arrin në 655,931 milionë denarë dhe në krahasim me vitin 2019, në aspekt nominal është ulur për 5,3%. Norma reale e rritjes së PBB-së në vitin 2020, krahasuar me vitin 2019, është -6.1%. Sektorët me peshën më të madhe të vlerës së shtuar në strukturën e PBB-së në vitin 2020 janë: (E; ZH dhe Z) Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave; Transporti dhe magazinimi; Objektet për akomodim dhe aktivitete të shërbimit ushqimor (19.2%).

Konsumi final në vitin 2020 përbënte 83,9% në strukturën e PBB-së. Konsumi final i familjeve, përfshirë institucionet jofitimprurëse që u shërbejnë familjeve, në vitin 2020 ulet në aspekt nominal me 2.7%, kurse pjesëmarrja në strukturën e prodhimit të brendshëm bruto arrin në 67.3%.

Pjesëmarrja e eksportit të mallrave dhe shërbimeve në strukturën e PBB-së në vitin 2020 është 58.9%. Mbulimi i importeve me eksporte është 76.1%, d.m.th. në vend (sipas ESHS) ekziston deficit tregtar (importet janë më të mëdha se eksportet).

Vlera e investimeve në mjete fikse në vitin 2020 është 144.779 milionë denarë. Në strukturën teknike të investimeve në mjetet bazë, punimet ndërtimore zënë 58.5%, makineritë dhe pajisjet me 31.4%, kurse investimet e të tjera me 10.1%.

Termet kyç

- Prodhimi i Brendshëm Bruto
- mallrat përfundimtare
- ndërmjetësit
- të ardhurat nacionale
- prodhimi i brendshëm neto
- PBB nominale
- PBB reale
- PBB-ja aktuale
- PBB potenciale
- Deflatori i PBB-së
- shpërndarje e dedikuar

Përmbledhje

- Prodhimi bruto i brendshëm është shuma e vlerës së totalit të mallrave dhe shërbimeve të prodhuara në një vend gjatë një viti. Është shuma e vlerës së mallrave dhe shërbimeve përfundimtare, masë e totalit të mallrave dhe shërbimeve të prodhuara, shuma e vetëm e vlerës së mallrave dhe shërbimeve përfundimtare, jo e ndërmjetësve, e përfshinë vetëm në prodhimin legal dhe prodhimin vetëm të një viti.
- Ekzistojnë dy metoda të llogaritjes së PBB-së. PBB si shuma e vlerës së mallrave dhe shërbimeve përfundimtare (konsumi sipas sektorëve) dhe PBB si shuma e shpenzimeve të inputeve të angazhuara të prodhimit.
- PBB nominale dhe reale janë tregues që përdoren në analizat për krahasimin e zhvillimit ekonomik. Për llogaritjen e PBB-së reale përdoret edhe treguesi PBB-deflator, i cili e tregon nivelin e çmimeve në vitin aktual në raport me nivelin e çmimeve të një viti më parë. PBB nominale e ndarë me deflatorin e PBB e jep PBB-në reale.

- Çështja për shpërndarjen e PBB-së është e rëndësishme për të qenë në gjendje të bëhet konsumimi dhe plotësimi i nevojave në ekonomi. Dallojmë disa lloje të shpërndarjes: (alokim) shpërndarje e dedikuar, funksionale, e brendshme. Rëndësi të veçantë për ekonominë ka shpërndarja e dedikuar, që nënkupton përcaktimin e qëllimeve për të cilat do të përdoren mallrat dhe shërbimet, pra kjo shpërndarje tregon se PBB është e destinuar për harxhime materiale në kompani, për konsum personal dhe publik, për rezerva, importe dhe eksporte. Në atë shpërndarje një pjesë të madhe prej (30%-45%) e zë konsumi publik.

Pyetje për kontrollimin e njohurive

1. Përcaktoni PBB-në!
2. Cilat janë karakteristikat thelbësore të PBB-së?
3. Cilat janë dy metodat e llogaritjes së PBB-së?
4. Si llogaritet PBB si shuma e vlerës së mallrave dhe shërbimeve përfundimtare?
5. Cilët sektorë janë konsumatorë?
6. Çfarë është eksporti neto dhe si mund të jetë ai?
7. Si llogaritet PBB si shuma e shpenzimeve të inputeve të përdorura në prodhim?
Shpjegoni!
8. Çfarë është shpërndarja e dedikuar e PBB-së?
9. Shkruani formulën e shpërndarjes së dedikuar!

Detyra për zbatimin praktik të njohurive

1. Sa është PBB-ja reale nëse PBB-ja nominale është 400 miliardë njësi monetare dhe norma e inflacionit është 3% (llogaritja duhet të bëhet me PBB – deflator)?
2. Duke hulumtuar të dhënat nga ESHS, bëni analizë të strukturës së PBB-së në RMV në vitin aktual!

Njësia modulare 2

Rritja dhe zhvillimi i ekonomisë

Rezultatet nga mësimi

Nxënësi do të jetë në gjendje:

- **Të shpjegojë rritjen ekonomike dhe dallon fazat e ciklit ekonomik**
- **Të përshkruajë konsumin, kursimet, investimet**
- **Të diferencojë llojet e papunësisë dhe shkaqet e papunësisë**

Kapitulli 1

Rritja ekonomike dhe fazat e ciklit ekonomik

Përmbajtja:

1. Rritja dhe zhvillimi ekonomik
2. Faktorët për zhvillimin ekonomik
3. Cikli ekonomik

Kur të përfundoni këtë kapitull, duhet të jeni në gjendje:

- të përkufizoni rritjen dhe zhvillimin ekonomik;
- të llogaritni shkallën e zhvillimit ekonomik sipas të dhënave të dhëna;
- të deklaroni rregullin 70;
- të përshkruani kapitalin fizik, kapitalin njerëzor, burimet natyrore dhe progresin tekniko-teknologjik si faktorë të zhvillimit;
- të përcaktoni ciklin ekonomik;
- të shpjegoni fazën e zgjerimit të ciklit ekonomik;
- të shpjegoni fazën e recesionit të ciklit ekonomik;
- të vizatoni-konstruktoni grafikun për ciklin ekonomik.

1. Rritja dhe zhvillimi ekonomik

Të gjitha aktivitetet e ndërmarrë nga subjektet ekonomike në realizimin e qëllimeve të tyre, në fund të fundit japin gjendjen e rritjes së treguesve ekonomikë nëse kanë tendencë – në drejtim pozitiv të lëvizjes – tregojnë rritje dhe zhvillim.

Rritja ekonomike në fakt përfaqëson rritje sasiore të PBB-së potenciale të ekonomisë me kalimin e kohës.

Në kapitujt e mëparshëm shpjeguam se PBB-ja është treguesi më sintetik i aktivitetit të përgjithshëm ekonomik në një vend. Kur duam të shpjegojmë rritjen ekonomike, duhet të kemi parasysh PBB-në aktuale dhe potenciale. PBB-në aktuale, që cila është PBB reale e realizuar në një vit, na i tregon ndryshimet dhe variacionet nga viti në vit, kurse PBB-ja potenciale, e cila reduktohet në tendencën afatgjatë të PBB-së aktuale, na tregon mundësinë e ekonomisë për prodhimin maksimal (mallrat dhe shërbimet e prodhuara) në drejtim të ruajtjes së nivelit më të lartë të stabilitetit të çmimeve.

Në fakt, për shpjegimin e rritjes ekonomike është e rëndësishme PBB-ja potenciale, sepse duhet të na tregojë nëse ekonomia ka rritje të qëndrueshme ose rritje afatgjatë. Kjo mund të bëhet duke përcaktuar shkallën e rritjes së PBB-së reale në periudhë afatgjatë, gjatë së cilës analizohet edhe madhësia e saj që është objekt i përcaktimit të rritjes.

Norma e rritjes së PBB-së reale jep raportin ndërmjet ndryshimit (rritjes ose uljes) të PBB-së në vitin aktual dhe vlerën e PBB-së në vitin e kaluar të shprehur në përqindje:

$$g = \frac{\text{GDP}(t) - \text{GDP}(t-1)}{\text{GDP}(t-1)} \times 100$$

GDP (t) = PBB në vitin aktual

GDP (t-1) = PBB në vitin e kaluar

Kështu, për shembull, nëse GDP (t) (PBB reale në 2020 në ndonjë ekonomi) është 215 miliardë njësi monetare, ndërsa GDP (t-1) (PBB reale në vitin 2019) është 200 miliardë njësi monetare, atëherë shkalla e rritjes së PBB-së reale në 2020 në ekonominë përkatëse do të jetë 7.5%:

$$g = \frac{215 - 200}{200} \times 100 = 7,5 \%$$

Gjatë analizimit të rritjes ekonomike dhe lëvizjes së normës së rritjes së PBB-së reale, ekonomistët, gjithashtu, e llogarisin edhe PBB *per capita* – domethënë prodhimin e brendshëm bruto për kokë banori (fitohet kur vlera e PBB-së së një vendi pjesëtohet me numrin e banorëve të atij vendi).

Sipas të dhënave që merren dhe analizohen në agjencitë dhe institucionet e ndryshme botërore që monitorojnë rritjen dhe zhvillimin botëror (EUROSTAT– Zyra Evropiane e Statistikave dhe të tjera), lartësia e PBB *per capita*– në vendet e BE-së është rreth 20,000 – 40,000 euro për kokë banori, kurse në vendet e pazhvilluara, vendet në zhvillim, këtu te ne është rreth 5000 euro për kokë banori. Ai është tregues i dallimeve në të ardhurat e secilit individ në vende, si dhe i asaj se çfarë fuqie blerëse ka ai dhe nëse ai mund të plotësojë në këtë mënyrë nevojat e tij brenda të gjitha ekonomive. Rëndësia e rritjes ekonomike është e madhe. Ai tregon nëse dhe sa mirë jetohej në një vend të caktuar, duke e ditur se nga ai varet edhe përmirësimi i kushteve të jetesës. Ndryshimet e vogla dhe diferencat në normat e rritjes ekonomike tregojnë ndikime të mëdha në gjendjen ekonomike të vendit. Kjo shpjegohet me të ashtuquajturin rregull 70, i cili thotë:

Nëse numri 70 pjesëtohet me normën mesatare të rritjes ekonomike të vendit, fitohet periudha kohore, respektivisht numri i viteve të nevojshme për të dyfishuar prodhimin e brendshëm bruto të vendit.

Për shembull: Nëse në një vend shkalla e rritjes së PBB-së reale është 2%, atij vendi do t'i duhen 35 vjet për të dyfishuar PBB-në ekzistuese ($70:2=35$).

Kur flasim për rritjen dhe zhvillimin ekonomik, është i rëndësishëm së veçantë përcaktimi i dallimeve në shkallën e zhvillimit ekonomik në kornizat ndërkombëtare. Niveli i ulët i zhvillimit në vendet e pazhvilluara nënkupton PBB të ulët, ndërsa në shpërndarje shkallë e vogël pagash, që do të thotë cilësi e ulët e jetës, pamundësi për të përmbushur nevojat (standarde të ulëta të jetesës), standard të ulët jetese. Kjo, nga ana tjetër, zvogëlon jetëgjatësinë e njerëzve në këto vende (ulet edhe kufiri i moshës), kurse situata është e kundërt në vendet e zhvilluara.

Më poshtë vijon tabela në të cilën do të shohim lëvizjen e PBB-së në RMV në periudhën kohore 2005-2020, si dhe lëvizjen e PBB-së për kokë banori dhe normën reale të rritjes së PBB-së.

Tabela 2-1 Prodhimi i Brendshëm Bruto, 2005-2020 në RMV

Viti	PBB me çmime aktuale	PBB për banor në euro (me kursin aktual të këmbimit)	PBB në miliona euro (me kursin aktual të këmbimit)	Norma reale e rritjes së PBB-së në %	PBB– Deflator
2005	308 447	2 470	5 032	4.7	104.9
2006	334 840	2 682	5 472	5.1	103.3
2007	372 889	2 982	6 095	6.5	104.6
2008	414 890	3 308	6 772	5.5	105.5
2009	414 622	3 300	6 767	-0.4	100.3
2010	437 296	3 459	7 109	3.4	102.0
2011	464 186	3 665	7 544	2.3	103.7
2012	466 703	3 680	7 585	-0.5	101.0
2013	501 891	3 948	8 150	2.9	104.5
2014	527 631	4 141	8 562	3.6	101.4
2015	558 954	4 382	9 072	3.9	102.0
2016	594 795	4 659	9 657	2.8	103.5
2017	618 106	4 839	10 038	1.1	102.8
2018	660 878	5 175	10 744	2.9	103.9
2019	692 683	5 423	11 262	3.9	100.9
2020	655 931	5 132	10 635	-6.1	100.9

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave i RMV

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelë, vërehet se ka rritje të PBB-së sipas banorëve në periudhën kohore 2005-2020. Norma reale e rritjes së PBB-së në tre vitet e para është në rritje, për të rënë në vitet e ardhshme dhe në vitin 2012 është – 0.5. Më pas rritet dhe zvogëlohet sërish, që në vitin e fundit 2020, për shkak të pandemisë së koronës dhe krizës ekonomike botërore, të bjerë në – 6.1 krahasuar me 2019. Për vitin 2021, të dhënat në ESHS tregojnë se PBB-ja reale e ka pasur këtë dinamikë: tremujori i parë (tremujori) -1.8%, tremujori i dytë 13.4%, tremujori i tretë 3% dhe tremujori i katërt 2.3%. Ndërsa në vitin 2022 në tremujorin e parë (të dhëna të vlerësuara) 2.4%.

2. Faktorët për zhvillimin ekonomik

Zhvillimi ekonomik është proces shumë kompleks që zhvillohet me intensitet të ndryshëm në kohë dhe hapësirë në varësi të fuqisë së veprimit të faktorëve që kushtëzojnë atë zhvillim. Shprehet përmes rritjes së vazhdueshme të prodhimit, punësimit, rritjes së cilësisë së jetës së popullsisë. Ajo çon në zhvillimin material dhe kulturor të vendit.

Zhvillimi ekonomik është proces që zhvillohet nën ndikimin e ligjeve dhe parimeve objektive ekonomike, të cilat ndikojnë në mënyrë të pavarur nga vullneti i njerëzve. Por gjithashtu, për të përshpejtuar dhe bërë më efikas zhvillimin, po veprohet edhe me masat e politikës ekonomike të shtetit.

Ka shumë kushte dhe faktorë që e kushtëzojnë, mundësojnë dhe përshpejtojnë zhvillimin ekonomik. Ata mund të jenë faktorë ekonomikë: puna, kapitali, toka dhe sipërmarrja (pa të cilat nuk mund të realizohet procesi i punës), kurse faktorë të natyrës joekonomike (natyra e sistemit politik, arsimi, shëndetësia, siguria shoqërore e njerëzve, feja, zakonet etj.). Ekonomistët në shpjegimet e tyre gjithmonë dalin nga fakti se prodhimi e përcakton dinamikën dhe cilësinë e rritjes ekonomike, prandaj, faktorët që përcaktojnë prodhimi janë “fajtor” për dallimet e mëdha në shkallën e zhvillimit ekonomik midis vendeve.

Prodhimi na tregon se sa mallra dhe shërbime mund të prodhojë një punëtor për një orë.

Faktorët më të rëndësishëm që përcaktojnë prodhimi e punës janë³:

- 1 **kapitali fizik**
- 2 **kapitali njerëzor**
- 3 **burimet natyrore**
- 4 **progresi tekniko-teknologjik**

Kapitali fizik është investim i mjete për furnizim, për blerje makinerish dhe pajisjesh të reja, mjete më moderne dhe të përmirësuara. Futja dhe aplikimi i inovacioneve, teknikave dhe transferimit të teknologjisë, kryesisht nga vendet më të zhvilluara, thjesht kërkon shumë burime financiare. Përdorimi i makinerive të kompjuterizuara në punë u mundëson punëtorëve të prodhojnë shumë më tepër produkte në të njëjtën kohë, me cilësi të lartë dhe me më pak kosto. Prandaj themi se kapitali është baza fillestare e punës dhe duhet siguruar vazhdimisht, nëpërmjet akumulimit dhe amortizimit, nëpërmjet fondeve nga kursimet e qytetarëve, si dhe kredive brenda dhe jashtë vendit, flukse investimesh të huaja. Kursimi (i qytetarit) është burim fondesh si kapital fizik, i cili në masë të madhe përcaktohet nga zhvillimi i ekonomisë në vende dhe nga sasia e të ardhurave në sektorin e ekonomive familjare. Pra, kursimi është karakteristik për vendet më të zhvilluara dhe lëvizë nga 6% në SHBA dhe Kanada, deri në mbi 11% në Japoni dhe vendet e BE-së sipas EUOSTAT-it.

Kapitali njerëzor është faktor që shfaqet në rol të dyanshëm, si burim i punës (forca punëtore) dhe si konsumator i mallrave dhe shërbimeve të prodhuara. Nga analizat e bëra nga numër i madh ekonomistësh, u pa se ky faktor është më pak i rëndësishëm sasia (numri) në raport me cilësinë (kualifikimin dhe nivelin arsimor) të punëtorëve. Gjithashtu, struktura më domethënëse e popullsisë është marrëdhënia midis popullsisë aktive dhe të mbështetur, bujqësore dhe jobujqësore, etj. Dihet nga

³ Fiti T. (2003), “Makroekonomia“, “Jugoreklama“, Shkup

praktika në të gjitha aktivitetet se punonjësit të cilët kanë fond të lartë njohurish, aftësish, shkathtësisë, të cilat i kanë fituar përmes edukimit të rregullt dhe përmes përmirësimit dhe trajnimit të vazhdueshëm përmes punës, janë në gjendje të ofrojnë numër më të madh të produkteve me cilësi më të lartë dhe shërbime në një kohë më të shkurtër dhe me rritje të prodhimit dhe kosto të reduktuara dhe çmime më të ulëta. Prandaj, në zhvillimin modern ekonomik të të gjitha vendeve, vëmendje e veçantë i kushtohet investimit në faktorin njerëzor, gjegjësisht investohen mjete në sistemin e rregullt arsimor për përvetësimin e njohurive dhe aftësive të reja, në specializime dhe studime pasuniversitare, në doktorata, forma të ndryshme trajnimi, biznesi-inkubatorë etj.

Burimet natyrore – pasuritë natyrore janë një faktor për zhvillimin ekonomik, i cili në bashkëpunim me faktorë të tjerë (kapitali, fuqia punëtore, teknologjia) mund të bëhet i rëndësishëm, por jo gjithmonë faktori më domethënës. Njihen shembuj të disa vendeve që arrijnë PBB të lartë, në total edhe për kokë banori, falë aktivizimit të burimeve të rëndësishme natyrore, për shembull, me shfrytëzimin dhe eksportin e naftës ose bazuar në përdorimin e bukurisë natyrore për zhvillimin e turizmit etj. Nga ana tjetër, ka vende shumë të zhvilluara me burime të kufizuara natyrore (për shembull, Japonia), të cilat me shumë sukses e kompensojnë mungesën e këtij faktori zhvillimi me teknologji të larta, me prodhimin e lëndëve të para artificiale dhe të ngjashme. Por ka vende që kanë burime natyrore, por në mungesë të kapitalit dhe faktorëve të tjerë, megjithatë, janë të pazhvilluar.

Në burime natyrore përfshihen sipërfaqet e punueshme, pyjet, ujërat, toka me pasuri xeherore dhe minerale në dispozicion, klima, bukuritë natyrore për turizëm, etj. Disa nga burimet natyrore janë të rinovuese (pyjet, rezervat e peshkut, etj.), kurse disa janë të pa rinovuese (për shembull, nafta). Prandaj, burimet natyrore duhet të menaxhohen në mënyrë racionale, veçanërisht ato të parinovueshme të ruhen, kurse ato të rinovueshme të lejohen të riprodhohen normalisht. Gjithashtu, çmimi i këtyre faktorëve është tregues nëse janë të rrallë (pastaj kanë çmim të lartë) ose nuk janë (çmimi i tyre është më i ulët), duke lënë kështu mundësinë për të bërë kombinimin dhe zëvendësimin e tyre, kur është e mundur.

Progresi tekniko-teknologjik është faktori më dinamik i zhvillimit ekonomik, sepse si rezultat i kërkimeve shkencore shfaqen zbulime të ndryshme të dobishme dhe realizohet zhvillimi ekonomik. Nëpërmjet këtij faktori rriten kufijtë e prodhimit të shoqërive.

Si zbulime të mëdha me rëndësi botërore konsiderohen zbulimi i motorit me avull, elektriciteti dhe çipi mikroelektronik. Aplikimi i tyre në prodhim, shërbime dhe servise çon në përparimin tekniko-teknologjik që shprehet përmes prezantimit të:

- produkteve të reja në programet e prodhimit të ndërmarrjeve;
- llojeve të reja të shërbimeve për popullatën;
- materialeve të reja për prodhim dhe pajisjen më produktive;

- llojeve të reja të energjisë;
- mënyrave të reja efikase të komunikimit;
- formave e reja të organizimit të prodhimit dhe mënyrat moderne të menaxhimit të operacioneve në ndërmarrje dhe ekonomi në tërësi, etj.

Shembulli i Japonisë është tregues se si një vend mund të bëhet një nga forcat më të forta ekonomike në botë duke aplikuar teknologji të huaja dhe me përmirësimin dhe zhvillimin e tyre të mëtejshëm. Te ky faktor janë të rëndësishme **shpikjet**, të cilat janë zbulime të reja dhe pasi të aplikohen në prodhim, do të mundësojnë prodhimin e produkteve të reja ose do të përmirësohen ato ekzistuese, do të bëhen **inovacionet**⁴. Kompanitë që i aplikojnë inovacionet, ato u sjellin më shumë të ardhura. Për këtë arsye ekonomitë moderne insistojnë që t'i stimulojnë shpikjet dhe inovacionet e reja. Për t'u mbrojtur njerëzit që janë novatorë, përdoret patenta, si mjet që u jep atyre të drejtën, për një periudhë të caktuar kohore, të përdorin përfitimet e punës së tyre kërkimore. Duke i shitur, nëpërmjet licencës, përdoruesit e tjerë të këtyre përfitimeve fitojnë të drejtën për t'i përdorur ato në të ardhmen. Në këtë mënyrë teknikat dhe zbulimet teknologjike transferohen në të gjitha vendet.

Republika e Maqedonisë së Veriut hyn në grupin e vendeve me nivel të ulët të zhvillimit ekonomik. Një pjesë e arsyeve të kësaj situatë janë në faktorin trashëgues (nga periudha kur ishim pjesë e RSFJ-së), kurse një pjesë në problemet që u shfaqën gjatë periudhës së transformimit, në politikën ekonomike etj. Në periudhën pas pavarësisë, Republika e Maqedonisë së Veriut u përpoq të ngrejë nivelin e ulët të trashëguar të zhvillimit, por u përplas me një sërë disavantazhesh që e ngadalësuan atë proces, e ndërlikuan dhe kërkonin vëmendje dhe angazhim të veçantë. Republika e Maqedonisë së Veriut kishte kapacitete të pamjaftueshme përpunuese, pajisje të vogla dhe të vjetruara të punës, shfrytëzim të pamjaftueshëm të burimeve. Sasia e vogël e kapitalit fizik ishte arsyeja kryesore e shkallës së ulët të zhvillimit, nuk kishte mundësi të aplikohen shpikjet tekniko-teknologjike. Vendi disponon pasuri të caktuar natyrore (xehe, potencial ujqor për energji elektrike, tokë dhe klimë të favorshme për prodhime bujqësore etj.), e cila shfrytëzohet në mënyrë të pamjaftueshme dhe në mënyrë të papërshtatshme. Prandaj, konsiderohet se ngritja e nivelit të zhvillimit ekonomik kërkon analizë komplekse të faktorëve për zhvillim në Republikën e Maqedonisë së Veriut, shpërndarja e tyre korrekte në shfrytëzimin dhe angazhimin e madh të fuqisë punëtore në domenin e atij problemi.


3. Cikli ekonomik

Aktivitetet ekonomike zhvillohen me dinamika dhe rrjedha të ndryshme, në drejtime të ndryshme, në periudhë të caktuar kohore. Kështu, herë ka zhvillim të përshpejtuar dhe rritje të

⁴ Fiti T. (2014), "Ekonomia", "Kultura", Shkup, faq.350

treguesve ekonomikë, herë të tjera rënie dhe ritëm të ngadalshëm të lëvizjes, që në fund jep diferenca në madhësinë e PBB-së, kurse e gjithë kjo është një nga ndikimi i faktorëve zhvillimor. Prandaj themi se zhvillimi i ekonomisë është ciklik. Ndonjëherë lëviz lart e herë poshtë.

Grafiku 2-1: Cikli ekonomik



Grafiku 2-1 tregon lëvizjen e PBB-së në kohë. Prej tij mund të konkludohet se PBB-ja përmes linjës CD jep madhësitë e saj të ndryshme të rritjes (EG) dhe rënies (GI). Pikat (E, I) tregojnë nivelin më të ulët të lëvizjes (në fund), ndërsa pikat (G) dhe (K), nivelin më të lartë në lëvizjen e PBB-së, domethënë majën. Nëpërmjet të drejtëzës AB, konstatohet se PBB-ja në periudhë afatgjate shënon rritje. Nga Grafiku i treguar në këtë mënyrë shpjegohen fazat në lëvizjen e PBB-së, pra shpjegohet cikli ekonomik i tij.

Cikli ekonomik është periudha kohore nga një recesion në tjetrin, domethënë nga njëri fund në tjetrin (nga pika E në pikën I).

Ai përbëhet nga dy faza:

- 1. Faza e zgjerimit** (shërimi dhe rritja – nga pika E në pikën G);
- 2. Faza e recesionit** (rënia dhe fundi – nga pika G në pikën I).

Faza e zgjerimit karakterizohet me rritjen e produktivitetit, rritjen e aktivitetit investues, punësimin, shpenzimet më të ulëta, fitimet më të larta, duke rezultuar në një PBB më të lartë në nivel të ekonomisë në tërësi dhe anasjelltas. Në fazën e recesionit, paraqitet produktiviteti më i ulët dhe vëllim më i vogël i prodhimit, ulje të aktivitetit investues, rritje të papunësisë, kosto dhe çmime të larta dhe PBB më të ulët në ekonomi.

Kohëzgjatja e ciklit ekonomik është e ndryshme, nga pesë deri në dhjetë vjet, e edhe më shumë, në varësi të kushteve në ekonominë specifike. Ka disa teori për ciklin ekonomik që e shpjegojnë atë, duke përfshirë: Teoria e inovacionit, Teoria monetare, Teoria e konsumit të pamjaftueshëm, Teoria psikologjike, teoria e Marksit dhe marksiste.

Këto teori tregojnë se arsyet e ndryshimeve në aktivitetet ekonomike janë të shumta, por pothuajse të gjithë teoricienët ekonomik pajtohen se faktori më domethënës që shpjegon ciklin dhe ndryshimin e zgjerimit me recesion, në ekonomitë moderne të tregut, janë ndryshimet në investime. Kështu, ndërveprimi i përshpejtuesit dhe shumëzuesit e shpjegon pse ndodhin këto ndryshime.

Përshpejtuesi (akceleratori) është tregues i ndikimit të ndryshimeve në të ardhura në masën e investimeve. domethënë, kur rritet prodhimi dhe shitjet totale të ndërmarrjeve, rriten edhe të ardhurat e tyre. Nga ana tjetër, ato rrisin investimet e kompanive, me një dinamikë më të madhe se ajo me të cilën rriten të ardhurat. Kjo çon në përshpejtim – akcelerim të rritjes ekonomike.

Multiplikatori është tregues që tregon ndikimin e ndryshimeve të investimeve mbi të ardhurat në ekonomi. Pra, rritja e investimeve rrit të ardhurat, por me një ritëm më të lartë se rritja e investimeve.

Termet kyç

- zhvillimi ekonomik
- norma e rritjes ekonomike
- Prodhimi i Brendshëm Bruto për frymë ((GDP per capita)
- kapitali fizik
- kapitali njerëzor
- burimet natyrore
- progresi tekniko-teknologjik
- cikli ekonomik
- zgjerimi (ekspansioni)
- recesioni

Përmbledhje

- Rritja ekonomike nënkupton rritje sasiore të PBB-së potenciale me kalimin e kohës. Ajo matet nëpërmjet normës së rritjes së PBB-së reale, e cila jep raportin ndërmjet ndryshimit (rritjes ose uljes) të PBB-së në vitin aktual dhe vlerës së PBB-së në vitin kaluar të shprehur në përqindje. Ekonomistët e llogaritin edhe PBB – *per capita* (PBB-në e pjesëtuar me numrin e banorëve në vend). Nivel më i lartë i rritjes ekonomike sjell PBB më të lartë dhe standard më të lartë jetese të njerëzve. Rregulli i 70 tregon se sa vite i duhen një ekonomie

për të dyfishuar PBB-në e saj (numri 70 pjesëtohet me normën mesatare të rritjes ekonomike të vendit).

- Faktorët për rritjen ekonomike mund të jenë të natyrës ekonomike (puna, kapitali, toka dhe sipërmarrja) dhe të natyrës joekonomike (rregullimi politik, arsimi...). Faktorët që rrisin produktivitetin janë: kapitali fizik – mjetet e punës, paraja, e cila mungon shumë në vendet e pazhvilluara, kurse sigurohet me anë të amortizimit, akumulimit, kursimeve të popullsisë, kredive nga jashtë; kapitali njerëzor – cilësia e punës është më e rëndësishme, jo sasia, kështu që gjithnjë e më shumë investohet në edukimin dhe aftësimin e punëtorëve; burimet natyrore janë faktor që nuk është vendimtar për zhvillim, por ndikon më së shumti në kombinim me faktorë të tjerë; faktori tekniko-teknologjik është faktori që e përshpejton më shumë zhvillimin ekonomik. Shpikjet janë zbulime të reja, ndërsa inovacionet janë kur ato aplikohen në procesin e punës. RMV është vend me nivel të ulët të zhvillimit ekonomik.
- Cikli ekonomik është periudha kohore nga një fund në tjetrin. Ekzistojnë dy faza në ciklin ekonomik: zgjerimi-ekspansioni (rimëkëmbja dhe rritja: produktiviteti i lartë, aktiviteti i lartë investues, papunësia e ulët, PBB e lartë) dhe faza e recesionit (rënia dhe fundi: produktiviteti i ulët, vëllimi i ulët i investimeve, papunësia e lartë, PBB e ulët).

Pyetje për kontrollimin e njohurive

1. Përcaktoni rritjen ekonomike!
2. Çfarë tregon norma e rritjes dhe si llogaritet?
3. Si llogaritet PBB *per capita*?
4. Shpjegoni rregullin e 70!
5. Cilët faktorë të rritjes ekonomike i dallojmë?
6. Shpjegoni faktorin fizik dhe faktorin njeri!
7. Shpjegoni pasuritë natyrore dhe faktorin tekniko-teknologjik!
8. Çfarë është cikli ekonomik?
9. Cilat faza i dallojmë në ciklin ekonomik? Shpjegoni ato!
10. Çfarë është akceleratori (përshpejtuesi) dhe çfarë është multiplikatori (shumëzuesi)?

Detyra për zbatimin praktik të njohurive

1. Shpjegoni në grafik si lëvizë cikli ekonomik!
2. Krahasoni nivelin e zhvillimit në një vend të zhvilluar dhe një vend të pazhvilluar!
3. Hulumtoni dhe gjeni të dhëna me të cilat do të bëni analizë krahasuese të rritjes dhe zhvillimit ekonomik në RMV dhe vendet e tjera të botës!
4. Si RMV mund të rrisë nivelin e zhvillimit ekonomik? Jepni pikëpamjet tuaja!

Kapitulli 2

Konsumi, kursimet dhe investimet

Përmbajtja:

1. Konsumi dhe struktura e tij
2. Kursimet
3. Investimet

Kur të përfundoni këtë kapitull, duhet të jeni në gjendje:

- të përcaktoni konsumin;
- të analizoni thelbin e konsumit;
- të krahasoni ligjet që lidhen me konsumin;
- të përcaktoni kursimet;
- të shpjegoni llojet e kursimeve;
- të bëni dallimin ndërmjet të ardhurave dhe kursimeve;
- të përcaktoni investimet;
- të dalloni llojet e investimeve;
- të shpjegoni efikasitetin e investimit përmes koeficientëve marginalë.

1. Konsumi dhe struktura e tij

Në analizën e sektorëve që e bëmë kur shpjeguam për AD-në, thamë se sektori i ekonomive familjare fiton të ardhura që mund t'i shpenzojë (për konsum personal) ose t'i kursejë.

Konsumi është ajo pjesë e të ardhurave të familjes që ata e përdorin për të blerë një sërë mallrash dhe shërbimesh përfundimtare për të kënaqur nevojat e tyre.

Duke pasur parasysh se të ardhurat në amvisëri që shpenzohen janë pothuajse gjithmonë të kufizuara, prandaj ka një ndarje të nevojave që plotësohen, varësisht nëse ato janë fiziologjike (ushqim, veshmbathje, banim) dhe quhen edhe elementare, bazë ose janë të përmirësuara, domethënë plotësohen nevojat me shërbime arsimore dhe kulturore.

Ekonomistët, duke analizuar konsumin e familjeve dhe sjelljen e tyre në të, përcaktuan ekzistencën e **tre ligjeve të përgjithshme**:

1. Familjet me të ardhura të ulëta i shpenzojnë pothuajse të gjitha të ardhurat e tyre të disponueshme për të kënaqur nevojat bazë (fiziologjike). Shuma e tij është aq e vogël saqë paratë zakonisht mjaftojnë vetëm për të plotësuar këto nevoja (ushqim, veshje, strehim).

2. Me rritjen e të ardhurave të familjes, rritet edhe përqindja relative e shpenzimeve për veshje dhe mallra konsumi të përhershme (mobile, teknik të bardhë etj.) me të njëjtën dinamikë si rritja e të gjitha të ardhurave.

3. Me rritjen e mëtejshme të të ardhurave rritet edhe pesha relative e konsumit të mallrave të luksit (shërbime turistike, sportive, rekreative etj.), edhe atë me dinamikë më të lartë se rritja e vetë të ardhurave.

2. Kursimet

Kursimi është pjesa e dytë e tërësisë së quajtur të ardhura të disponueshme të familjes, që e përbëjnë konsumin dhe kursimin.

Me kursim nënkuptojmë pjesën e pashpenzuar të të ardhurave të disponueshme të familjeve.

Varësisht nëse flasim për ekonomi – vend të zhvilluar apo të pazhvilluar, ne bëjmë dallimin në mundësinë e kursimit dhe nivelin e kursimit. Është e zakonshme që familjet në ekonomi të zhvilluar të kenë të ardhura më të larta, të cilat mbeten të pashpenzuara, kurse kështu ato reduktohen në kurtime, d.m.th. fondet e mbetura për t'u shpenzuar më vonë – si konsum i shtyrë – ose i lënë mënjane qëllimisht – të kursyera, për t'u shpenzuar në të ardhmen që të përmbushet

ndonjë nevojë specifike që kërkon shumë më të madhe parash që nuk mund të sigurohen nga të ardhurat aktuale (ditëlindje, dasma, nevoja, pushime, arsimim i fëmijëve, rikualifikim, etj.). Kursimi kushtëzohet nga një sërë faktorësh, por në thelb nga shuma e të ardhurave në dispozicion të familjeve. Përmes shembullit të mëposhtëm, mund të konkludohet se në ekonomi ekzistojnë tre lloje të kursimeve në familje:

1. Kursimi negativ – Kjo është karakteristikë e familjeve të varfra që nuk mund të kursejnë për shkak të të ardhurave të ulëta të disponueshme, ndërsa në të njëjtën kohë marrin hua për të plotësuar nevojat bazë (familja ka 30,000 njësi monetare të ardhura të disponueshme dhe shpenzon 33,000 njësi monetare).

- E theksojnë të menduarit e mëposhtëm: nevoja për kombinim të ndërsjellë të forcave të tregut dhe veprimt të ndërgjegjshëm shoqëror në zhvillimin e ekonomive moderne është postulati bazë.

3. Neoliberalizmi

Periudha e viteve të shtatëdhjeta të shekullit të kaluar u karakterizua me paqëndrueshmëri të madhe të lëvizjeve ekonomike në vendet me ekonomi tregu. Goditja e naftës e viteve 1973/1974, reduktoi aktivitetet investuese, papunësia e thelloi gjithnjë e më shumë recesionin, kështu që u krijua gjendje e stagflacionit, e cila rezultoi njëkohësisht me inflacion të lartë, papunësi të lartë, rënie të ritmeve të rritjes ekonomike, pra të PBB-së. Duke qenë se neokejzianizmi dhe përfaqësuesit e tij ishin tërësisht të fokusuar në stimulimin e kërkesës efektive, ai nuk i zgjidhte problemet, por ekzistonte rreziku i përkeqësimit të tyre. Prandaj, gjatë kësaj periudhe neokejzianët u detyruan të tërhiqen nga skena ekonomike. Por vendin e tyre e zinin gjithnjë e më shumë ekonomistët-përfaqësues të neoliberalizmit në rritje. Masat dhe instrumentet e tyre shërbyen në luftën kundër stagflacionit.

Pikëpamjet dhe kuptimet bazë të neoliberalistëve dhe shkollës së tyre janë në ideologjinë individualiste të filozofëve të famshëm Xhon Lok dhe Dejvid Hjum. Përfaqësues të tjerë domethënës të kësaj shkolle janë: Adam Smit, Menger, Ben Baverk, Majzes, Hajek, nobelisti Fridman, si dhe ekonomistët monetaristë anglezë Valters, Lejdlër dhe Perkin. Te të gjitha, mbijetoi mësimi për tregun si mekanizmi më efikas absolut për shpërndarjen e burimeve dhe nevoja për të kufizuar funksionet ekonomike të shtetit. Ata janë të bindur se inflacioni në periudha afatgjate është fenomen jashtëzakonisht monetar, ndaj përpiqen për politikë monetare kufizuese. Ata janë të bindur se deficitet buxhetore kanë implikime negative në ritmin e rritjes ekonomike, pavarësisht nëse deficitet mbulohen nga emetimi i parasë apo nga huamarrja e shtetit nga bankat tregtare apo popullata.

Neoliberalistët mbronin zbatimin praktik të procesit të privatizimit dhe ç 'rregullimin e jetës ekonomike në vendet e zhvilluara, për të ulur shkallën e monopolizimit të strukturave të tregut, për të mbrojtur konkurrencën e tregut, lirinë e tregut, sipërmarrjen dhe për të rritur efikasitetin ekonomik.

3.1. Tendencat bazë në shkollën neoliberale

Në kuadër të shkollës neoliberale dallohen disa prirje si pjesë e shkollës së vetme, përkatësisht: *monetaristët, ekonomia e ofertës, pritshmëria racionale dhe zgjedhja publike.*

- **Monetaristët** e përbëjnë thelbin e shkollës neoliberale. Ata kërkojnë liri të madhe në treg dhe ndërhyrjen e shtetit e konsiderojnë të panevojshme dhe të dëmshme. Monetaristët argumentojnë se faktorët monetarë (paraja dhe kredia) janë vendimtare në jetën ekonomike. Baza e mësimi të tyre është teoria sasiore e parasë. Kjo teori matematikisht lexohet kështu:

$$MV = PQ$$

M = oferta monetare

V = shpejtësia e qarkullimit të parasë

R = niveli i çmimeve

Q = vëllimi total fizik i mallrave dhe shërbimeve

Ana e djathtë është PBB-ja totale, kurse ana e majtë është oferta monetare M dhe shpejtësia e qarkullimit të parasë V, që do të thotë faktorë jashtëzakonisht monetar.

Monetaristët besojnë se çmimet e mallrave dhe shërbimeve, si dhe fuqia punëtore, janë fleksibile dhe se vazhdimisht harmonizohen dhe e kundërshtojnë ekzistencën e monopolit në treg, veçanërisht monopolin e zbatuar nga sindikatat në tregun e punës, ndërhyrjen e shtetit nëpërmjet transferimeve

sociale dhe monopolit shtetëror, kur qeveria u jep ndërmarrjeve të caktuara të drejtën për të prodhuar mallra dhe shërbime të caktuara.

3.1.1. Ekonomia e ofertës

Ndryshe nga kejnzanët dhe të kërkesës efektive, këta ekonomistë, përfaqësues të ekonomisë së ofertës, besojnë se problemi i stagflacionit do të zgjidhet me masa të politikës ekonomike të orientuara drejt ofertës. Ata kërkojnë uljen e normave margjinale të taksave, për të stimuluar kursimet dhe investimet, pra rritjen e ofertës dhe ndalimin e stagflacionit. Me norma më të ulëta tatimore, shteti do të realizojë të ardhura më të mëdha tatimore.

3.1.2. Pritjet racionale

Ky grup teoricienësh-ekonomistësh beson se pritjet janë e një rëndësie të madhe për analizën ekonomike, ato e përcaktojnë sjelljen e pjesëmarrësve në jetën ekonomike. Në literaturën ekonomike, ekzistojnë dy lloje të pritjeve: adaptuese dhe racionale. Pritjet adaptuese formulohen në bazë të ngjarjeve dhe sjelljeve të së kaluarës. Pritjet racionale formohen duke shfrytëzuar të gjithë informacionin përkatës për ngjarjet dhe ndryshimet në të ardhmen. Teoricienët e pritjeve racionale besojnë në racionalitetin e tregut dhe tepricën e ndërhyrjes së qeverisë në ekonomi. Sipas tyre, nevoja për mosndërrhyrje të shtetit në jetën ekonomike është rezultat i sjelljes racionale të subjekteve ekonomike, pra, në bazë të informacioneve nga tregu, ato eliminojnë pasojat negative të ndryshimeve që do të ndodhin në të ardhmen.. Ndaj, sipas tyre, ndërhyrja e shtetit, nëse ekziston, nuk ka asnjë efekt dhe nuk mund të ndihmojë e as të dëmtojë ekonominë.

3.1.3. Zgjedhja publike

Përfaqësuesi kryesor është profesori i ekonomisë Xhejms Bjukenen (fitues i çmimit Nobel në Ekonomi në vitin 1936).

Përfaqësuesit e kësaj shkolle janë të interesuar se si qeveritë marrin vendime për disa çështje të rëndësishme socio-ekonomike (për shembull, për rregullimin e sektorëve ekonomik – eksternalitetet, etj.). Në lojën politike ka pjesëmarrës: të zgjedhurit dhe politikanët në njërën anë dhe qytetarët-votuesit në anën tjetër. Politikanët e zgjedhur përpiqen t'u ofrojnë qytetarëve të mira kolektive. Teoricienët e ekonomisë së zgjedhjes publike dalin nga supozimi se politikanët, si qenie njerëzore racionale, vazhdimisht i japin përparësi interesave personale mbi interesat publike. Në kryerjen e funksioneve të

tyre politike, politikanët po bëjnë gjithçka për të fituar sërish në zgjedhjet e ardhshme. Në funksion të kësaj profilizojnë edhe politikën ekonomike. Këta teoricienë flasin për dështimin e shtetit, pasi ka edhe fusha të dështimit të tregut, veçanërisht ata mbrojnë kufizimin e fuqisë së tepërt të shtetit në sferën ekonomike dhe kufizimin e tij me rregulla të qarta dhe legjislacion të fortë.

Termet kyç

- merkantilistët
- fiziokratët
- Ekonomia politike klasike angleze
- Të mësuarit kejnzian
- Neokejnzianizmi
- neoliberalizmi
- monetaristët
- ekonomia e ofertës
- zgjedhje publike

Përmbledhje

- Teoritë mbizotëruese ekonomike që e shpjegojnë ndikimin e shtetit në aktivitetet ekonomike janë: teoria e merkantilistëve, teoria e fiziokratëve, ekonomia politike klasike angleze dhe mësimi i Kejnzit. Neokejnzianizmi është term për të gjithë teoricienët ekonomikë që ndjekin mësimet e Xh.M. Kejnzit dhe të cilët japin idetë e tyre për rolin e tregut dhe të shtetit. Neoliberalizmi është mësim, mbrojtës i të cilit kundërshtojnë mësimet neokejnziane dhe që i drejtojnë pikëpamjet dhe kuptimet e tyre bazë në procesin e privatizimit dhe ç ‘rregullimit të jetës ekonomike në vendet e pazhvilluara, me qëllim mbrojtjen e konkurrencës së tregut, lirinë e tregut, sipërmarrjen dhe rritjen e efikasitetit ekonomik, ndryshe nga neokejnzianët të cilët theksojnë nevojën e ndërhyrjes së shtetit në ekonomi. Shkollat bazë neoliberale janë: monetaristët, ekonomia e ofertës, pritshmëritë racionale dhe zgjedhja publike.

Pyetje për kontrollimin e njohurive

1. Cilat janë teoritë ekonomike dominuese për rolin e shtetit në ekonomi?
2. Çfarë pikëpamjesh mbrojnë neokejnzianët për rolin e tregut në ekonomi?
3. Shpjegoni pikëpamjet e neokejnzianëve për rolin e shtetit në ekonomi!
4. Çfarë pikëpamjesh mbrojnë neoliberalistët?
5. Cilat prirje themelore ekzistojnë në shkollën neoliberale?

Detyra për zbatimin praktik të njohurive

1. Ilustroni politikën e zgjedhjes publike!

Kapitulli 2

Të hyrat publike dhe shpenzimet publike

Përmbajtja:

1. Politika fiskale dhe të ardhurat publike
2. Shpenzimet publike
3. Buxheti

Kur të përfundoni këtë kapitull, duhet të jeni në gjendje:

- të përcaktoni politikën fiskale;
- të numëroni llojet e të hyrave publike;
- të shpjegoni llojet e të ardhurave publike (taksat, kontributet, tarifatat, kreditë publike, doganat, vetë kontributet vendore, dhuratat dhe ndihmat);
- të shpjegoni shpenzimet publike;
- të bëni dallimin ndërmjet të ardhurave publike dhe shpenzimeve publike;
- të përcaktoni buxhetin;
- të dalloni karakteristikat e buxhetit;
- të shpjegoni mënyrën e miratimit të buxhetit;
- të analizoni suficitin buxhetor dhe deficitin buxhetor.

1. Politika fiskale

Nën termin sistem fiskal të një vendi nënkuptohet sistemi i të hyrave publike dhe shpenzimeve publike të aplikuara në atë vend. Nga ana tjetër, **politika fiskale paraqet përdorimin e të hyrave dhe shpenzimeve publike për veprim mbi agregatet makroekonomik, pra mbi aktivitetin e përgjithshëm ekonomik.** Ekonomistët i shpjegojnë të ardhurat publike si të hyra që shteti mbledh nga qytetarët dhe nga ekonomia dhe që shërbejnë për të mbuluar nevojat publike, gjegjësisht nevojat e shtetit dhe qytetarëve. Në anën tjetër” nën shpenzime publike, nënkuptojnë përdorimin e mjeteve të mbledhura nga të hyrat publike, gjegjësisht shpenzimet e bëra nga shteti për t’i mbuluar nevojat publike për funksionimin e shtetit.

Në shumë vende ekziston edhe prona shtetërore dhe shteti mbledh të ardhurat e veta nga prona e tij, por ato të ardhura zakonisht nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e bëra nga shteti në kryerjen e funksioneve të tij, të cilat janë në interes të qytetarëve dhe shtetit në tërësi. Prandaj në të gjitha vendet shteti, përveç të ardhurave nga pasuria e tij, mbledh edhe të ardhura të tjera. Pra, ato përfaqësojnë në fakt mbledhjen e të ardhurave të vetë shtetit dhe të ardhurave që ai mbledh nga qytetarët dhe kompanitë. Shteti, bazuar në autoritetin e qeverisë dhe detyrimin shtetëror, vendos detyrimin për qytetarët dhe kompanitë për të paguar taksat. Në kushtet moderne, në të cilat roli i shtetit është rritur, si në ekonomi ashtu edhe në nevojat sociale, të gjitha shpenzimet publike nga 30% në 50% të prodhimit shoqëror zakonisht mbledhen dhe drejtohen përmes të ardhurave publike. Në R. Maqedonisë së Veriut, duke pasur parasysh nivelin ende të ulët të zhvillimit ekonomik dhe nevojat e mëdha për pretendime dhe investime sociale, të hyrat dhe shpenzimet publike lëvizin nga 35% deri në 45% të PBB-së.

1.1. Të ardhurat publike

Ekzistojnë lloje të ndryshme të të ardhurave publike, por në thelb ato ndahen në:

- **të ardhura nga qytetarët**
- **të ardhurat nga kompanitë**

Sipas llojit, të hyrat publike përbëhen nga:

- 1. të ardhurat nga ndërmarrjet shtetërore dhe publike;**
- 2. taksat;**
- 3. kontributet;**
- 4. detyrimet doganore;**
- 5. tarifat;**

6. *huat publike;*

7. *dhurata dhe ndihma*

- **Taksat** janë tarifa të detyrueshme për personat fizikë dhe juridikë që shteti u vendos për të paguar nga të ardhurat, pasuria, konsumi.

- **Kontributet** janë tarifa të tilla për të cilat nuk ka detyrim nga autoritetet shtetërore. Ato nuk janë të detyrueshme, por janë **tarifa vullnetare** për një pjesë të caktuar të qytetarëve, të cilët me pagesën e atij kontributi përfitojnë direkt ose indirekt nga nevoja për plotësimin e së cilës paguhet ai kontribut. Kontributet paguhën si të ardhura në fondet nga të cilat financohen këto nevoja. Në sistemin aktual të taksave, kontributet paguhën vetëm për mbulimin e nevojave sociale, pra për sigurimet shëndetësore, pensionale dhe invalidore, si dhe për rastet e papunësisë, për të cilat ka arsytim për natyrën e këtyre nevojave. Duke mos e braktisur plotësisht parimin e solidaritetit, vendoset lidhje më e drejtpërdrejtë midis kontributit dhe përdorimit të ndonjë nevoje. Parashikohet që sigurimi pensional të bazohet në tri shtylla. Përveç sigurimit të detyrueshëm, ka edhe sigurim vullnetar dhe privat. Në këto fonde paguhet kontribut i veçantë dhe secila prej tyre punon në parime të ndryshme, ndërsa disa punojnë në parime tregu etj.

- **Doganat** janë tarifa që kanë funksion fiskal, ndërsa funksioni themelor i tyre sipas analizave ekonomike është funksioni mbrojtës. Kjo do të thotë se kur për një produkt të caktuar parashikohet detyrim doganor, me importimin e tij, çmimi i tij rëndohet me shumën e taksës doganore. Ai produkt i importuar do të ketë çmim më të lartë se prodhimet vendase dhe njëkohësisht do të ketë më pak konkurrencë, kurse kjo është arsyeja pse janë përcaktuar tarifatat. Për të stimuluar prodhimin vendas dhe për të mbushur arkën e shtetit. Normat me të cilat paguhën doganat përcaktohen si tarifa doganore, me dispozita të veçanta ligjore dhe në libra të veçantë. R. Maqedonisë së Veriut, në rrugën drejt anëtarësisimit në BE, duhet të harmonizojë tarifën tonë doganore me rregullat e BE-së dhe rregullat e Organizatës Botërore të Tregtisë.

- **Tarifat** janë kompensimi që autoritetet shtetërore i mbledhin nga personat fizikë dhe juridikë për shërbimet që ofrojnë. Pra, ndryshe nga taksat, te tarifatat ka kompensim direkt, pra qytetarët marrin shërbime specifike për tarifën e paguar, ndërsa shuma e tarifës përcaktohet nga natyra e shërbimit të kërkuar. Kështu, për shembull, për marrjen e certifikatave dhe dokumenteve të tjera nga autoritetet shtetërore, paguhën **tarifa administrative**, si për kërkesën ashtu edhe për dokumentin e marrë. **Tarifat gjyqësore** paguhën edhe për përdorimin e shërbimeve nga autoritetet gjyqësore, kurse për shkak të natyrës së shërbimeve, ato zakonisht janë më të larta se tarifatat administrative. Qytetarët dhe kompanitë paguajnë edhe tarifa komunale, p.sh., për përdorimin e disa shërbimeve apo komoditeteve, si p.sh.: shfaqja e reklamave dhe njoftimeve në vend publik, për ekspozimin e kompanive, për parkim, taksa turistike etj. **Tarifatat komunale**, si rregull, janë të ardhura të autoriteteve vendore, ndërsa tarifatat administrative dhe ato gjyqësore janë të ardhura të autoriteteve shtetërore dhe gjyqësore.

Obligues janë të gjithë përdoruesit, personat juridik dhe fizik dhe tarifata paguhen me pulla tatimore ose vërtetime të ngjashme, gjë që ndikon që me këtë lloj të hyrave publike lehtë dhe shpejt të paguhen. Për këtë lloj të ardhurash publike ka edhe përjashtime dhe lehtësime.

- **Huat publike** janë një nga burimet shumë të rëndësishme të të ardhurave publike në kushtet bashkëkohore. Këto janë nga huat që merr shteti nga popullsia dhe nga bankat komerciale ose nga banka qendrore (nëse flasim për hua të brendshme), ose nga jashtë (kur flasim për hua të jashtme).

Huat publike jepen nga shteti, pra merren për disa nevoja, kur kryhet ndonjë aktivitet i rëndësishëm ekonomik, p.sh., ndërtimi i rrugëve, deficitit buxhetor etj. Mbulimi i deficitit buxhetor, në kushte bashkëkohore, është arsyeja më e zakonshme për hua publike. Me atë mbulohen shpenzimet që janë më të mëdha se të ardhurat e mbledhura në buxhetin e shtetit. Kur merr hua publike, shteti zakonisht merr hua në tregun e lirë të kapitalit, ku nxjerr në shitje letra me vlerë në formën e obligacioneve që qytetarët dhe kompanitë i blejnë vullnetarisht, sipas interesit të tyre, duke i vendosur mjetet e tyre financiare të lira dhe duke pritur, në një farë mase. afat, kamatë që zakonisht është e garantuar dhe më e lartë se kamata e rregullt bankare. Pra, huat publike janë, në fakt, investime vullnetare të fondeve nga qytetarët dhe kompanitë për nevoja të shtetit, të cilat shteti duhet t'ua kthejë atyre, me kamatë (interes).

Vendet në zhvillim, si Republika Maqedonisë së Veriut, nuk kanë akumulimin e tyre të mjaftueshëm, kështu që u duhen hua të huaja për të ndërtuar kapacitete të konsiderueshme ekonomike (në industri, bujqësi, infrastrukturë, për të përmirësuar bilancin e pagesave me vendet e huaja, etj.).

- **Dhuratat dhe ndihmat** janë fondet që personat fizikë dhe juridikë vendas dhe të huaj i japin si donacion dhe ia dhurojnë shtetit në shuma të ndryshme (vullnetarisht dhe në mënyrë të pavarur).
- **Vetë kontributi vendor** janë të ardhura publike që përdoren si mjet për mbledhjen e të ardhurave për autoritetet vendore me anë të referendumit ose mbledhjes publike dhe përdoren për një qëllim të caktuar specifik (për ndërtimin e objekteve të infrastrukturës komunale dhe sociale, shkollave, klinikave, etj.).

Të gjitha këto të hyra publike përcaktohen dhe arkëtohen përmes Drejtorisë së të Ardhurave Publike dhe Drejtorisë doganore.

2. Shpenzimet publike

Nën *shpenzime publike nënkuptojnë përdorimin e mjeteve të mbledhura nga të hyrat publike, respektivisht shpenzimet e bëra nga shteti për të mbuluar nevojat publike*. Funkcionet e shtetit janë të shumta dhe të ndryshme, duke filluar nga funksionimi i organeve shtetërore, gjyqësori, mbrojtja e

vendit, e deri te roli domethënës që luan shteti modern në rregullimin e jetës ekonomike dhe të politikës sociale. Shteti krijon, inkurajon dhe mbështet lëvizjet ekonomike, kujdeset për arritjen e zhvillimit të përhershëm dhe rritjen e punësimit, për stabilitetin ekonomik dhe social.

Shteti angazhohet edhe për sigurimin e nivelit të caktuar të mbrojtjes shëndetësore dhe sociale, veçanërisht për qytetarët që nuk mund t'i paguajnë këto nevoja me të ardhurat e tyre. Shteti udhëheq politikë aktive në arsim dhe në mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe punës. Për të gjitha këto dhe nevoja të tjera të ngjashme, shteti shpenzon fonde, bën shpenzime publike.

Megjithatë, në përpjekjen për të kënaqur nevojat e mëdha, shteti nuk duhet të ekzagjerojë barrën tatimore mbi qytetarët dhe shoqërinë. Përvoja ka treguar se nëse taksat janë tepër të larta, qytetarët do t'i shmangin ato dhe nuk do t'i paguajnë ato (**evazioni**), kurse shteti do të fitojë më pak të ardhura sesa nëse aplikohen taksa më të ulëta. Me barrën e tepërt tatimore mbi qytetarët dhe ekonominë zvogëlohet mundësia për investime dhe në përgjithësi dekurajohet zhvillimi, por edhe zvogëlohet fuqia blerëse, pra kërkesa, e cila ndikon në uljen e ofertës etj.

Madhësia e të ardhurave publike zakonisht theksohet si përqindje, domethënë përqindje në PBB. Praktika ka treguar se shtetet moderne zakonisht për shpenzimet e tyre publike, respektivisht për nevojat që i plotësojnë angazhojnë nga 30% deri në 50% të PBB-së.

Nëpërmjet shpenzimeve publike, bëhet shpërndarja e PBB-së dhe zbuten diferencat sociale ndërmjet shtresave të pasura dhe të varfra të popullsisë.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në fillim të viteve të 90-ta të shekullit të kaluar, 40% deri në 45% të PBB-së ndaheshin vazhdimisht për shpenzime publike, që është barrë shumë e madhe. Prej kohësh janë bërë përpjekje që shpenzimet publike të shtetit të jenë nga 35% në 40% të PBB-së, gjë që nuk është e lehtë të arrihet duke pasur parasysh nevojat e mëdha të shtetit dhe shërbimeve sociale, por edhe për shkak të raskapitjes financiare të ekonomisë dhe popullsisë. Njëkohësisht, duhet pasur parasysh se këto shpenzime janë më të larta, sepse një pjesë e shpenzimeve publike të dikurshme për disa nevoja publike, të cilat deri më tani siguroheshin nga shteti në bazë të parimit të solidaritetit si konsum i përbashkët, tani transferohen si barrë e qytetarëve, të cilën e paguajnë vetë nga të ardhurat e veta, si p.sh., disa lloje të kujdesit shëndetësor, por edhe kjo nuk i redukton shumë shpenzimet publike. Diferenca mes të ardhurave më pak të mbledhura dhe shpenzimeve më të larta që janë shfaqur në buxhet, në fakt paraqet deficit buxhetor, i cili mbulohet nga kreditë e huaja, që nga ana tjetër paraqet barrë të madhe për të ardhmen.

Sistemi i financimit të shpenzimeve publike, si dhe sistemi i të ardhurave publike, po ndryshojnë pasi i gjithë sistemi ekonomik po ndryshohet dhe po përmirësohet.

3. Buxheti

Buxheti është plan i të ardhurave dhe shpenzimeve të një shteti gjatë një viti. Është dokument, akt i shtetit i miratuar nga organi ligjvënës, parlamenti, në formë dhe procedurë rreptësisht të përcaktuar. Ai miratohet në fund të vitit që kalon, për vitin pasardhës. Viti buxhetor jo gjithmonë përkon me vitin kalendarik. Në buxhet, nga njëra anë, renditen të ardhurat publike që priten për vitin e ardhshëm, gjithsej dhe sipas burimeve të veçanta, kurse nga ana tjetër, jepen shpenzimet publike, në total dhe sipas qëllimit. Në buxhet renditen individualisht qëllimet dhe bartësit kryesorë të shpenzimeve publike, së bashku me sasinë e parave me të cilat ato marrin pjesë në shpenzimet publike.

Organet shtetërore që janë të ngarkuara për përgatitjen e buxhetit, më së shpeshti Ministria e Financave zbatojnë procedurë për përpilimin e buxhetit. Në bazë të kriterëve të tij dhe propozimeve nga shfrytëzuesit e buxhetit, përcaktohet propozim për sasinë e mjeteve të nevojshme në vitin e ardhshëm nga përdoruesit individualë, duke marrë parasysh detyrimet e shtuara ose të pakësuara. Debatimi që zhvillohet në Kuvendin e RMV gjatë miratimit të buxhetit, në fakt konsiston në harmonizimin e mëtejshëm të kërkesave të shfrytëzuesve buxhetorë, të cilat zakonisht janë gjithmonë më të mëdha se mundësitë, pra nga të hyrat totale dhe nga shpenzimet buxhetore.

Buxheti përcaktohet në formë ligjore që sugjeron ekzekutimin e buxhetit sipas synimit. Qeveria dhe Ministria e Financave janë përgjegjëse për zbatimin e buxhetit. Autoritetet që janë të ngarkuara posaçërisht për ekzekutimin e buxhetit, urdhërdhënësit, kontabilistët, etj., duhet t'u përmbahen rreptësisht dispozitave në buxhet. Ekzekutuesit e buxhetit nuk mund të paguajnë shuma më të vogla apo më të mëdha parash për përdoruesit individualë nga ato të parapara. Një nga parimet bazë buxhetore është parimi i bilancit buxhetor, i cili paraqet balancën ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve. Me rastin e përpilimit të buxhetit, **të hyrat dhe shpenzimet duhet të jenë të balancuara**, por gjatë zbatimit të buxhetit, ky bilanc prishet, kështu që shpenzimet shpeshherë janë më të mëdha se të hyrat. Në këtë mënyrë lind **deficit buxhetor** dhe nevoja **për të ribalancuar buxhetin**, pra për të rivendosur bilanc të ri të ardhurash dhe shpenzimesh, ose më mirë për të siguruar të ardhura të reja për shpenzimet më të mëdha. Nëse të ardhurat publike janë më të mëdha se shpenzimet publike, është suficit. Në praktikën tonë, ky lloj rebalancimi buxhetor bëhet shumë shpesh. Në buxhetin e vitit 1994 deficit është planifikuar për herë të parë gjatë përpilimit të buxhetit. Në vitin 2000 është bërë rebalancim për shkak të rritjes së të hyrave dhe në vitin 2001 është bërë rebalancim për shkak të rritjes së shpenzimeve. Në vitin 2004 ishte parashikuar deficit buxhetor prej 2.447.306.000 denarë.

Në buxhetin e RMV për vitin 2004 ishin paraparë shpenzime të të hyrave publike prej 57.255.000.000 denarë dhe shpenzime publike prej 59.702.306.000 denarë. Në sistemin aktual fiskal është ndërtuar sistemi i ri buxhetor. Karakteristika bazë është zgjerimi i rolit të buxhetit.

Në financimin buxhetor janë integruar disa nevoja publike të qytetarëve që më parë financoheshin përmes bashkësive të interesit vetëqeverisës.

- Barra e buxhetit është **financimi i programeve sociale**. Shteti, nga fondet e buxhetit, përmes fondeve përkatëse, kompenson shpenzimet e institucioneve shëndetësore dhe sociale për shërbimet e atyre qytetarëve që nuk mund të paguajnë kontribute në mjete nga të ardhurat e tyre.

- Roli i buxhetit është zgjeruar me përfshirjen në buxhet të ish të ashtuquajturit **financim jashtë buxhetit**, d.m.th financimi i disa nevojave të veçanta në prodhimin material, si premitë, regrestet, stimujt dhe të tjera, me të cilat shteti, për shembull, nxit prodhimin e grurit ose stimulon eksportet.

- Nga buxheti **financohen edhe disa investime të reja për sektorin publik** (objektet infrastrukturore – hidrocentrale, hekurudha, gazsjellës etj.).

- Me pavarësinë ekonomike dhe politike dhe me kalimin nga një sistem ekonomik në tjetrin, u shfaqën **shpenzime të reja** që duhej të përballoheshin me fonde nga buxheti, si fondet e nevojshme për rehabilitimin e bankave, për borxhet e tyre të jashtme dhe për të mbuluar një pjesë të kursimeve të vjetra devizore, më pas mbulimi i kompensimeve për punëtorët e falimentuar dhe të tjerë që e humbën punën në procesin e privatizimit, si dhe të tjerë. Nevoja për shpenzime më të larta në buxhet ka lindur nga ndarja e re territoriale e RMV në vitin 1996, si dhe nga zbatimi i procesit të denacionalizimit.

Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022 përbëhet nga: në milionë denarë.

I. Të ardhurat totale = 238 900

- **të ardhurat burimore = 230 000**
- **të ardhurat kapitale = 3300**
- **donacione = 5.570**

II. Shpenzimet totale = 272 428

- **qëllime të përcaktuara = 272,228**
- **rezerva = 220**

III. Deficit = 33.529

- **hyrjet = 45,103**
- **daljet = 11 574**

Burimi: Ministria e Financave e RMV (<https://finance.gov.mk>)

Termet kyç

- Politika fiskale
- të ardhurat publike
- taksat
- kontributet
- huat publike
- doganat
- tatimet
- dhurata dhe ndihma
- vetë kontributi lokal
- shpenzimet publike
- buxheti
- suficiti buxhetor
- def iciti buxhetor

Përmbledhje

- Politika fiskale paraqet përdorimin e të hyrave dhe shpenzimeve publike për veprim mbi agregatet makroekonomik, pra mbi aktivitetin e përgjithshëm ekonomik.
- Të ardhurat publike janë anë pozitive në buxhet dhe në politikën fiskale të çdo vendi. Këto janë fondet që shteti i mbledh nga qytetarët dhe kompanitë dhe shërbejnë për mbulimin e nevojave publike. Pronësia shtetërore dhe të ardhurat e veta të mbledhura prej saj nuk mjaftojnë asnjëherë për të kënaqur të ashtuquajturat nevoja publike, kështu që shteti, përveç mjeteve të mbledhura nga institucionet e veta, grumbullon mjete nga qytetarët dhe kompanitë. Kështu, ata i paguajnë shtetit një pjesë të të ardhurave, pronës apo konsumit të tyre.
- Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ekzistojnë këto lloje të të hyrave publike: të hyra nga ndërmarrjet shtetërore dhe publike, taksat, doganat, tarifat, kontributet, huat publike, vetë kontributi lokal, dhuratat dhe ndihmat. Taksat janë tarifa të detyrueshme që qytetarët dhe kompanitë i paguajnë shtetit, doganat paguhen gjatë importimit të disa produkteve për të cilat është paraparë kjo tarifë dhe ato duhet të mbrojnë produktet vendase nga konkurrenca, tarifat janë taksa (të dhëna) për disa shërbime që autoritetet shtetërore e bëjnë për qytetarët dhe kompanitë, ndërsa ato gjenden si: administrative, gjyqësore dhe komunale, kontributet janë tarifa vullnetare që paguhen për plotësimin e disa nevojave në fushën e shëndetësisë, arsimit etj., huat publike merren nga shteti nga qytetarët, kompanitë, nga bankat në vend (si të brendshme) dhe nga bankat e huaja, shtetet (si të jashtme).

- Shpenzimet publike janë mjetet që shteti i shpenzon për të kënaqur nevojat në shtet, institucionet publike, d.m.th. fondet që duhet të përdoren për të mbuluar shpenzimet e funksionimit të institucioneve në arsim, shëndetësi, polici, ushtri, gjyqësor, administratë etj. Këto nevoja financohen nga shteti, me përjashtim të atyre që qytetarët i plotësojnë ose marrin pjesë në koston e tyre (sigurimi shëndetësor, pensional dhe invalidor).
- Buxheti është plani i shtetit që përfshin të hyrat dhe shpenzimet publike. Ai përgatitet nga Qeveria dhe miratohet nga Kuvendi për një vit dhe shprehet sipas llojeve të të ardhurave dhe llojeve të shpenzimeve. Kjo formë e përshkruar rreptësisht kërkon gjithashtu edhe ekzekutim të tillë. Parimi themelor është bilanci buxhetor, por ai shpeshherë prishet nga shpenzimet më të larta (deficiti buxhetor), kurse nganjëherë ka të hyra më të larta se shpenzimet (suficiti buxhetor), kurse më pas duhet të bëhet rebalancimi i buxhetit, i cili zakonisht mbulohet me kredi.

Pyetje për kontrollimin e njohurive

1. Çfarë është politika fiskale?
2. Përcaktoni se çfarë janë të ardhurat publike!
3. Cilat lloje e të hyrave publike ekzistojnë?
4. Çfarë janë shpenzimet publike?
5. Si financohen shpenzimet publike?
6. Çfarë është buxheti?
7. Kush e miraton buxhetin dhe cila është ajo procedurë?
8. Cilat janë parimet e buxhetit?
9. Çfarë është deficiti buxhetor?
10. Çka është suficiti buxhetor?

Detyra për zbatimin praktik të njohurive

1. Cili është bilanci dhe sa është ai në shtetin XX nëse të ardhurat publike arrijnë në 59,444,000,000 njësi monetare dhe shpenzimet publike arrijnë në 63,278,000,000 njësi monetare ?

Kapitulli 3

Tatimet dhe sistemi tatimor

Përmbajtja:

1. Koncepti i taksave, karakteristikat dhe elementet e taksave
2. Llojet e taksave
3. Tatimi mbi fitimin
4. Tatimi personal
5. Tatimi në pronë
6. Tatimi i konsumit (TVSH, akciza dhe doganat)

Kur të përfundoni këtë kapitull, duhet të jeni në gjendje:

- të përcaktoni taksat;
- të përshkruani karakteristikat e taksave;
- të dalloni elementet e taksave;
- të numëroni llojet e taksave;
- të shpjegoni tatimin mbi fitimin;
- të shpjegoni tatimin personal;
- të numëroni dhe shpjegoni tatimet në pronë;
- të shpjegoni TVSH-në;
- të shpjegoni akcizat dhe detyrimet doganore.

1. Koncepti i tatimeve, karakteristikat dhe elementet e tatimeve

Llojet më domethënëse të detyrimeve publike janë taksat. **Tatimet janë një lloj i të ardhurave publike, që rrjedhin nga detyrimi i vendosur nga shteti ndaj qytetarëve dhe ndërmarrjeve për të ndarë një pjesë të të ardhurave ose pasurisë së tyre për të plotësuar nevojat publike, shtetërore.** Tatimet kanë disa karakteristika të rëndësishme, përkatësisht:

- 1) Janë tarifa të detyrueshme të përcaktuara me ligj, i mbledh shteti edhe me dhunë;
- 2) Tatimet jepen pa kompensim direkt;
- 3) Këto janë tarifa të pakthyeshme.

Sipas formës së pagesës, ato paguhet në natyrë (dominionin para zhvillimit të marrëdhënieve mall-para) dhe në para (janë forma kryesore e pagesës në të gjitha ekonomitë moderne tatimore).

Tatimet kanë disa elemente bazë:

A) Objekti i tatimit – lënda: Çfarë është ajo që është objekt i tatimit? Ai ndryshon me zhvillimin e sistemit tatimor dhe në këtë mënyrë përcakton llojet e tatimit. Si objekt i tatimit janë të ardhurat, konsumi dhe prona.

B) Subjekti tatimor – tatimpaguesi: Për çdo lloj tatimi është i rëndësishëm se kush është tatimpaguesi që duhet të paguajë tatimin. Në sistemet aktuale tatimore, bartës të detyrimit tatimor janë kompanitë dhe qytetarët.

C) Baza tatimore: Është ai vëllim dhe shumë e subjektit të tatimit mbi të cilën llogaritet tatimi. Për shembull, tatimi mbi fitimin paguhet në bazë të tatimit – shumën e fitimit të realizuar.

D) Norma tatimore: Është përqindja, pjesa që duhet paguar në formën e tatimit nga baza tatimore e vendosur. Mund të jetë normë tatimore proporcionale (tatimi paguhet gjithmonë me të njëjtën normë, pavarësisht nga madhësia e pronës ose të ardhurave) dhe normë tatimore progresive (shumë më e lartë e pasurisë, të ardhurave ose fitimit llogaritet me normë më të lartë, ndërsa me normë më të ulët të fitimit më të vogël).

Shembull:

17.000 den. bazë – norma 15%.


50.000 den. bazë – norma 18%.

Funksioni themelor i tatimeve është sigurisht ai fiskal, pra mbledhja e të ardhurave për nevojat e shtetit. Megjithatë, shumë shpesh dhe për një kohë të gjatë, taksat janë përdorur edhe për arritjen e qëllimeve të caktuara ekonomike dhe sociale. Në kushtet moderne, tatimet përdoren veçanërisht në realizimin e politikës stabilizuese dhe në parandalimin e inflacionit, sepse me rritjen e tatimeve ulet fuqia blerëse e qytetarëve. Tatimet, në veçanti, përdoren si instrument për rishpërndarjen e prodhimit të brendshëm bruto, veçanërisht për zbutjen e caktuar të dallimeve sociale midis popullsisë, si dhe për rritjen e fondeve për investime dhe për nevoja të tjera publike.


2. Llojet e tatimeve

Në sistemin aktual tatimor të RMV, i prezantuar në fillim të viteve '90 të shekullit të kaluar, ekzistojnë tatimet direkte (ku njihet subjekti, tatimpaguesi dhe baza e tij tatimore) dhe tatime indirekte (ku tatimpaguesi dhe baza e tij tatimore. nuk dihen).

- *Tatimet e menjëhershme direkte në sistemin tonë tatimor janë:*



- *Tatimet indirekte të ndërmjetme të konsumit janë:*



3. Tatimi mbi fitimin

Në përputhje me ndryshimet në të gjithë sistemin ekonomik dhe veçanërisht në sistemin e llogaritjes, ku fitimi pranohet si kategori bazë ekonomike, tatimi i dikurshëm mbi të ardhurat, i cili paguhej nga subjektet afariste në sistemin vetëqeverisës, është zëvendësuar me tatimi mbi fitimin në sistemin e ri tatimor.

Sipas Ligjit për tatimin në fitim të vitit 1993, këtë tatim, përveç personave juridik, e paguanin edhe personat fizik të cilët kryenin veprimtari të regjistruar. Me ndryshimet e bëra në fillim të vitit 2001, vetëm firmat më të mëdha, shoqëritë aksionare dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar paguanjnë tatimin mbi fitimin, i njohur në literaturë si tatimi mbi korporatat.

Domethënë, *obligues* të tatimit në fitim janë *subjektet juridike, vendase dhe të huaja*, që realizojnë fitim në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe ndërmarrjet nga RMV që realizojnë fitim jashtë vendit, kur atje nuk paguanjnë tatim.

Baza për llogaritjen e këtij lloji të tatimit është fitimi, i cili është diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve totale të tatimpaguesit, e përcaktuar sipas rregulloreve të kontabilitetit dhe Ligjit për tatimin mbi fitimin, ku saktësohet se çfarë konsiderohet e ardhur dhe çfarë njihet si shpenzim, për të përcaktuar në mënyrë precize dhe saktë fitimin si bazë të tatimit.

Shkalla e këtij tatimi është proporcionale dhe është 10% e bazës tatimore (tatim i sheshtë).

Ligji parashikon lehtësime tatimore dhe përjashtime, të cilat mbështesin ose inkurajojnë disa aktivitete që janë me interes të përgjithshëm për shtetin dhe që zbatohen për të gjithë, jo vetëm për disa aktivitete dhe sektorë, për shembull: tatimpaguesit i reduktohet baza tatimore për investimet në mjete elementare fikse, me qëllim stimulimin e investimit të fitimeve në investime (ri investim), një vend për konsum personal dhe blerje makinash apo të ngjashme. Gjithashtu njihet si amortizimi i përshpejtuar, nëse kryhet modernizimi, rregullimi strukturor dhe mbrojtja e mjedisit. Nuk paguhet tatim për atë pjesë të fitimit që do të investohet në zona të pazhvilluara për mbrojtjen e mjedisit, sportin ndërkombëtar, kurse kulturën, etj. Disa autorizime mbështesin investimet e përbashkëta me partner të huaj për tre vitet e para, si dhe obligacionet që fillojnë të operojnë për herë të parë në vitin e parë në të cilin raportohet fitimi.

4. Tatimi mbi të ardhurat personale

Ky ligj është prezantuar në vitin 1993 dhe në fakt përfaqëson tatim të konsoliduar mbi tatimet e mëparshme të veçanta të paguara nga zotëruesit e obligacioneve. Në atë kohë qytetarët që ushtronin ndonjë veprimtari ekonomike apo profesionale paguanin tatime të ndryshme, si tatimin mbi të ardhurat personale, tatimin mbi të ardhurat nga veprimtaria bujqësore e të tjera. Në sistemin e ri tatimor, këto taksa mbahen, por tashmë përcaktohen si tatim i vetëm, në përgjithësi mbi të ardhurat e qytetarëve. Ky tatim quhet tatim mbi të ardhurat personale, ndryshe nga tatimi mbi fitimin, që e paguajnë vetëm qytetarët, gjegjësisht personat fizikë – banorë të RMV, për të ardhurat që realizojnë brenda dhe jashtë vendit, si dhe personat që nuk janë rezidentë në RMV ndërsa këtu kanë realizuar të ardhura. Obligues i këtij tatimi është personi fizik-tregtar, tregtari individual, si dhe personat fizikë që ushtrojnë veprimtari bujqësore e zejtare dhe personat që kryejnë shërbime ose profesione të lira.

Me ndryshimet në ligj në vitin 2001, kompanitë individuale nuk do të paguajnë tatim fitimi, madje as për pagat e tyre, siç ishte para këtyre ndryshimeve, por do të paguajnë **tatim mbi të ardhurat e përgjithshme** që e realizojnë nga kryerja e atij aktiviteti. Subjekt i tatimit me këtë tatim janë **të ardhurat neto nga të gjitha burimet**, pra të ardhurat totale të qytetarëve gjatë një viti. Të ardhura të tilla janë: të ardhurat personale, të ardhurat nga veprimtaria bujqësore, të ardhurat nga prona dhe të drejtat pronësore, të ardhurat nga e drejta e autorit dhe e drejta e pronës industriale, të ardhurat nga kapitali, fitimet kapitale nga lojërat e fatit dhe të ardhura të tjera.

Në Ligj gjithashtu janë të shënuara të ardhurat për të cilat nuk paguhet tatim mbi të ardhurat. Të ardhura të tilla, p.sh., janë: të ardhurat e invalidëve ushtarak, shpërblimet, bursat, shtesat e fëmijëve, ndihmat sociale, interesat në obligacione, depozitat e kursimit, llogaritë rrjedhëse sipas kërkesës, etj.

Nga baza e përcaktuar tatimore e obliguesit tatimor i pranohen si zbritje kontributet për sigurimin pensional dhe invalidor dhe për punësim, si dhe tarifata, detyrimet e të tjera publike të paguara nga të ardhurat e obliguesit. Tatimi mbi të ardhurat personale është paguar me 23%, 27% dhe deri në 35% të të ardhurave të fituara të tatimpaguesit. Pastaj këto norma u zvogëluan dhe për të ardhurat prej 360.000 denarë u pagua tatim me normë prej 15%, ndërsa për të ardhurat mbi 360.000 denarë në vit norma e tatimit ishte 18%. Sot edhe këtu përdoret vetëm 10% tatim i sheshtë.

A) Tatimi mbi të ardhurat personale është tatimi më i zakonshëm që paguhet nga të gjithë qytetarët e punësuar si tatim mbi të ardhurat personale. Baza tatimore mbi të cilën paguhet ky tatim janë pagat nga punësimi, pensionet, të ardhurat e zyrtarëve, deputetëve, këshilltarëve, anëtarëve të bordeve drejtuese dhe mbikëqyrëse dhe të ardhura e përfitime të tjera. Nga ky tatim përjashtohen shtetasit e huaj që janë në shërbim të RMV, por jo edhe shtetasit maqedonas që punojnë në përfaqësitë e huaja diplomatike dhe konsullare dhe organizata të tjera.

B) Tatimi mbi të ardhurat personale në bazë të të ardhurave të realizuara nga kryerja e veprimtarisë bujqësore dhe pylltarisë paguhet nga pronarët ose përdoruesit e tokës bujqësore dhe pyjeve, mbi

të ardhurat kadastrale që përcaktohen për çdo njësi toke që mund të përdoret për prodhim bujqësor, d.m.th. pylltaria, pavarësisht nëse zona përdoret për prodhim apo jo.

Të ardhurat kadastrale përcaktohen si të ardhura mesatare të supozuara që realizohen në tokë të caktuar me një bonitet të caktuar dhe me përdorim mesatar të mjeteve agroteknike. Edhe pse si bazë për tatim sipas zgjedhjes mund të merret tatimit real, aktual, i cili përcaktohet në mënyrë të veçantë, megjithatë më shpesh zbatohet parimi i të ardhurave kadastrale. Në këtë ligj jepen lehtësime të caktuara për disa veprimtari që janë me interes të përgjithshëm të shtetit, ose lirohen nga tatimi për një periudhë të caktuar ose përgjithmonë.

C) Në këtë tatim mbi të fitimin përfshihen edhe të ardhurat, fitimi që realizohet nga kryerja e veprimtarisë së pavarur (prodhuese dhe shërbyese), kurse debitorë janë: personat fizikë, tregtarët, tregtarët individualë, si dhe të gjithë personat fizik që janë zejtar ose kryejnë profesione të tjera të lira.

5. Taksat e pronës

Edhe në sistemin e ri tatimor të RMV, si dhe në atë vetëqeverisës, paguhet të njëjtat lloje të *tatimit të pronës*:

- **tatimi i pronës;**
- **tatimi mbi trashëgiminë dhe dhuratën;**
- **tatimi mbi qarkullimin e pasurive të paluajtshme dhe të drejtat;**

Subjekt i tatimit në pronë është pronësia e pronave të paluajtshme, si toka jobujqësore, ndërtesa banimi dhe apartamentet, lokalet e biznesit, ndërtesat administrative, ndërtesat ose banesat për pushim dhe rekreacion dhe ndërtimet të tjera. Taksa e pronës paguhet edhe për pasuritë e luajtshme, si mjetet motorike të pasagjerëve mbi vëllimin e caktuar të motorit, autobusëve, mjeteve motorike të mallrave, traktorëve, anijeve dhe aeroplanëve.

Edhe për këtë tatim parashikohen edhe përjashtime, si që janë ndërtesat dhe tokat në pronësi të shtetit, kisha dhe bashkësitë fetare etj., ndërsa janë parashikuar lehtësime.

Tatimpagues është çdo qytetar që ka në pronësi pasurinë në përdorim dhe baza mbi të cilën paguhet tatimi është vlera e tregut të pasurisë së paluajtshme dhe të luajtshme. Tatimi në pronë është i ngarkuar në shkallë proporcionale prej 0.1% për pasurinë e paluajtshme dhe 0.05% për pasurinë e luajtshme.

Tatimi në pronë në bazë të trashëgimisë, si dhe në bazë të qarkullimit të pasurisë paguhet në masë proporcionale. Në rastin e tatimit mbi trashëgiminë, trashëgimtarët e rendit të dytë paguajnë 3% taksë mbi vlerën e tregut të pasurisë trashëgimore dhe trashëgimtarët e rendit të tretë paguajnë 5%. Trashëgimtarët e linjës së parë përjashtohen nga pagimi i tatimit. Norma e tatimit për tatimin

mbi qarkullimin e pronës dhe të drejtat pronësore është gjithashtu proporcionale dhe arrin në 3% të vlerës së pronës që është objekt i blerjes dhe shitjes.

6. Tatimi i konsumit

6.1. Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH)

Ndër llojet e tatimeve, një rol të rëndësishëm luajnë edhe tatimet e konsumit. Tatimet e tilla janë: tatimi mbi vlerën e shtuar, gjegjësisht tatimi aktual në shitje dhe në mënyrë të caktuar këtu përfshihen edhe doganat dhe detyrimet tjera të importit. Zëvendësimi i tatimit mbi shitjen me TVSH është bërë në prill të vitit 2000. Në sistemin e mëparshëm tatimor, tatimi mbi shitjen përfaqësonte një nga të ardhurat më të rëndësishme të buxhetit dhe ngarkohej në konsumin final, ku prekeshin pothuajse të gjitha produktet, por me ritme të ndryshme, sipas natyrës së produkteve dhe konsumit të tyre. Tatimi i shitjes nuk paguhej vetëm për ushqimet bazë. Që nga prilli i vitit 2000, ky tatim është zëvendësuar me TVSH-në dhe njihet si **VAT (Value Added Tax)** dhe është aplikuar në vendet e BE-së për një kohë të gjatë. Duke marrë parasysh fokusin e RMV drejt BE, vendimi për përcaktimin e zëvendësimit të tatimit aktual të shitjes me TVSH është logjik. Në përgjithësi, vendosja e TVSH-së konsiderohet si procesi më i rëndësishëm në reformat tatimore. Përgatitjet serioze që i paraprinë futjes së tij synonin shmangien e pasojave negative që disa vende në tranzicion u përballën me vendosjen e këtij tatimi, veçanërisht ndikimin mbi çmimet dhe inflacionin.

Sigurisht që vendosmëria për ta pranuar këtë taksë i detyrohet edhe përparësive të shumta që ka ndaj tatimit të dikurshëm të shitjes. Kështu, për dallim nga tatimi i shitjes, i cili ishte njëfazor dhe paguhej vetëm në konsumin përfundimtar, **TVSH-ja është tatim shumëfazor, gjegjësisht paguhet në disa faza të prodhimit dhe qarkullimit, duke përfshirë edhe konsumin final.** Gjatë kalimit të prodhimit nga një fazë në tjetrën paguhet vetëm vlera e shtuar në atë fazë, ndërsa taksa e paguar gjatë blerjes së atij prodhimi zbritet gjatë shitjes. Domethënë, tatimi paguhet, ose më mirë llogaritet, nga secili pjesëmarrës në çdo fazë të kalimit të prodhimit te konsumatori përfundimtar dhe vetëm mbi vlerën që ai i shton prodhimit. Megjithatë, çdo pjesëmarrës ka mundësinë të rikuperojë taksën e paguar. Vetëm konsumatori përfundimtar që është përdorues i prodhimit apo shërbimit nuk e ka mundësinë të tillë, kështu që ai paguan patjetër normën e parashikuar të TVSH-së mbi çmimin e vendosur të shitjes.

Siç mund të shihet, me këtë sistem të tatimit të qarkullimit inkorporohet vetëkontrolli i pjesëmarrësve në qarkullim, e me këtë pamundësohet efikasiteti në fushëveprimin e tatimpaguesve, evazioni, respektivisht shmangia e pagesës së tatimit. Në të njëjtën kohë, dokumenti i kontrollit të ndërsjellë është lëshimi, përkatësisht vërtetimi i pranuar si konfirmim i qarkullimit të kryer.

Sipas Ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, TVSH-ja si tatim i përgjithshëm i konsumit llogaritet dhe paguhet në të gjitha fazat e prodhimit dhe tregtisë, si dhe në sektorin e përgjithshëm të shërbimeve. Lënda e tatimit është qarkullimi i mallrave dhe shërbimeve që kryen tatimpaguesi në kuadër të veprimtarisë së tij ekonomike, si dhe importet.

Tatimpaguesit e TVSH-së janë personat që kryejnë në mënyrë të përhershme ose herë pas here në mënyrë të pavarur veprimtari ekonomike, me qëllim të krijimit të të ardhurave. Megjithatë, bartësit e fundit të barrës tatimore janë, në fakt, konsumatorët e fundit, qytetarët, pjesëmarrësit përfundimtarë në tregti.

Baza tatimore e TVSH-së është vlera e shtuar, pra shuma totale që duhet të merret për qarkullim, ndërsa është minusuar tatimi që prodhuesi e ka paguar gjatë hyrjes së prodhimit. Megjithatë, baza tatimore i përfshin tatimet e paguara, për shembull: mbi fitimin, mbi pagën, TVSH-në e paguar më parë. Baza tatimore për importin e mallrave është vlera e mallrave të importuara e përcaktuar sipas rregullave doganore.

TVSH-ja llogaritet duke aplikuar norma tatimore proporcionale mbi bazën tatimore për qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve dhe importeve, përkatësisht: sipas shkallës së përgjithshme tatimore prej 18% dhe sipas normës tatimore preferenciale prej 5%. Në ligj janë të numëruara rastet e shitjes së mallrave dhe ofrimit të shërbimeve për të cilat nuk paguhet TVSH-ja, pra të cilat janë të liruara nga pagesa e TVSH-së.

Megjithatë, për numrin më të madh të produkteve dhe shërbimeve, TVSH paguhet me shkallën e përgjithshme tatimore prej 18%, ndërsa për numër të vogël produktesh paguhet normë preferenciale prej 5%.

Procesi i futjes së TVSH-së në RMV konsiderohet i suksesshëm, veçanërisht duke pasur parasysh ndikimin relativisht të vogël në inflacion dhe çmime, megjithëse tani TVSH-ja paguhet edhe për ato produkte dhe shërbime për të cilat deri atëherë nuk paguhej tatimi mbi shitjen ose paguhej me normë preferenciale prej 5%. Futjes së TVSH-së i kanë paraprirë përgatitje serioze administrativo-teknike dhe profesionale në Ministrinë e Financave dhe Administratën e të Ardhurave Publike, mbi të gjitha kompjuterizimi dhe edukimi i shërbimeve, përfshirë edhe obligacionet etj.

6.2. Akcizat

Akcizat janë lloj i veçantë i tatimit mbi konsumin. Me akcizën, disa lloje të produkteve, si pijet alkoolike, produktet e duhanit, derivatet e naftës, makinat e të tjera, para se të taksohen me normën më të lartë të TVSH-së, çmimit të caktuar të atyre produkteve i shtohet shuma e përcaktuar si akcizë, kurse atëherë atij çmimi i llogaritet TVSH-ja.

Një nga problemet serioze që u shfaq gjatë vendosjes së TVSH-së ishte rritja e lartë e akcizës. Konkretisht, u bë që çmimeve të vendosura tashmë t'i shtohet TVSH-ja me akcizë të përfshirë.

Ndonëse ishte parashikuar ulje e akcizës, kjo nuk ka ndodhur deri më tani dhe arsyeja kryesore është nevoja për të siguruar sa më shumë të ardhura për buxhetin. Çështja e natyrës dhe sasisë së akcizës është e rëndësishme edhe sot, siç janë, për shembull, akcizat për makinat.

6.3. Detyrimet doganore

Ndryshe nga llojet e të tjera të tatimeve, funksioni bazë i të cilave është fiskale, me doganën, si lloj tatimi, ai funksion duhet të jetë dytësor, kurse **funksioni** i tyre parësor duhet të jetë **mbrojtës**. Pra, me rastin e importimit të ndonjë prodhimi, çmimi i ndonjë prodhimi rëndohet me shumën e doganës, ai produkt i importuar në krahasim me produktet vendore do të ketë çmim më të lartë dhe konkurrencë të reduktuar, që është edhe qëllimi i taksës doganore. Megjithatë, në sistemin e mëparshëm të të hyrave publike në RMV, funksioni mbrojtës shpesh sakrifikohet në kurriz të funksionit fiskal. Dogana të larta vendosen edhe kur nuk nevojitet mbrojtje e lartë, për të mbledhur më shumë të ardhura.

Lënda e zhdoganimit, gjegjësisht tatimit është importi i mallrave, rrallë eksporti, ndërsa bazë e doganës është vlera e mallit të importuar. Si obligues paraqiten të gjithë personat fizikë dhe juridikë që importojnë mallra nga jashtë. Duke vepruar kështu, parashikohen lehtësime ose përjashtime për mallra të caktuara, për bagazhet personale të udhëtarëve, për zyrtarët diplomatikë dhe konsullarë, për punonjësit jashtë vendit etj.

Normat, përkatësisht **tarifat doganore**, si element shumë i rëndësishëm i sistemit doganor, në sistemin aktual doganor janë më të ulëta për produktet që nuk prodhohen në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndërsa për produktet tjera janë më të larta në bazë të nevojës për mbrojtjen e atyre produkteve. Në sistemin doganor pranohet përcaktimi për liberalizim më të madh të marrëdhënieve ekonomike me shtetet e huaja dhe kjo nënkupton mbrojtje më të ulët doganore. I paraprinë një procesi shumë i vështirë dhe kompleks i harmonizimit të tarifës doganore të RMV me rregullat e BE-së, por mbi të gjitha me rregullat e **Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT)**. Marrëveshjet e tregtisë së lirë me disa vende fqinje dhe të tjera kërkojnë gjithashtu përshtatje të tarifave të këtyre marrëveshjeve. Në të njëjtën kohë, duhet të sigurohet mbrojtje e caktuar e prodhimit vendor, duke pasur parasysh nivelin ende të ulët të zhvillimit ekonomik të RMV, por edhe për të mos e ekzagjeruar me mbrojtjen.

Termet kyç

- tatimet
- subjekti tatimor
- objekti tatimor

- baza tatimore
- norma e tatimit
- tatimi mbi fitimin
- tatimi personal
- tatimi i pronës
- tatimi mbi vlerën e shtuar
- akciza
- doganat
- kërkesa për fuqi punëtore
- oferta e fuqisë punëtore
- balancimin i tregut të punës
- diferencat e pagave
- sindikatat

Përmbledhje

- Taksat janë të ardhura publike që rezultojnë nga detyrimi i vendosur nga shteti për qytetarët dhe ndërmarrjet për të ndarë një pjesë të të ardhurave ose pronës së tyre për plotësimin e nevojave publike shtetërore. Ato kanë tri karakteristika: të detyrueshme, të pakthyeshme dhe tarifat pa kompensim. Elementet bazë të tatimeve janë: objekti – lënda tatimore e tatimit (të ardhurat, pasuria, konsumi), subjekti tatimor (personi fizik ose juridik i cili tatóhet), baza tatimore – mbi cilën bazë ose vëllim është llogaritur tatimi dhe shkalla tatimore (përqindja), shumta e detyrimit që duhet paguar nga baza dhe mund të jetë normë progresive dhe proporcionale).
- Në sistemin tatimor të RMV dallohen tatimet direkte, të menjëhershme: tatimi mbi fitimin, tatimi mbi të ardhurat personale të qytetarëve dhe tatimi në pronë, si dhe tatimet e ndërmjetme indirekte (TVSH, akciza, dogana). Tatimi mbi fitimin paguhet vetëm nga kompanitë që realizojnë fitim në masën 10% – tatim i sheshtë. Tatimi personal është tatim që paguhet vetëm nga qytetarët që fitojnë të ardhura në baza të ndryshme në vend dhe paguhet në masën 10% si tatim i sheshtë. Tatimi në pronë mund të jetë: tatimi në pronë (i pagueshëm në masën 0.10% dhe 0.5% për pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme), tatimi mbi trashëgiminë dhe dhuratën dhe tatimi dhe në të drejtat e shitjes së pasurive të paluajtshme. TVSH-ja është tatim që paguhet në disa faza të prodhimit dhe qarkullimit me norma 18% normë të përgjithshme dhe 5% normë preferenciale për të gjitha produktet dhe shërbimet në prodhim dhe qarkullim. Ky tatim rëndon vetëm konsumatorët e fundit. Akcizat janë një lloj i veçantë i tatimit

të konsumit për disa lloje produktesh si pijet alkoolike, duhani, kafeja, makinat, derivatet e naftës. Tarifat doganore janë taksa për importin e produkteve të caktuara, me qëllim mbrojtjen e prodhimit vendas nga konkurrenca.

Pyetje për kontrollimin e njohurive

1. Çfarë janë tatimet?
2. Cilat janë karakteristikat tatimore dhe elementet tatimore?
3. Shpjegoni tatimin mbi fitimin!
4. Cilat lloje të tatimeve ekzistojnë në RMV?
5. Shpjegoni tatimin mbi të ardhurat personale!
6. Shpjegoni tatimin e pronës!
7. Çfarë është TVSH dhe si llogaritet?
8. Çfarë janë akcizat?

Detyra për zbatimin praktik të njohurive

1. Llogaritni sa tatim fitimi do të paguajë kompania XX nëse të ardhurat totale të saj janë 1,625,000 njësi monetare dhe shpenzimet totale janë 1,120,000 njësi monetare!
2. A kontribuon TVSH-ja në uljen e evazionit fiskal dhe pse? Shpjegoni!

Njësia modulare 5

Ekonomia ndërkombëtare

Rezultatet nga mësimi

Nxënësi do të jetë në gjendje:

- **Të diferencojë format e marrëdhënieve ekonomike ndërkombëtare;**
- **Të krahasojë proteksionizmin dhe liberalizmin si sisteme të tregtisë ndërkombëtare;**
- **Të shpjegojë sistemin valutor dhe politikën valutore;**

Kapitulli 1

Marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare

Përmbajtja:

1. Format e tregtisë ndërkombëtare
2. Marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare
3. Sistemi i tregtisë së jashtme dhe politika e tregtisë së jashtme

Kur të përfundoni këtë kapitull, duhet të jeni në gjendje:

- të shpjegoni ekonominë ndërkombëtare;
- të specifikoni format e MEN-re (marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare);
- të përshkruani format e MEN-re;
- të theksoni rëndësinë e MEN-re për zhvillimin ekonomik të vendeve;
- të bëni dallimin ndërmjet sistemit të tregtisë së jashtme dhe politikës së tregtisë së jashtme.


1. Format e tregtisë ndërkombëtare

Prej kohësh dihet në shkencën ekonomike se *shkëmbimi i mallrave ndërmjet vendeve paraqet mënyrë për të përdorur në mënyrë optimale avantazhet natyrore dhe të tjera krahasuese të një vendi në raport me vendet e tjera*. Duke pasur parasysh këtë, mund të thuhet se nevoja për tregti ndërkombëtare parashikohet nga shumë arsye – faktorë:

- Ekonomitë moderne janë ekonomi të hapura, që do të thotë se ato tregtojnë me njëra-tjetrën në një sërë mallrash dhe shërbimesh, eksportojnë dhe importojnë fuqi punëtore, kapital, teknologji e të ngjashme;
- Eksporti neto është komponent i kërkesës agregate të PBB-së;
- Eksporti dhe importi i mallrave janë format më të përhapura të tregtisë ndërkombëtare, sepse ato kanë efekt të fortë në proceset moderne të globalizimit të aktivitetit të përgjithshëm ekonomik, me fjalë të tjera, tregtia ndërkombëtare është fakt për çdo vend: ne vozisim automjete të huaja, hamë fruta jugore, kudo në botë pihen vera franceze, te gjitha vendet përdorin shërbime nga avio-kompanitë e huaja etj.

Në kushte të tregtisë ndërkombëtare, ne konsumojmë PBB-në e të tjerëve me importe, ndërsa me eksportet në vende të tjera, një pjesë e PBB-së sonë konsumohet atje. Diferenca ndërmjet eksporteve dhe importeve të mallrave dhe shërbimeve quhet neto-eksporte. Kur eksportet janë më të mëdha se importet e vendit, atëherë është neto-eksport *pozitiv*, i cili quhet *suficit tregtar*, kurse anasjelltas, kur importet e mallrave dhe shërbimeve janë më të mëdha se eksportet, është neto-eksport *negativ* ose *deficit tregtar*. Çmimet e mallrave brenda dhe jashtë vendit, kursi devizor, politika e tregtisë së jashtme të qeverisë dhe të tjera, sipas ekonomistit amerikan Menkju, janë një faktor domethënës që ndikuan në vëllimin dhe dinamikën e neto-eksporteve.

Figura 5-1: Eksporti dhe importi i mallrave në RMV (në miliona euro)




Burimi: Enti shtetëror i statistikës

Sipas të dhënave të ESHS-së, këmbimi total i tregtisë së jashtme në K-4-2020 arriti në 3.973,4 milionë euro dhe shënoi rritje prej 1.3% krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2019. Kjo tregon

tendenca më të favorshme në tregtinë e jashtme, pas rënies së saj në tremujorët e parë të vitit 2020, si pasojë e përhapjes së pandemisë së shkaktuar nga virusi korona.

Figura 5-2: Vendet me peshën më të madhe në eksporte (majtas) dhe në eksporte (djathtas) në TM4 2020



Burimi: Llogaritjet e Ministrisë së Financave bazuar në të dhënat nga ESHS

2. Marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare

Krahas eksportit dhe importit të mallrave, marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare përfshijnë edhe qarkullimin e shërbimeve, qarkullimin e kapitalit, transferimin e njohurive teknologjike, lëvizjen e fuqisë punëtore. *Shërbime të ndryshme kryhen edhe në tregun ndërkombëtar.* Më domethënëse janë:

- *Transporti i mallrave dhe transporti i udhëtarëve;*
- *Shërbimet e ndërtimitarisë (projektimi, ndërtimi dhe montimi i objekteve në vendet e huaja);*
- *Turizmi, respektivisht shërbimet që lidhen me udhëtimin dhe qëndrimin e turistëve të huaj dhe shtetasve vendas në vendet e huaja;*
- *Shërbimet konsulente të llojeve të ndryshme dhe të tjera;*
- *Element tjetër në marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare është lëvizja e kapitalit.*

Dy format më të rëndësishme të eksportit të kapitalit janë:

- *Investimet e huaja direkte;*
- *Portofolio – Investimet*

Investimet e huaja direkte (IHD), në mënyrën më sintetike, realizohen nga kompanitë transnacionale (KTN) nëpërmjet hapjes së **filialeve** të tyre (veta) – ndërmarrjeve prodhuese në vendet e huaja nëpërmjet blerjes së aksioneve kontrolluese të shoqërisë ekzistuese ose, nga ana tjetër, duke

krijuar ndërmarrje krejtësisht të reja. Sot, në botë operojnë më shumë se 650,000 afiliale të huaja, të krijuara nga rreth 60,000 kompani prindërore. Në përgjithësi, KTN-të përfshijnë firmat e mëdha më shumë në marrëdhëniet e vendeve të zhvilluara, por edhe firmat nga vendet në zhvillim, kurse së fundmi nga ekonomitë në tranzicion, si firma të vogla dhe të mesme (UNCTAD 1999, P. 1). Ekzistojnë faktorë që përcaktojnë investimet e huaja direkte. Ndër to, më të rëndësishmet janë:

- *Gjerësia dhe fuqia absorbuese e tregut në ekonominë ku drejtohen IHD;*
- *Burimet e disponueshme dhe të lira (puna, toka, energjia, lëndët e para, etj.);*
- *Stabiliteti infrastrukturor i vendit;*
- *Stabiliteti politik i vendit;*
- *Klima miqësore dhe trajtimi i favorshëm për investitorët e huaj.*

Në RMV, shembuj të IHD-ve janë “Pivara”, “Zhito Luks”, “OKTA”, “Makedonski Telecom” AD, “Xhonson Controls”, “Xhonson Meti”, “Van Holl”, “Drexler Majer”, “Kromberg dhe Shubert “. etj.

Në **portofolio investimet** përfshihen **aksionet e korporatës në përqindje më pak se 10% e numrit të përgjithshëm të aksioneve me të drejtë vote**, investimet në obligacionet e korporatave (të lëshuara nga kompanitë për të marrë kapital shtesë), investimet në obligacionet e qeverisë, emetimet e obligacioneve speciale (si p.sh., *eurobono, eurobons* etj.). Pra, këto janë investime për realizimin e fitimit, jo për të blerë bllok kontrollues të aksioneve. Gjithashtu, si IHD-të, ato janë të fokusuara më së shumti në marrëdhëniet e relacioneve, vende të zhvilluara – vende të zhvilluara, kurse pas viteve nëntëdhjetë ekziston tendencë për rritjen e portofolio – plasmaneve edhe në vendet në zhvillim ashtu edhe në vendet që janë në tranzicion.

Investimet e huaja direkte (IHD) bëhen në mbarë botën përmes kompanive transnacionale (KTN).

Figura 5-3: Flukset neto të IHD-ve në RMV në periudhën 1998-2014 në dollarë

Viti	Shuma e IHD-ve	Viti	Shuma e IHD-ve
1998	150	2008	600
1999	88	2009	185
2000	216	2010	207
2001	446	2011	474
2002	105	2012	165
2003	117	2013	305
2004	322	2014	261
2005	94	2015	
2006	424	2016	
2007	700	2017	

Burimi: “Grafiku i muajit”, Ekonomia dhe Biznesi, viti 18, numër 209, Nëntor 2015, f.7

Figura 5-4: Neto-flukset të IHD-ve në RMV në periudhën 1998-2014 në përqindje të PBB-së

Viti	Shuma e IHD-ve	Viti	Shuma e IHD-ve
1998	4.2%	2008	6.1%
1999	2.4%	2009	2%
2000	5.7%	2010	2.2%
2001	12%	2011	4.5%
2002	2.6%	2012	1.7%
2003	2.4%	2013	2.8%
2004	5.7%	2014	2.3%
2005	1.5%	2015	
2006	6.2%		
2007	8.4%		


Burimi: “Grafiku i muajit”, Ekonomia dhe Biznesi, viti 18, numër 209, Nëntor 2015, f.7

Figura 5-5: Pjesëmarrësit më të mëdhenj të vendeve në IHD në R. Maqedonisë së Veriut në periudhën 1998-2014

Vendi (shteti)	Pjesëmarrja në IHD-të e përgjithshme
Holanda	21.6%
Austria	12.8%
Greqia	10.7%
Sllovenia	9.6%
Hungaria	5.6%
Turqia	4.5%
Zvicra	4.3%
Mbretëria e bashkuar	3.5%

Burimi: “Grafika e muajit”, Ekonomia dhe Biznesi, viti 18, numri 209, Nëntor 2015, f.7

Figura 5-6: Investimet e huaja direkte në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga viti 2017-2020 (në miliona euro)



Burimi: Banka popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe llogaritja e FM

Transferimi i njohurive teknologjike është lloj specifik i qarkullimit që po merr gjithnjë e më shumë rëndësi për zhvillimin ekonomik, si në botë ashtu edhe në ekonominë e RMV. Si rezultat i kërkimit shkencor vazhdimisht shfaqen procese të reja teknologjike, shpikje teknike, metoda të reja të organizimit në operacione etj. Njohuritë e reja janë objekt i tregtisë ndërkombëtare, ato blihen dhe shiten, ashtu siç shiten dhe blihen mallrat dhe shërbimet, kurse në këtë mënyrë dija bartet në vendet e tjera. Në fakt blihen të drejta për të prodhuar produkte sipas njohurive të reja teknologjike. Kështu përhapet teknologjia dhe në përgjithësi zhvillimi teknologjik në botë.

Lëvizja e fuqisë punëtore – Në vendet në zhvillim, shpesh ka “tepricë” të fuqisë punëtore, domethënë fuqi punëtore që për shkak të mungesës së kapitalit, nuk mundet në afat të shkurtër të angazhohet në prodhim, shitje dhe shërbime. Megjithatë, në disa vende të zhvilluara ka mungesë të fuqisë punëtore. Kështu ndodh lëvizja e fuqisë punëtore. Nga punësimi jashtë vendit, si marrëdhëniet ekonomike, rezultojnë me efekte pozitive si që është ulja e papunësisë, rritja e standardit të jetesës, fluksi i devizave, fitimi i përvojës së punës etj. Megjithatë, ka edhe efekte negative, veçanërisht kur largohen nga vendi personeli me kualifikim të lartë, për arsimimin e të cilit janë shpenzuar fonde të konsiderueshme në vend dhe që me ato njohuri dhe atë ekspertizë do të gjenerojnë të ardhura në vende të tjera. Sot, ky është rasti i RMV, kur shumë të rinj, në pamundësi për të gjetur punë në vend, kërkojnë punë në vende të tjera, pra jashtë shtetit.

3. Sistemi i tregtisë së jashtme dhe politika e tregtisë së jashtme

Në kushtet bashkëkohore të ekonomive të tregut, asnjë vend në botë nuk mund të ketë ekonomi të mbyllur, që do të thotë se ai duhet të kryejë tregti të jashtme dhe, në ato marrëdhënie, të bëjë përpjekje për të shfrytëzuar lehtësitë e tij, për prodhim dhe për shërbime, eksportimin e tyre si konkurrues

dhe importimin e mallrave dhe shërbimeve, për të cilat nuk mund t'i prodhojë me çmim të lirë ose nuk mund t'i prodhojë fare. Rregullat e sistemit të tregtisë së jashtme i rregullojnë kushtet për kryerjen e veprimeve të tregtisë së jashtme, përkatësisht importin dhe eksportin e mallrave dhe shërbimeve dhe kryerjen e veprimtarive të tjera ekonomike jashtë vendit. Në thelb, sipas rregullave të sistemit të tregtisë së jashtme, eksporti dhe importi i mallrave është i lirë. Numri më i madh i produkteve janë të lira, pra me regjim liberal. Kjo është në përputhje me karakterin e ekonomive, sepse në kushtet moderne ato janë ekonomi me treg të hapur, kështu që eksporti dhe importi i mallrave mund të kryhet lirisht, në sasi dhe vlera që kompanitë e eksport-importit do t'i përcaktojnë vetë.

Për importin e disa mallrave është paraparë inspektimi i veçantë i kontrollit shëndetësor dhe i cilësisë, i cili kryhet nga organet e autorizuar inspektuese.

Numër i caktuar produktesh nuk janë në regjimin liberal, por në një nga **regjimet e kufizimit**. Një regjim i tillë janë kuotat e importit dhe eksportit. Kjo do të thotë se mallra të caktuara mund të importohen dhe eksportohen derisa të arrihet sasia ose vlera e miratuar nga autoritetet kompetente si kuotë. Ky regjim përdoret si një lloj mbrojtjeje e prodhimit vendas. Me aplikimin e regjimit të kuotave, në eksportet që përdoren më rrallë për shkak të rëndësisë së disa produkteve, eksportet kufizohen në aspektin sasior, duke mos rrezikuar ofertën në tregun vendas.

Një regjim kontrolli më i rreptë është **regjimi i lejeve**, i cili zbatohet për eksportin dhe importin e produkteve specifike, siç janë pajisjet dhe armët ushtarake, vepra me vlerë historike dhe artistike dhe metale të çmuara. Lejet shpesh jepen për të importuar pa ose me më pak detyrime ose detyrime të tjera jo-tarifore të produkteve që janë në mungesë në treg, për shembull, sheqeri, vaji për gatim, etj.

Disa nga mallrat mund të gjenden edhe në regjimin e pëlqimit për importin ose eksportin e atyre produkteve. Një regjim i tillë për importin ose eksportin e mallrave mund të ndërmerret për shkak të orientimit rajonal dhe balancimit të këmbimit tregtar me disa vende.

Termet kyç

- tregtia ndërkombëtare
- marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare (MEN)
- importi
- eksport

Përmbledhje

- Në kushtet moderne tregtare të ekonomizimit, tregtia ndërkombëtare është parakusht bazë për realizimin e ofertës së pasur të mallrave dhe shërbimeve në vendet e botës. Ajo përfshin import-eksport të mallrave dhe shërbimeve, import-eksport të kapitalit, teknikës dhe teknologjisë. Elementi më i zakonshëm në tregtinë ndërkombëtare është import-eksporti i mallrave dhe si rrjedhojë me importe e konsumojmë PBB-në e të tjerëve dhe me eksporte në vende të tjera një pjesë e jona konsumohet atje.
- Marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare janë term më i gjerë se tregtia ndërkombëtare, sepse përveç importit dhe eksportit të mallrave, përfshijnë edhe importin dhe eksportin e kapitalit, shërbimeve, teknikës dhe teknologjisë, fuqisë punëtore. Dy format më të rëndësishme të eksportit të kapitalit janë IHD-të dhe portofolio – investimet. IHD-të realizohen më së shumti në marrëdhëniet e vendeve të zhvilluara – të zhvilluara dhe kërkojnë plotësimin e disa kushteve që investitorët ta bëjnë IHD-në.

Pyetje për kontrollimin e njohurive

1. Çfarë është tregtia ndërkombëtare ?
2. Shpjegoni nevojën e tregtisë ndërkombëtare!
3. Çfarë janë investimet e huaja direkte (IHD)?
4. Cilat parakushte i kërkojnë IHD-në?
5. Çfarë kuptoni me termin portofol-investimet?

Detyra për zbatimin praktik të njohurive

1. Çfarë ndryshimi do të shkaktojë zhvlerësimi i denarit në marrëdhëniet tregtare me jashtë nëse merret si masë nga qeveria e vendit?
2. Bëni kërkime dhe përmes analizave numëroni vendet – investitorët më të mëdhenj në RMV!

Kapitulli 3

Proteksionizmi dhe liberalizmi si sisteme të tregtisë ndërkombëtare

Përmbajtja:

1. Përparësitë absolute dhe krahasuese
2. Proteksionizmi
3. Liberalizmi

Kur të përfundoni këtë kapitull, duhet të jeni në gjendje:

- të shpjegoni teorinë e përparësive absolute;
- të shpjegoni teorinë e përparësive krahasuese;
- të ilustroni një shembull të përparësive absolute dhe krahasuese;
- të shpjegoni proteksionizmin në tregtinë ndërkombëtare;
- të paraqitni instrumente të politikës proteksioniste;
- të shpjegoni liberalizmin si sistem të tregtisë së lirë ndërkombëtare;
- të analizoni organizatat ekonomike ndërkombëtare;
- të krahasoni proteksionizmin dhe liberalizmin si sisteme të tregtisë ndërkombëtare.

1. Përparësitë absolute dhe krahasuese

Të gjitha vendet përfitojnë nga tregtia ndërkombëtare. Nëpërmjet tij, ata mund të blejnë mallra dhe shërbime të caktuara nga jashtë me çmime më të ulëta se sa kushton prodhimi i mallrave dhe shërbimeve të njëjta në vend. Pra, në ekonomi, prodhimi i çdo malli apo shërbimi ka **koston e vet oportune**.

Kostoja oportune e prodhimit të një malli ose shërbimi është sasia e mallrave dhe shërbimeve të tjera që duhet të sakrifikohen (të mos prodhohen) nëse do të prodhohet edhe një njësi shtesë e atij malli ose shërbimi.

Kjo ligjshmëri rezulton nga rrallësia (kufizimi) i burimeve. Domethënë, nëse ndonjë ekonomi mund të prodhojë mallra dhe shërbime të caktuara në ndonjë kohë më të shkurtër dhe me një kosto më të ulët të faktorëve të tjerë të prodhimit, ajo mund të specializohet dhe të përqendrohet pikërisht në prodhimin e atyre mallrave dhe shërbimeve. Vetë specializimi do të vazhdojë të veprojë në uljen e shpenzimeve të prodhimit të atyre mallrave dhe shërbimeve. Ai vend më pas mund t'i prodhojë ato mallra dhe shërbime në grupe të mëdha dhe të arrijë **ekonomi në vëllim. Ekonomitë e vëllimit i reduktojnë shpenzimet fikse për njësi të prodhimit**. Falë specializimit dhe ekonomive të vëllimit, vendi është në gjendje të prodhojë me çmim të lirë sasi të mëdha të mallrave dhe shërbimeve të caktuara dhe t'i shkëmbejë ato për mallra dhe shërbime që do të kushtonin më shumë nëse do të prodhoheshin në vend. Në këtë mënyrë reduktohet ndjeshëm kostoja oportune e prodhimit të mallrave dhe shërbimeve në të cilat vendi është specializuar.

Ekzistojnë disa korniza të rëndësishme teorike që e shpjegojnë specializimin e prodhimit në tregtinë ndërkombëtare. Ndër to janë teoria e përparësisë absolute dhe teoria e përparësisë krahasuese.

1.1. Teoria e përparësive (avantazheve) absolute

Kjo teori u zhvillua nga Adam Smiti në veprën e tij “Hetimi mbi natyrën dhe shkaqet e pasurisë së kombeve” e botuar në vitin 1776. Adam Smit u angazhua për tregtinë e lirë midis kombeve, e cila kontribuon në rritjen e mirëqenies së tyre.

Sipas teorisë së avantazheve absolute, çdo vend duhet të specializohet në prodhimin e atij prodhimi që e prodhon në mënyrë më efikase se vendet e të tjera. Prandaj, nëse një vend mund të marrë ndonjë produkt të caktuar më lirë se një vend tjetër, ai nuk duhet ta prodhojë vetë, por ta importojë. Pra, nëse një vend ka ndonjë avantazh absolut në prodhimin e ndonjë prodhimi, ajo duhet të specializohet në prodhimin e atij prodhimi dhe ta eksportojë atë në këmbim të ndonjë prodhimi tjetër, të cilin e prodhon më shtrenjtë në krahasim me vendet e të tjera.

Tabela 5-1: Përparësitë absolute

	Vendi A	Vendi B	Gjithsej
Prodhimi X	4	1	5
Prodhimi Y	2	3	5

Nga tabela mund të shihet se vendi A prodhon 4 njësi të prodhimi X për një orë, kurse vendi B prodhon vetëm një pjesë të të njëjtit produkt në orë. Prandaj, vendi A ka avantazh absolut në prodhimin e atij prodhimi. Vendi B është më efikas në prodhimin e Y-it, ai prodhon 3 njësi në orë të atij prodhimi dhe vendi A vetëm 2 njësi në orë. Gjithashtu vihet re se nëse të dy vendet prodhojnë vetëm dy produktet, prodhimi total arrin në 5 njësi të secilit produkt.

Duke qenë se vendi A ka avantazh absolut në prodhimin e X, ai do të specializohet në prodhimin e atij prodhimi dhe do ta eksportojë atë në këmbim të prodhimit Y të prodhuar nga vendi B, i cili është më efikas në prodhimin e tij.

Tabela 5-2: Teoria e përparësive (avantazheve) absolute

	Vendi A	Vendi B	Gjithsej
Prodhimi X	8	0	8
Prodhimi Y	0	6	6

Siç kemi thënë, vendi A do të specializohet në prodhimin e parë në mënyrë që në dy orë të prodhojë 8 njësi. Vendi B do të specializohet në prodhimin e dytë dhe do të prodhojë 6 njësi të tij. Prandaj, nëse secili vend specializohet në prodhimin që prodhohet në mënyrë më efektive, prodhimi total i të dy produkteve do të rritet, kurse kjo nënkupton mundësinë e konsumit më të madh në të dy vendet. Prandaj nga këtu shihet fitimi në tregtinë ndërkombëtare.

1.2. Teoria e avantazhit krahasues

Teoria e avantazhit krahasues u zhvillua nga ekonomisti anglez Dejvid Rikardo në veprën e tij më të famshme “Parimet e ekonomisë politike dhe taksave” nga viti 1817.

Siç thamë, sipas teorisë së avantazheve absolute të Adam Smitit, çdo vend duhet të specializohet në atë produkt që prodhon në mënyrë më efektive se vendet e tjera. Por çfarë ndodh nëse një vend nuk është efikas në të gjitha produktet? A do të thotë kjo se nuk duhet të prodhojë asnjë produkt,

por duhet të importojë të gjitha produktet nga vendet e të tjera? Përgjigjen e jep teoria e avantazheve krahasuese, e cila tregon se edhe vendet që prodhojnë një produkt të caktuar me më pak efikasitet në krahasim me të tjerët, mund të marrin pjesë në tregtinë ndërkombëtare.

Ja shembulli i kësaj teorie.

Tabela 5-3: Teoria e avantazheve krahasuese

	Vendi A	Vendi B	Gjithsej
Prodhimi X	6	1	7
Prodhimi Y	4	2	6

Nga tabela shihet se vendi A është më efikas në prodhimin e të dy produkteve në krahasim me vendin B. A do të thotë kjo që ajo duhet të prodhojë të dyja produktet? Teoria e avantazhit krahasues tregon parimet me të cilat vendet do të specializohen në prodhim dhe do të angazhohen në tregtinë ndërkombëtare. Gjegjësisht, vendi A është absolutisht më efikas në të dy produktet, megjithatë, ai e prodhon prodhimin e parë shumë më efikas se prodhimin e dytë. Në prodhimin e prodhimit të parë është gjashtë herë më efikas se vendi i dytë, ndërsa në prodhimin e prodhimit të dytë është vetëm dy herë më efikas. Prandaj, vendi A ka avantazh krahasues në prodhimin e prodhimit X dhe do të specializohet në prodhimin e tij, ndërsa vendi B ka avantazh krahasues në prodhimin e prodhimit Y dhe do të specializohet në prodhimin e tij.

Nga tabela mund të vërehet se vendi A prodhon 6 njësi të prodhimit të parë në orë dhe 4 njësi të prodhimit të dytë në orë. Prandaj, produktet do të shkëmbehen në raportin 6 : 4, që do të thotë se një njësi Y do të këmbëhet për 1,5 njësi X. Vendi B prodhon 1 njësi X në orë, kurse nga ky produkt i fundit prodhon 2 njësi në orë. Kjo do të thotë që produktet X dhe Y do të shkëmbehen në raport 1:2, domethënë një njësi X do të shkëmbehet për dy njësi Y.

Siç thamë, vendi A do të specializohet në prodhimin X dhe atë do ta eksportojë atë në vendin B, i cili do të specializohet në prodhimin Y, ndërsa do ta importoj prodhimin X. Duke supozuar se të dy produktet në tregtinë ndërkombëtare do të shkëmbehen me një normë prej 1:1, vendi A për një orë do të prodhojë 6 njësi X për nevojat e veta, kurse në orën tjetër do të prodhojë gjithashtu 6 njësi për t'i eksportuar në vendin B. Në një orë vendi B do të prodhojë 2 njësi Y për nevojat e tij dhe në tri orët e ardhshme do të prodhojë 6 njësi të cilat do t'i shkëmbejë me 6 njësi të prodhimit X, të cilin e importon nga vendi A.

Siç mund të shihet, përfitimi i specializimit dhe tregtisë ndërkombëtare është i dukshëm: dy vendet me kosto më të ulët të punës dhe burimeve të tjera marrin më shumë produkte, që do të thotë mundësi për konsum më të lartë. Specializimi dhe shkëmbimi ndërkombëtar, mbi bazën e avantazheve

krahasuese ju sjellin përfitime të gjitha vendeve pjesëmarrëse në shkëmbim, pasi lejon zgjerimin e mundësive prodhuese të çdo vendi, duke rritur në këtë mënyrë prodhimin total botëror dhe duke rritur mirëqenien e përgjithshme.

Parimi i avantazhit krahasues është baza e shkëmbimit ndërkombëtar. Megjithatë, teoria e avantazhit krahasues ka disa të meta. Gjegjësisht, bazohet në supozimin se ka fleksibilitet të çmimeve dhe qirave në shkëmbimet ndërkombëtare, gjë që nuk përkon me realitetin. Për më tepër, teoria është e zbatueshme vetëm për vendet që janë afërsisht në të njëjtin nivel zhvillimi, kurse nëse ka dallime të mëdha midis vendeve tregtare, atëherë vendet më të varfra janë të dënuara të jenë shtesë e lëndës së parë për vendet e zhvilluara.


2. Proteksionizmi në tregtinë ndërkombëtare

Tregtia ndërkombëtare në shumë vende të botës është liberalizuar ndjeshëm në 50 vitet e fundit. Megjithatë, ata shpesh përdorin masa proteksioniste (si tarifatat e larta, kuotat e eksportit dhe importit, lejet e eksportit dhe importit, subvencionet, etj.). Qëllimi është mbrojtja e prodhimit vendas nga konkurrenca e huaj. Shpesh ndodhin edhe të ashtuquajturat luftëra tregtare midis vendeve të veçanta, për të mbizotëruar në marrëdhëniet dhe ndikimet ekonomike.

Proteksionizmi është fenomeni i mbrojtjes së prodhimit vendas nga konkurrenca e huaj, pra nga produktet dhe shërbimet më të lira me origjinë të huaj.

Ekzistojnë dy grupe të mëdha të instrumenteve të politikës proteksioniste:

Figura 5-7: Instrumentet e politikës proteksioniste



- **doganat**
- **barriera pa doganë**

Një nga instrumentet më të përdorura në politikën proteksioniste janë doganat. Ato janë taksë mbi importet. Ato paguhen nga importuesit e mallrave me origjinë të huaj, në mënyrë që çmimi i tyre

në tregun tonë të rritet dhe të afrohet, ndoshta edhe të barazohet me çmimin e të njëjtit mall të prodhuar në vend. Në këtë mënyrë, prodhuesit vendas mbrohen nga konkurrenca e huaj.

Grupi i dytë i instrumenteve proteksioniste janë: kuotat e importit dhe eksportit, të cilat i kufizojnë në mënyrë sasiore importet. Domethënë, eksporti i një malli nga një vend në tjetrin, lejet e importit dhe eksportit, d.m.th. procedura administrative me të cilat autoritetet shtetërore përpara e miratojnë eksportin ose importin e mallrave të caktuara, subvencionet e eksportit me të cilat shteti i kompenson ndërmarrjet vendase për diferencën në çmimin e mallit që eksportohet (në këtë rast prodhuesi vendas është më pak produktiv dhe ka çmim më të lartë të prodhimit se ai në tregun botëror), standardet shëndetësore që ndalojnë importin e ndonjë malli, sepse nuk i plotëson kriteret e përcaktuara për mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve të vendit importues, standardet mjedisore me logjikë të njëjtë ose të ngjashme me standardet shëndetësore, procedurat doganore, të cilat dekurajojnë eksportin e disa mallrave, etj.

Si grupi i parë ashtu edhe ai i dytë i instrumenteve japin disa efekte negative ekonomike. Ato mund të stimulohen si:

- Dogana krijon jo efikasitet ekonomik, sepse çmimi më i lartë i prodhimit lejon që disa nga ndërmarrjet vendase që më parë ishin pamjaftueshëm produktive dhe konkurruese me mallrat e huaja, falë doganës, të mbijetojnë dhe të vazhdojnë të ekzistojnë, ndonëse nuk i shfrytëzojnë burimet e pakta.
- Dogana e vendosur dhe rritja e çmimit të produkteve në tregun vendas i detyron konsumatorët t'i blejnë mallrat më të shtrenjta, pikërisht për lartësinë e doganës – konsumatorët janë humbës.
- Taksat doganore janë taksë me efekt fiskal dhe duhet të përdoren për disa qëllime me përfitim shoqëror publik.

3. Tregtia e lirë ndërkombëtare – liberalizmi

Aktiviteti ekonomik botëror në kushtet moderne gjithnjë e më shumë po globalizohet dhe ekziston bashkëpunimi ekonomik ndërkombëtar shumë intensiv dhe importit të kapitalit. Ato janë më të theksuara se kurrë më parë. Ky është rezultat i ndërgjegjësimit të vendeve për përfitimet që kanë nga tregtia ndërkombëtare dhe, për rrjedhojë, po përpiqen të reduktojnë dhe t'i heqin sa më shumë barrierat tregtare në bashkëpunimin ekonomik ndërkombëtar.

Në vitin 1947 u krijua Marrëveshja e Përgjithshme për Doganat dhe Tregtinë (GATT – General Agreement on Tariffs and Trade) dhe si institucion ndërkombëtar u kujdes për liberalizimin e tregtisë ndërkombëtare në baza shumëpalëshe.

Në vitin 1995, ky institucion u shndërrua në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT) (WTO – World Trade Organization). Sot, më shumë se 140 vende janë anëtarë të saj. RMV është gjithashtu anëtare e OBT-së. Kjo organizatë përcakton parimet dhe standardet për sjelljen e shteteve anëtare në

tregtinë ndërkombëtare, të cilat kontribuojnë në liberalizimin e tregtisë në shkallë globale dhe në marrëdhëniet e drejta dhe korrekte ndërmjet vendeve në bashkëpunimin e tyre tregtar. Ndër këto parime të OBT-së është parimi i mos diskriminimit të të gjitha vendeve anëtare dhe ato duhet të gëzojnë statusin dhe trajtimin e kombit më të favorizuar. OBT gjithashtu i angazhon anëtarët e saj të punojnë për të reduktuar të gjitha llojet e barrierave tregtare, tarifore dhe jo tarifore. Vendet shumë të zhvilluara nën kujdesin e OBT-së po negociojnë vazhdimisht reduktimin e barrierave tregtare në baza shumëpalëshe. Në këto kushte moderne, ka disa integritime të mëdha ekonomike, si BE-ja, të cilat japin kontribut të madh në liberalizimin e tregtisë së jashtme ndërmjet shteteve anëtare të Unionit. Është, në fakt, integrimi ekonomik më i fuqishëm në botë që ka një treg të vetëm prej mbi 400 milionë banorësh dhe ku ka lëvizje të lirë të mallrave, shërbimeve, punës, kapitalit.

Integritime të tjera të tilla të fuqishme ekonomike janë NAFTA (shoqata e tre vendeve – SHBA, Kanada dhe Meksikë), EFTA – zona më e vjetër e tregtisë së lirë në të cilën janë anëtarë një numër i madh i vendeve evropiane.

Termet kyç

- avantazhet absolute
- avantazhet krahasuese
- liberalizmi
- proteksionizmi
- importi kontingjent
- import me leje
- mënyra e miratimit
- doganat
- kuotat
- Organizata Botërore e Tregtisë (OBT).

Përmbledhje

- Asnjë vend në botë nuk ka ekonomi të mbyllur, që do të thotë se i drejtohet bashkëpunimit (import-eksportit) me vendet e të tjera. Duke vepruar kështu, respektohen disa ligjshmëri përmes të cilave theksohen kushtet dhe përparësitë që kanë vendet në atë bashkëpunim tregtar të jashtëm. Vendet specializohen në prodhimin e mallrave të caktuara, për të cilat kanë përparësi ndaj të tjerave. Teoria e avantazheve absolute do të thotë që çdo vend është i

specializuar në prodhimin e atij produkti që e prodhon në mënyrë më efikase se vendet e tjera dhe e eksporton atë produkt. Teoria e vlerave krahasuese është në dobi të të gjitha vendeve pjesëmarrëse në shkëmbim, pasi krijon një zgjerim të mundësive prodhuese të çdo vendi, ndërsa në këtë mënyrë edhe rritje e prodhimit të përgjithshëm botëror dhe rritje e mirëqenies së përgjithshme.

- Proteksionizmi është dukuria e mbrojtjes së prodhimit vendas nga konkurrenca e huaj, pra nga produktet dhe shërbimet më të lira me origjinë të huaj. Për ta bërë këtë, përdoren dy grupe instrumentesh: doganat dhe barrierat pa doganë.
- Liberalizim do të thotë tregti e lirë ndërkombëtare, tregti në të cilën do të reduktohen dhe hiqen barrierat tregtare në bashkëpunimin ekonomik ndërkombëtar. Në botë ekziston OBT (Organizata Botërore e Tregtisë), e cila kujdeset për liberalizimin e tregtisë ndërkombëtare në baza shumëpalëshe.

Pyetje për kontrollimin e njohurive

1. Cilat lloje të import-eksportit të kontrolluar i dallojmë?
2. Shpjegoni thelbin e vlerave absolute!
3. Shpjegoni teorinë e Rikardos për përparësitë (avantazhet) krahasuese!
4. Çfarë është proteksionizmi?
5. Çfarë rëndësie kanë doganat?
6. Çfarë janë kuotat?
7. Çfarë është tregtia e lirë?
8. Çfarë është Organizata Botërore e Tregtisë (OBT)?

Detyra për zbatimin praktik të njohurive

1. A ka RMV përparësi absolute në prodhimin e produkteve bujqësore në krahasim me vendet e BE-së? Shpjegoni!
2. Përmes hulumtimit, bëni analizë krahasuese të importeve dhe eksporteve në ekonominë e Maqedonisë në vitet e fundit!

Kapitulli 3

Sistemi devizor (valutor) dhe politika devizore (valutore)

Përmbajtja:

1. Sistemi devizor dhe politika devizore
2. Kursi devizor
3. Bilanci i pagesave (teknika e pagesave ndërkombëtare)

Kur të përfundoni këtë kapitull, duhet të jeni në gjendje:

- të përcaktoni sistemin devizor dhe politikën devizore;
- të shpjegoni për konvertueshmërinë e devizave;
- të përcaktoni kursin devizor;
- të bëni dallimin midis kurseve fikse dhe të ndryshueshme devizore;
- të tregoni formimin grafik të kursit devizor;
- të përcaktoni bilancin e pagesave.

1. Sistemi devizor dhe politika devizore

Sistemi devizor lidhet drejtpërdrejt me sistemin e tregtisë së jashtme. Së bashku ata bëjnë një tërësi. Përkatësisht, në lidhje me importin dhe eksportin e produkteve, ndodhë transaksioni me pagesë, gjegjësisht pagesat dhe arkëtimet. Pikërisht ato rregulla për kryerjen e pagesave jashtë vendit, janë elementi më i rëndësishëm i sistemit devizor. Duke pasur parasysh këtë, *sistemi devizor mund të përkufizohet si grup rregullimesh dhe masash ligjore me të cilat shteti i rregullon transaksionet e pagesave jashtë vendit, blerjen dhe disponimin e mjeteve të huaja të pagesës dhe mënyrën e blerjes dhe shitjes me mjete të huaja pagese*. Gjithashtu, si grup i veçantë rregullimesh, sistemi devizor i përfshin rregulloret dhe masat që lidhen me ruajtjen e kursit devizor, ruajtjen e bilancit të pagesave, tregun devizor, rezervat devizore dhe qarkullimin e metaleve të çmuara.

Tregu devizor është lloj specifik i tregut organizativ në të cilin kryhet blerja dhe shitja e devizave, kurse në të cilin marrin pjesë banka qendrore, bankat e autorizuara dhe institucionet e tjera financiare dhe persona të tjerë vendas.

Çdo vend ka *monedhën e vet nacionale* që përdoret si mjet ligjor brenda vendit. Subjektet vendase, nëse duan të bëjnë pagesë jashtë vendit, do të duhet të blejnë monedhën – njësinë monetare nacionale të vendit të huaj. Natyrisht, valutat e huaja do të paguhen me para të vendit.

Devizat janë kërkesa në periudhë afatshkurtër të shprehura në para të huaja, domethënë devizat janë kërkesa afatshkurtra të huaja. Për shembull, nëse ndërmarrja vendase i shet mallrat ndërmarrjes së huaj dhe kjo e fundit paguan për mallrat me faturë të shprehur në valutë të huaj, në atë rast ndërmarrja vendase fiton deviza. Disa autorë në deviza përfshijnë edhe monedhat, paratë e huaja efektive, pra paratë e gatshme të huaja, kurse autorë të tjerë bëjnë dallimin midis devizave dhe valutave. Devizat mund të ndahen sipas disa kriterëve. Do të fokusohemi vetëm në dy ndarje.

Varësisht nëse devizat mund të shkëmbehen lirisht me njëra-tjetrën, ato ndahen në: të *konvertueshme* dhe të *pakonvertueshme*.

Të parat janë deviza që mund të konvertohen lirisht, të shkëmbehen me monedha të tjera. Këto të dytat janë ato deviza që nuk mund të këmbehen me monedha të tjera. Për shembull: dollari amerikan është i konvertueshëm, sepse mund të këmbehet lirisht me monedha të tjera në të gjithë botën. Kjo është arsyeja pse ajo quhet edhe monedhë e qëndrueshme. Nga ana tjetër, denari është i pakonvertueshëm, sepse në shtetin e huaj nuk mund të këmbehet me dollarë, euro etj. Denarët kanë vlerë të paqëndrueshme dhe shpesh mund të ndryshojnë, pra mund të bien.

Rezervat devizore janë instrument shumë i rëndësishëm i bankës qendrore për ruajtjen e likuiditetit të pagesave të huaja. Por ato mund të përdoren edhe për të ndërhurë në tregun devizor. Ato ndikojnë në ruajtjen e kursit të denarit, që është arsye e zakonshme në vendin tonë.

Një pjesë e rezervave mbahen si të **përhershme**. Është pjesa e rezervës devizore që siguron likuiditet të përgjithshëm minimal prej një muaji në pagesat me jashtë. Një pjesë tjetër janë **rezervat aktuale**, të cilat sigurojnë likuiditet aktual me pagesat jashtë vendit. Vëllimi i rezervave të përhershme dhe aktuale përcaktohet çdo vit me dokument të posaçëm të miratuar nga kuvendi dhe banka qendrore (në rastin tonë BP) që i disponon ato.

Sipas sistemit devizor, rezervat valutore në RMV përbëhen nga: pretendimet jashtë vendit dhe letrat me vlerë në njësi monetare të huaja, të cilat mbahen dhe disponohen nga BP RMV, bankat e autorizuara dhe subjektet e të tjera ekonomike vendase. Në rezerva devizore përfshihen paratë e huaja efektive dhe ari monetar.

2. Kursi devizor

Çmimi i parasë së huaj i shprehur në para vendase shpreh kursin devizor.

Prandaj, kursi devizor tregon se **sa para vendase duhet dhënë për një ose njëqind njësi para të huaja**, që do të thotë se kursi devizor e përfaqëson vlerën e jashtme të monedhës vendase.

Për shembull, kursi i denarit është 61,8 denarë, që do të thotë se duhet të jepni 61,8 denarë për të blerë një euro (denari është i lidhur me euron).

Kursi devizor është lidhje midis ekonomisë së brendshme dhe të jashtme. Domethënë, nëse importojmë produkt që ka një çmim të shprehur në valutë të huaj, përmes kursit devizor ne e shndërojmë çmimin e tij në para të vendit dhe kështu fitojmë ide nëse çmimi i atij prodhimi është më i lartë apo më i ulët se çmimi i brendshëm, ndërsa me këtë nëse do të paguhet për ta importuar apo është më mirë ta blejmë në vend. Për më tepër, nëse çmimet e produkteve të huaja nuk ndryshojnë, por rritet kursi devizor, atëherë mallrat e huaja bëhen më të shtrenjta, të shprehura në para të brendshme. Ose, rritja e kursit devizor do të shkaktojë rritje të çmimit të materialeve që i importojmë, e rrjedhimisht edhe rritje të çmimeve të brendshme. Siç mund ta shihni, kursi devizor ka rëndësi shumë të madhe për ekonominë nacionale dhe për këtë arsye çdo shtet – qeveri ndërhyn në këtë fushë.

Në tregun devizor blihen dhe shiten valutat e huaja, domethënë në tregun devizor tregtohet me njësitë valutore të vendeve të ndryshme, kurse nën ndikimin e marrëdhënieve të ofertës dhe kërkesës formohen çmimet e kursit devizor.

Regjimi i kursit devizor e shpjegon bazën mbi të cilën qeveritë nacionale e përforcojnë kursin devizor. Ekzistojnë dy regjime bazë – sistemet e kursit devizor:

- **kurset fikse devizore**
- **kurset e luhatshme devizore**

